



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**Këshilli Drejtues**

**V E N D I M**

**Nr.2558, datë 17.04. 2015**

**Për**

**“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 17.04.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr, 2506, datë 30.10.2014, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Miratimi i Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014”.**

**I. BAZA LIGJORE:**

1. Neni 9, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr.9918/2008**);
2. Shkronja j) e nenit 7/1 të ligjit nr. 8530, datë 23.9.1999 “Për shërbim in Postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 8530/1999**);
3. Rregullore e Brendshme miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr, 2506, datë 30.10.2014 (**Rregullore e Brendshme**);

## II. K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-Raport i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014 (*Projekt-raporti*);
2. Relacioni shpjegues mbi project-vendimin (*Relacioni*);
3. Projektakti miratues – vendim i Këshillit Drejtues për miratimin e “Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014”;

## III. V Ë R E N se:

1. Projekt-raporti i paraqitur pasqyron në mënyrë të plotë veprimtarinë e AKEP për vitin 2014 dhe është hartuar bazuar në raportimet e bëra nga secila drejtori e AKEP mbi veprimtarinë e kryer;
2. Përmbajtja e Projekt-raportit përmbush kërkesat e përcaktuara në:
  - (i) Nenin 9, të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
  - (ii) Shkronjën j) të nenit 7/1 të ligjit nr. 8530, datë 23.9.1999 “Për shërbim in Postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
  - (iii) Rregulloren e Brendshme miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr, 2506, datë 30.10.2014.

## IV. P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen projekt-raportin në përputhje me kërkesat ligjore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918/2008 dhe Rregullores së Brendshme,

## V. V E N D O S:

1. Të miratojë Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të dërgojë brenda datës 20/04/2014 në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014”;
3. Të publikojë në faqen elektronike të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al) “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014” dhe një kopje e tij njëkohësisht t’i dërgohet edhe Ministrit të Inovacionit dhe Administratës Publike;

4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)
5. Ngarkohet Kabineti për zbatimin e këtij Urdhëri.

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**PIRO XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPCIU**
4. **Klarina ALLUSHI**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**R A P O R T I V J E T O R**

**I**

**V E P R I M T A R I S Ë**

**P Ë R**

**V I T I N 2 0 1 4**

## **PËRMBAJTJA:**

I.	INFORMACION I SHKURTËR MBI VEPRIMTARINË E AKEP-it PËR VITIN 2014...	4
II.	RAPORTI I PUNËS SË AKEP PËR VITIN 2014 .....	19
2.1.	ZHVILLIMI I TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE .....	19
2.1.1	Tregues Financiarë të sektorit.....	19
2.1.2	Shërbime të rrjeteve Celulare.....	20
2.1.3.	Telefonia fikse .....	32
2.1.4.	Aksesi me brez te gjere në Internet: rrjete fikse dhe celulare .....	36
2.2.	RREGULLIMI EKONOMIK I TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE .....	40
2.2.1.	Analizat e Tregjeve .....	40
2.2.2.	Masat rregullatore .....	49
2.2.3.	Rregullorja për të dhënat statistikore .....	53
2.3.	STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR SHËRBIMET PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELKTRONIKE .....	53
2.4.	ZHVILLIMI I TREGUT TË SHËRBIMIT POSTAR.....	53
2.4.1.	Kuadri ligjor dhe rregullator .....	53
2.4.2.	Ligji për shërbimet postare .....	54
2.4.3.	Aspekte të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe të dhënat statistikore .....	55
2.4.4.	Kontrolli i veprimtarisë së ofruesve të shërbimit postar.....	56
2.4.5.	Publikimi i të dhënave të tregut postar dhe projekti ATLAS .....	57
2.4.6.	Rrjeti postar.....	61
2.4.7.	Tregues statistikore .....	61
2.4.8.	Rezultatet financiare – 2014 .....	62

2.4.9.	Statusi i shërbimit universal për shërbimin postar .....	64
2.4.10.	Prioritete.....	65
2.5.	ADMINISTRIMI I BURIMEVE TË FUNDME DHE REGJIMI I AUTORIZIMEVE....	66
2.5.1.	Administrimi i spektrit të frekuencave .....	66
2.5.2.	Administrimi i planit të numeracionit dhe dhënia e të drejtës së përdorimit të numrave.....	75
2.5.3.	Ofrimi i shërbimit të portabilitetit të numrave .....	75
2.6.	MONITORIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE, CILËSISË DHE INSPEKTIMI I VEPRIMTARISË .....	77
2.6.1.	Monitorimi i spektrit të frekuencave.....	77
2.6.2.	Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe standardet .....	80
2.6.3.	Inspektimi .....	81
2.6.4.	Kundravajtjet administrative.....	82
2.6.5.	Bashkëpunimi .....	83
2.6.6.	Projekti ATLAS .....	84
2.6.7.	Zhvillimi i projektit “Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Spektrit të Frekuencave për Shqipërinë” .....	85
2.6.8.	Përmirësimi dhe plotësimi i akteve administrative normative:.....	87
2.7.	ÇËSHTJE QË LIDHEN ME TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT, ADMINISTRIMIN E DOMAIN CC.TLD.AL DHE NËN DOMAIN-EVE TË TIJ, SI DHE APLIKACIONET .....	89
2.7.1.	Ushtrimi i kompetencave ligjore mbi ofrimin shërbimeve me brez të gjerë dhe aksesin në internet.....	89
2.7.2.	Administrim i sistemeve cctld .al.....	93
2.8.	ZHVILLIMI I KUADRIT NËNLIGJOR RREGULLATOR, ZBATIMI I LIGJSHMËRISË DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PËRDORUESVE .....	95
2.8.1.	Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit nënligjor rregullator të fushës .....	95
2.8.2.	Ushtrimi i kompetencës ligjore të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve.....	99
2.8.3.	Kontrolli administrativ i akteve të nxjerra nga AKEP-i, përfaqësimi dhe ndjekja e çështjeve gjatë shqyrtimit gjyqësor ku AKEP është palë ndërgjyqëse .....	101
2.8.4.	Ushtrimi i kompetencës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar.....	113

2.9.	ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË BURIMEVE NJERËZORE, MARRËDHËNIET NDËR-INSTITUCIONALE DHE NDËRKOMBËTARE, ADMINISTRIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR INSTITUCIONIN .....	115
2.9.1.	Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore.....	115
2.9.2.	Aktiviteti i bashkëpunimit ndër-institucional dhe marrëdhëniet ndërkombëtare	119
2.9.3.	Administrimi i shërbimeve mbështetëse për institucionin.....	120
III.	PROGRAMI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2015 .....	121
IV.	RAPORTI PËR REALIZIMIN E TREGUESVE FINANCIARË VJETOR TË AKEP..	123
4.1.	Realizimi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2014.....	123
4.2.	Rritja e performancës dhe efektiviteti i realizimit të treguesve financiarë të AKEP .....	128
4.3.	Parashikimi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2015.....	128

## **I. INFORMACION I SHKURTËR MBI VEPRIMTARINË E AKEP-it PËR VITIN 2014**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), është person juridik, publik, jobuxhetor, i krijuar me ligjin e veçantë, Ligj nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligj nr. 9918/2008*).

Objekti i veprimtarisë së AKEP-it si organ rregullator është mbikëqyrja e zbatimit nga subjektet e ligjit, të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe atë postare, të përcaktuar nga legjislacioni përkatës material si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave

Parimet bazë të cilat AKEP-i aplikon në kryerjen e aktivitetit referuar rregullimit sektorial, janë të orientuara për:

- të siguroar një mjedis të qartë dhe të parashikueshëm biznesi për veprimtarinë e sipërmarrësve dhe investimet e tyre të rëndësishme;
- të krijuar kushte për zbatimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke promovuar një përdorim racional të burimeve të kufizuara (frekuencat dhe numeracioni/adresat);
- promovimin e konkurrencës dhe parandalimin e shtrëmbërimeve të konkurrueshmërisë në treg midis operatorëve;
- zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis operatorëve dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të mbrojtjes së interesave të përdoruesve.

Raporti i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2014 i paraqitet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 9 të ligjit nr. 9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligj nr. 9918/2008*).

Raporti në përputhje me përcaktimet ligjore për këtë qëllim përmban në mënyrë të veçantë:

- Raportin e punës së AKEP për vitin 2014 ;
- Programin vjetor të punës për vitin 2015;
- Raportin për statusin e shërbimit universal; dhe
- Raportimin për realizimin e treguesve financiarë vjetorë të AKEP.

### **Funksionimi i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

Edhe gjatë vitit 2014 AKEP-i ka qenë i angazhuar për përmbushjen e objektivave në dy drejtimet kryesore të veprimtarisë:



➤ **Si organ i Administratës Publike:**

- Zhvillimin e veprimtarisë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë aderon, ligjet e Republikës së Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave që disponon dhe konform qëllimit për të cilat i janë dhënë këto kompetenca;
- Zbatimin e parimeve të barazisë dhe proporcionalitetit, drejtësisë dhe paanësisë, bashkëpunimit me personat privatë dhe përgjegjshmërisë.

➤ **Si organ rregullator i fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar:**

- Realizimit me sukses të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në politikat e Këshillit të Ministrave për zhvillimin sektorial;
- Zbatimin e kërkesave të Kuvendit të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2013”, si dhe:

Rekomandimet e parashikuara në Raportin e Progresit për Shqipërinë të KE, për vitin 2013

🚩 **Vendimmarrja**

AKEP-i drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga vetë ai.

Përbërja e Këshillit Drejtues për vitin 2014 ka qene:

Pirro Xhixho	Kryetar
Alban Karapici	Anëtar
Alketa Mukavelati	Anëtar
Benon Paloka	Anëtar
Zamira Nurçe	Anëtar

Në ushtrimin e veprimtarisë vendimmarrëse Këshilli Drejtues gjatë vitit 2014 ka marrë gjithsej **118** vendime, nga të cilat:

- **86** vendime për miratimin e akteve rregullatore;
- **20** vendime për miratimin e akteve që lidhen me veprimtarinë ekzekutive të institucionit;
- **4** vendime për miratimin e akteve lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve;
- **8** vendime për miratimin e akteve lidhur me shqyrtimin e ankimeve administrative.

Për funksionimin e veprimtarisë institucionale të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare janë miratuar nga Këshilli Drejtues rregulloret:

- Rregullore e brendshme e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
- Rregullore e etikës dhe sjelljes profesionale në Autoritetin të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
- Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike

në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

- Rregullore për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhani në Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

#### **Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit rregullator**

Në përmbushje të kompetencës për nxjerrjen e rregulloreve në zbatim të ligjit nr 9918/2008 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, gjatë vitit 2014 janë hartuar nga strukturat përgjegjëse dhe miratuar nga Këshilli Drejtues gjithsejt **10** akte normative administrative (Rregullore) nga të cilat 6 akte përmirësuese me shtesa dhe ndryshime në aktet ekzistuese dhe **4** akte të reja në plotëim të kuadrit rregullator.

#### **Bashkëpunimi në nismat ligjore**

Ligji nr. 9918/2008 parashikon kompetencën e Ministrit për paraqitjen në Këshillin e Ministrave të projekt-akteve ligjore e nënligjore, për zhvillimin e sektorit. Në kuadër të nismave ligjore të ndërmarrë nga Ministri për këtë qëllim është bashkëpunuar bazuar në aktet e nxjerra nga Ministri lidhur me nismat ligjore, ndër të cilat veçojmë si më të rëndësishmin bashkëpunimin për hartimin e projekt-ligjit për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

#### **Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore**

Me Vendimi të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 11/2014 të Kuvendit të Shqipërisë, “*Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare*” është miratuar struktura organizative dhe organika e AKEP, e përbërë nga 60 punonjës.

Implementimi i strukturës së re, në zbatim të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore në fuqi ka mundësuar rritjen e efikasitetit të stafit dhe cilësisë së kapaciteteve të burimeve njerëzore, në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rritjes së fleksibilitetit dhe transparencës në ushtrimin e funksioneve, në gjithë veprimtarinë e punës së AKEP. E reja e kësaj strukture qëndron te konfigurimi i organigramës sipas zhvillimeve të tregut të komunikimeve elektronike dhe krijimit të një sektori të veçantë për rregullimin postar në Shqipëri.

#### **Financimi dhe buxheti i Autoritetit të komunikimeve Elektronike dhe Postare**

Burimet e financimit të AKEP janë pagesat, sipas përcaktimeve në nenet24, 78 dhe 86 të ligjit nr. 9918/2008.

AKEP mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

Me Vendimin nr.104 të Këshillit të Ministrave, datë 26.02.2014 “ Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2014 për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare” fondi i shpenzimeve u miratua në shumën 259,500,000 lekë .

**Përformanca e treguesve ekonomik – financiarë të AKEP – it është e pasqyruar si më poshtë:**

<b>Nr. Ren</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Programi</b>	<b>Realizimi</b>
<b>I</b>	<b>Të ardhurat gjithsej:</b>	<b>259,500,000</b>	<b>272,115,581</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime gjithsej:</b>	<b>259,500,000</b>	<b>232,177,757</b>
1	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	72,000,000	58,434,822
2	Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore	9,700,000	8,143,808
3	Shpenzimet për materiale	5,200,000	6,264,027
4	Shpenzimet për shërbime	48,180,000	44,405,237
5	Shpenzimet për investime	124,420,000	114,929,863
<b>III</b>	<b>Tarifa e Shërbimit të radiokomunikacionit</b>		<b>357,892,000</b>
1	Arkëtuar dhe Transferuar në Buxhetin e Shtetit		357,892,000

#### **🚩 Tregu i komunikimeve elektronike**

##### **➤ Rregullimi i Tregjeve**

AKEP-i përcakton tregjet përkatëse kombëtare të komunikimeve elektronike dhe produktet përkatëse, të cilat justifikojnë rregullimin dhe janë subjekte të rregullimit të veçantë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918/2008, me parimet e ligjit për konkurrencën dhe kushtet aktuale të tregut shqiptar, duke pasur parasysh kërkesat e rregullimit të veçantë në sector dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve.

##### **➤ Analizat e Tregjeve**

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918/2008, dhe Rregullores “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2014 kreu proceset e mëposhtme për analizat e tregut:

- Miratimi i versionit final të Analizës së tregjeve të linjave me qira
- Miratimi i versionit final të Analizës së tregjeve të aksesit broadband me shumicë dhe LLU
- Miratimi i versionit final të Analizës së tregut të terminimit të SMS-ve
- Këshillim publik dhe miratimi i versionit final të Analizës së tregut celular.

➤ **Të dhëna statistikore:**

- Në fund të vitit 2014, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, arriti në 4.9 milion krahasuar me 5.3 milion në fund të vitit 2013. Ndryshimi përbën një rënie vjetore prej 7.6%, dhe ai varion sipas operatorëve: AMC dhe Vodafone patën rënie me 8 dhe 12% respektivisht, Plus pati 12% rritje, ndërsa numri i pajtimatrëve sipas këtij treguesi të Albtelecom (Eagle Mobile) ishte pothuajse i pandryshuar (reduktim me 0.1%).

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2013 ishin rreth 50206 milion leke, të cilat përbëjnë një rënie me 9% në krahasim me vitin 2012. Peshën kryesore të këtyre të ardhurave e zënë ato që vijne nga shërbimet e ofruara nëpërmjet rrjeteve celulare, të cilat për 2013 janë rreth 74 % të të ardhurave totale të sektorit, ndërsa të ardhurat e gjithë sipërmarrësve të rrjeteve fikse (Albtelecom Fiks + OA) zënë rreth 26% të të ardhurave të sektorit. Sipas të dhënave, të ardhurat totale të sipërmarrësve për vitin 2014 ishin rreth 41632 miliard lek, që përbën një reduktim me 17 përqind nga viti 2013. Vodafone, AMC dhe Struktuar e të ardhurave sipas sipërmarrësve në 2014 nuk ka ndryshime të dukshme nga 2013. Katër sipërmarrësit më të mëdhenj zotërojnë rreth 93% të të ardhurave të sektorit ndërsa operatorët alternativë 7%. Të ardhurat e sipërmarrësve më të mëdhenj janë reduktuar ndjeshëm në 2014, gje që ka cuar edhe në reduktim të të ardhurave të sektorit. Të ardhurat e operatorëve celularë në 2014 u reduktuan me 13%, nga 37 miliard lek në 2013 në 32 miliard lek në 2014.

Nga të dhënat e tabelës vihet re se të numri i përdoruesve të shërbimeve bazë GSM ka rënie me 8-9%, ndërkohë që treguesit e volumit të shërbimeve të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS janë me rritje 8-47%. Thirrjet hyrëse ndërkombëtare kanë reduktim me 29%, ndërkohë që terminimi i thirrjeve nga rrjetet kombëtare ka rritje me 78%, e cila vjen rritja e trafikut off-net. Treguesit e volumit të shërbimeve 3G janë të gjithë me rritje. Numri i përdoruesve të këtyre shërbimeve është rritur me 16%, ndërsa volumi total i të dhënave të trenasmetuara në rrjetet celulare me GPRS/UMTS është rritur me 148%

Proporcioni i përdoruesve aktive ndaj kartave SIM aktive është në nivel 69% për të katër operatorët së bashku, duke variuar nga 59% për AMC në 79% për Vodafone. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në fund të vitit 2014 ishte 119% për përdorues active (krahasuar me 130% në 2013) dhe 172% sipas kartave SIM (krahasuar me 187% në 2013). Të dy treguesit e matjes së numrit të përdoruesve celularë janë me rënie në 2014, e cila mund të ketë ardhur për shkak të reduktimit të zotërimit të disa kartave SIM nga përdoruesit.

- Në vitin 2014 është vënë re rritje e përqindjes së numrit të përdoruesve me parapagim në krahasim me vitin 2013. Tabela e mëposhtë paraqet peshën që zënë përdoruesit me kontratë në numrin total të përdoruesve, aktivë dhe sipas kartave SIM. Në fund të vitit 2014 përdoruesit me parapagim përbënin 92% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë krahasuar me 87% në 2013 dhe 94 % të numrit të përdoruesve sipas kartave SIM aktive, krahasuar me 91% në 2013.

- Gjatë vitit 2014 thirrjet dalëse të përdoruesve celularë u rriten me 8% në krahasim me vitin 2013. Rritjen më të madhe e kanë pasur Altelecom (EM) dhe Plus me 69% dhe 58% respektivisht, ndërsa Vodafone dhe AMC kanë pasur rritje me 6% dhe reduktim me 6% respektivisht. Gjatë vitit 2014 për herë të parë u vu re reduktim i sasisë së thirrjeve brenda rrjetit, me 3% në krahasim me vitin e mëparshëm. Reduktimi ka ndodhur tek AMC me 12 dhe Vodafone me 2%, ndërkohë që Altelecom dhe Plus kanë rritje me 22 dhe 36%. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombetare (off-net) ka pasur rritje me 72%, ku rritjen më të madhe e kanë pasur Altelecom dhe Vodafone me 128% dhe 89% përkatësisht.

Ndërkohë rritjen më të madhe e ka pasur trafiku (thirrjet) dalës ndërkombëtar, i cili gjatë vitit 2014 u rrit më shumë se 4 herë në krahasim me vitin 2013. Rritja varin nga rreth 3 here tek AMC dhe Vodafone në 8-12 herë tek Altelecom dhe Plus.

- Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse u reduktua në 83% në 2014 krahasuar me 93% në 2013. Pesha e këtyre thirrjeve për Vodafone dhe AMC në 2014 ishte 87-88% krahasuar me 94-95% në 2013. Edhe tek Altelecom dhe Plus është venë re reduktim i peshës së këtyre thirrjeve nga 78-79% në 2013 në 58-67% në 2014. Thirrjet ndërkombëtare kanë pasur rritjen më të madhe në 2014 dhe pesha e tyre arriti në 8% krahasuar me 2% në 2013. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare pati rritje në 2014 dhe pesha e tyre në totalin e thirrjeve dalëse celulare, arriti në 8% në 2014 krahasuar me 5% në 2013. Megjithë ndryshimet e mësipërme, përqindja e thirrjeve brenda rrjetit ndaj thirrjeve drejt rrjeteve celulare kombëtare (brenda dhe jashtë rrjetit) për AMC dhe Vodafone në 2014 ishte 93-95% krahasuar me 95-97% në 2013.

Struktura e trafikut dalës tregon se edhe në 2014 ka vazhduar tendenca e viteve të fundit dhe përdorim i madh i paketave tarifore me tarifa shumë të ulëta për thirrjet brenda rrjeteve por me reduktime të moderuara të tyre dhe rritje të ofertave të thirrjeve jashtë rrjetit dhe sidomos me rritje të mëdha të ofertave për thirrjet dalëse ndërkombëtare.

- Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse u reduktua në 83% në 2014 krahasuar me 93% në 2013. Pesha e këtyre thirrjeve për Vodafone dhe AMC në 2014 ishte 87-88% krahasuar me 94-95% në 2013. Edhe tek Altelecom dhe Plus është venë re reduktim i peshës së këtyre thirrjeve nga 78-79% në 2013 në 58-67% në 2014. Thirrjet ndërkombëtare kanë pasur rritjen më të madhe në 2014 dhe pesha e tyre arriti në 8% krahasuar me 2% në 2013. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare pati rritje në 2014 dhe pesha e tyre në totalin e thirrjeve dalëse celulare, arriti në 8% në 2014 krahasuar me 5% në 2013.

## ➤ Pjesët e tregut:

### **Për treguesit e numrit të përdoruesve:**

- AMC në 2014 ka humbur 4 pikë përqindje në pjesën e tregut për përdorues aktive, ndërsa tre operatorët e tjerë kanë rritur pjesët e tregut me nga 1-2 pikë përqindje pjesët e tyre të tregut: Vodafone duke arritur në 46%, EM në 13%, dhe Plus në 8%.
- Vodafone në 2014 ka pasur reduktim me 2 pikë përqindje në pjesën e tregut të përdoruesve të kartave SIM, e cila ka shkuar në rritje me 1 pikë përqindje të pjesëve të tregut të EM dhe Plus, ndërsa AMC nuk ka ndryshim në pjesën e tregut të këtij treguesi.
- Pjesët e tregut të përdoruesve me kontratë kanë ndryshime të ndjeshme, ku AMC dhe Plus kanë reduktime me 17 dhe 10 pikë përqindje të pjesëve të tregut, ndërsa Vodafone dhe EM kanë rritje me 15 dhe 13 pikë përqindje respektivisht.

### **Pjesët e tregut të thirrjeve dalëse:**

- Në vitin 2014 në krahasim me vitin 2013 tregojnë për rritje nga 7 në 11% të Altelecom (EM) dhe nga 3 në 5% për Plus, ndërkohë që AMC ka reduktim nga 39 në 34% dhe Vodafone reduktim me 1 pikë përqindje, duke zotëruar 50% pjesë tregu të thirrjeve dalëse në 2015.
- Pjesa e tregut e Vodafone për SMS është reduktuar me 7 pikë përqindje por Vodafone vazhdon të ketë një pjesë tregu të lartë prej 66%. Plus dhe Altelecom (EM) kanë rritje të pjesëve të tregut me 4 dhe 5 pikë përqindje, ndërsa AMC ka reduktim me 2 pikë përqindje.

### **Pjesa e tregut në të ardhura:**

- Vodafone për 2013 rezulton të jetë 47% që përbën rënie nga niveli 50% në 2013. AMC dhe Altelecom (EM) kanë rritje me 2 dhe 1 pikë përqindje në 2014, duke arritur në 35% dhe 12% pjesë tregu respektivisht. Plus edhe në 2014 kishte 6% pjesë tregu në të ardhura si edhe në vitin 2013.

## ➤ Telefonia fikse

### **Numri i pajtimtarëve**

- Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2014 arriti në rreth 247 mijë, që përbën një reduktim me 12% në krahasim me vitin 2013. Rënia ka ardhur për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Altelecom, me 13% si dhe rënies me 9% të numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë. Norma e pënetimit për telefoninë fikse arriti në 8.7%, që është shumë më e ulët se në vendet e BE apo edhe të rajonit. Figura e mëposhtme

paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe Albtelecom dhe operatorëve alternativë në periudhën 2000-2014.

## Tarifat

Gjatë vitit 2014 ka vazhduar tendenca viteve të fundit të operatorëve të telefonisë fikse për promovim të paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (bundles of minutes) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (bundles of services). Dy operatorët më të mëdhenj alternativë, Abcom dhe ASC, tradicionalisht janë ofrues të shërbimeve akses në internet, telefoni dhe transmetim të shërbimeve televizive, dhe ofrojnë dhe paketa të integruara më të tre shërbimet në një shportë dhe me tarifë mujore të përbashkët. Gjatë vitit 2014 edhe Albtelecom filloi ofrimin e paketave trefishe, Telefoni, Akses në Internet dhe IPTV, dhe vihet re se në fund të 2014 rreth 20% e pajtimtarëve familjarë me akses broadband të Albtelecom ishin përdorues të këtyre paketave 3-fishe.

## Tregu i shërbimit postar

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së AKEP për vitin 2014 ka qenë plotësimi i objektivave rregullatore, në nxitjen e zhvillimit të sektorit postar, duke zbatuar procedurat e licencimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontrollin e respektimit të kërkesave ligjore në shërbimet e ofruara nga operatorët, duke u kujdesur që konkurrenca ndërmjet operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve postare të mbështetet në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme.

Zhvillimi i tregut postar është nxitur nga rritja e infrastrukturës së tregut postar dhe tendencave të reja teknologjike, të cilat kanë çuar në rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë, shërbimeve më të mira dhe më eficiente.

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2014, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:

### ➤ Tregues për shërbimin bazë postar të realizuar nga Posta Shqiptare:

- Objekte postare të pranuar nga Posta Shqiptare për shërbimet bazë postare 18.735.676 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.821.977 janë: **6.6 objekte / banorë**.
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 553, për ofrimin e shërbimeve bazë postare nga Posta Shqiptare në raport me popullsinë 2.821.977 janë: **5.103 banorë / zyrë**.
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 553, për ofrimin e shërbimeve bazë postare nga Posta Shqiptare në raport me sipërfaqen 28.748 Km<sup>2</sup> janë: **52m<sup>2</sup> / zyrë**.

➤ **Tregues të realizuar nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare:**

- Objekte postare të pranuar gjithësej 21.258.225 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.821.977 janë: **7.5 objekte / banorë.**
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 928 në raport me popullsinë 2.821.977 janë: **3.040 banorë / zyrë.**
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 928 në raport me sipërfaqen 28.748 Km<sup>2</sup> janë: **31 Km<sup>2</sup> / zyrë .**

🚩 **Regjimi i Autorizimit të Përgjithshëm, Administrimi i Burimeve të fundme**

➤ **Regjistrimi i sipërmarrësve dhe dhënia e Autorizimeve Individuale**

Sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9918/2008 ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike bëhet kundrejt autorizimit nga AKEP-i, sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm. Autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike bëhet:

- përmes njoftimit, kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuara;
- pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme.

**Për vitin 2014 rezulton se:**

- Janë dhenë **106** Çertifikata të Konfirmimit të Njoftimit (ÇKNJ) për regjistrimin e sipërmarrësve që kanë njoftuar fillimin e ofrimit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, nga të cilat:
- **83** janë fillestare;
- **23** shtesa ose ndryshime në ekzistueset;
- **19** janë për telefoni (17 për telefoni fikse, 2 kartë me parapagim);
- **36** për ofrim internet
- **4** për ofrim shërbimi me vlerë të shtuar;
- **2** për transmetim të dhënash.
- Janë çregjistruar **10** ÇKNJ.
- Janë regjistruar **47** sipërmarrës që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale, nga të cilët:
- **8** ofrojnë shërbime publike të komunikimeve elektronike;
- **39** janë vetëm kabllorë.

Me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2507, datë 30.10.2014 bëri “Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt:“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz” dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi pajisi ofertuesin fitues me Autorizimin Individual përkatës.



AKEP ka punuar në mënyrë të vazhdueshme për heqjen e barrierave administrative në procesin e lëshimit të Autorizimeve Individuale. Për këtë ka informatizuar sistemin e aplikimeve për pajisjen me autorizim për frekuenca dhe për numra. Këshilli Drejtues miratoi aktet rregullatore “Rregullore për Autorizimin Individual” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për caktim dhe përdorim të numrave dhe serive numerike dhe PKN” duke bërë të mundur dhe implementimin e procesit “Aplikim Online” për kërkesat e caktimit të frekuencave, caktimit të numrave dhe raportimin e interferencave. I gjithë procesi ka kaluar nëpërmjet këshillimit publik dhe takimeve e workshop-eve me sipërmarrësit.

Nga fillimi i vitit 2014, për operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP:

- **40** autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 1160 lidhje fikse të reja/ndryshuara, nga të cilat:
  - (i) VFAL 8 (115 lidhje të reja, 269 ndryshime, 84 revokime)
  - (ii) AMC 4 (560 lidhje të reja, 34 ndryshime, 16 revokime)
  - (iii) PLUS 1 (10 lidhje për 3G test, 0 ndryshime, 11 revokime)
  - (iv) Albtelecom 2 (33 lidhje të reja, 73 ndryshime, 0 revokime)
  - (v) Të tjera 25 (65 lidhje të reja, 0 ndryshime, 53 revokime)
- **195** Autorizime Individuale për përdorimin e frekuencave në 200 sisteme PMR radiokomunikim dhe radioalarmi.
- Për dhënien e numrave dhe serive numerike është ngritur sistemi i menaxhimit të Planit të Numeracionit që përfshin të gjithë kategoritë e numrave dhe matricën e ndërfaqur online.

Janë përpunuar dhe procesuar:

- (i) Alokime numra dhe seri numerike janë trajtuar **50** aplikime. Anullim numeracioni janë trajtuar **30** caktime për efekt pagese dhe 10 me kërkesën e subjekteve.

➤ **Portabiliteti i numrave**

Në mënyrë të vazhdueshme AKEP ka ndjekur funksionimin e sistemit të portabilitetit të numrit CRDB.

Në përgjithësi procesi ka ecur mirë, edhe këtë vit ka patur një numër të madh abonentësh të cilët kanë përdorur shërbimin e portabilitetit të numrit, një tablo me shifrat e numrave të bartur në fund të viteve 2013 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

Shërbimi Telefonik	I lëvizshëm		Fiks	
	2013	2014	2013	2014
Numra të bartur	<b>101622</b>	<b>102796</b>	<b>4875</b>	<b>5336</b>

## ➤ **Marrja e mendimit të palëve të interesuara**

Duke vlersuar se interesi për disa breza të kërkuar të frekuencave tejkalonte disponueshmërinë e frekuencave në këtë brez, si dhe për të garantuar një përdorim efektiv të tyre, AKEP-i gjatë vitit 2014 zhvilloi procese të këshillimit public me palët e interesuara. Kështu u zhvilluan proceduar këshillimi publik për dhënien e të drejtave të përdorimit:

- në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/“EiMAX” ,
- në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”,
- nga brezi 900 MHz për sistemet GSM.

AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi po ndjek të gjitha procedurat e duhura deri në përfundimin të tij.

## ➤ **Zbatimi i kushteve të përgjithshme**

Në drejtim të zbatimit nga sipërmarrësit të kushteve të vendosura në autorizimin e përgjithshëm, mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit AKEP ka kërkuar në mënyrë të veçantë:

- Respektimin nga sipërmarrësit që ofrojnë aksesin në internet, e kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme;
- Kushtet për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike në rastet e gjendjes së emergjencës apo të gjendjes të luftës;
- Detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918/2008; etj.

### **Konkretisht:**

- AKEP në bashkëpunim dhe me kërkesë të Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojrave Të Fatit në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 15, pika 1e) të ligjit nr. 9918/2008 i ka kërkuar ofruesve të shërbimit të Internetit (ISP) mbylljen e faqeve të internetit të cilat kanë në përmbajtje lojëra fati online. Aktualisht rezultojnë të bllokuara rreth 500 faqe të cilat kanë në përmbajtje lojëra fati online.

Gjatë vitit 2014 për monitorimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe standardet AKEP ka kryer monitorimin e segmenteve kryesorë rrugorë kombëtare

### **🇹🇷 Inspektimi, Monitorimi i Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative**

## ➤ **Inspektimi**

Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo personi tjetër fizik apo juridik, që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, kryhet nga inspektorët e AKEP-it.

AKEP në zbatim të planit vjetor dhe planeve një-mujore të miratuara nga KD i AKEP në vitin 2014 **ka kryer gjithsej 47 inspektime** tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

#### ➤ **Monitorimi i përdorimit të spektrit të frekuencave**

AKEP-i monitoron spektrin e frekuencave të caktuara në Planin Kombëtar të frekuencave me qëllim që:

- Përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje mekuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit;
- Spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit nr. 9918/2008;
- Të krijojë një mjedis të përshtatshëm dhe pa interference të dëmshme për operimin e sistemeve dhe stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2014 monitorimi u krye dy herë në vit në pikat e mëposhtme:

- |                                      |                                      |
|--------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Kërtushaj, Vorë, Ardenicë         | 7. Sopot, Mile, Midë, Tregtan,       |
| 2. Pinet, Kodër Durrës, Zvërnec,     | 8. Tarabosh, Tyrbe, Petresh, Krrabë, |
| 3. Likovun, Grabian, Dajt            | 9. Çervenakë, Korçë, Gllavë,         |
| 4. Tarabosh, Tyrbe, Petresh, Krrabë, | 10. Sopot, Mile, Midë, Tregtan,      |
| 5. Çervenakë, Korçë, Gllavë,         | 11. Likovun, Grabian,                |
| 6. Dajt Kërtushaj, Vorë, Ardenicë    |                                      |

#### ➤ **Blokimi i pajisjeve dhe ndalimi i funksionimit të tyre**

Kur një person fizik apo juridik zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, i paautorizuar nga AKEP-i, inspektorët bllokojnë pajisjet.

Gjatë monitorimit të pikave të mësipërme janë identifikuar:

- disa subjekte, kryesisht ato që ofrojnë shërbim audiovizual (broadcast), të cilat përdorin lidhje fikse pa u pajisur me Autorizim Individual. Për këto subjekte në disa raste u mbajt proces-verbal ku u njoftuan për të aplikuar për lidhje fikse radio pikë-pikë dhe në disa raste të tjera u mor masa e sekuestrimit të pajisjeve.
- disa subjekte të cilat përdorin lidhje fikse radio, për të cilat u mor masa e sekuestrimit të pajisjeve dhe vendosjes së gjobave.

Gjatë vitit 2014 janë bllokuar **38** pajisje transmetuese, të cilat operonin pa Autorizim Individual dhe **65** antena që operonin në frekuencat e brezit 5.8 GHz, në kundërshtim me rregulloren nr. 33 dt. 15.05.2014 për "*Kushtet e përdorimit të frekuencave pa Autorizim Individual dhe Kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza*".

### ➤ **Kundërvajtjet administrative**

Gjatë inspektimeve, bazuar në nenin 137 të ligjit material nr.9918/2008 , nenit 24 të Rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe kundravajtjet administrative”, miratuar me VKD nr.1516, datë 31.01.2011, për 17 sipërmarrës të komunikimeve elektronike u vendos masë administrative me gjobë për shkelje të cilat janë pasqyruar në aktet e inspektimit.

Nga 17 masa administrative (me gjobë) janë arkëtuar në llogari të AKEP, 14 gjoba me vlerë **470.000 lekë** dhe 3 gjoba të pavjelura në proces ankimi.

### 🚧 **Mosmarrëveshjet**

#### ➤ **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve**

AKEP-i zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e ligjit nr. 9918/2008 dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij.

Një fakt i rëndësishëm për është se gjatë vitit 2014 numri i mosmarrëveshjeve midis sipërmarrësve duke investuar AKEP-in për zgjidhjen e tyre ka shënuar një ulje të theksuar. Në varësi të problematikës/objektit, nëpërmjet strukturës përgjegjëse në bashkëpunim me strukturat e tjera sipas organikës, AKEP-i është angazhuar në ndjekjen e procedimeve.

#### ➤ **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve**

Nëse një mosmarrëveshje mes një pajtimtari dhe një sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimit publik nuk mund të zgjidhet ndërmjet procedurave për trajtimin e ankesave, sipas nenit 107 të ligjit nr. 9918/2008, pajtimtari mund të kërkojë nga AKEP-i të zgjidhë mosmarrëveshjen.

AKEP e ka ushtruar kompetencën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar nëpërmjet instrumenteve të tij, zyrës përkatëse dhe “Komisionit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes – KZM”, struktura e ngritur “ ad hock” për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, në rastet kur pajtimtari kërkon që mosmarrëveshja e tij me sipërmarrësin të zgjidhet nga AKEP.

Gjatë vitit 2014 janë trajtuar **14** ankesa për zgjidhje të mosmarrëveshjeve midis pajtimtarit dhe sipërmarrësit, në kuadër të pjesëmarrjes në KZM.

### 🚧 **Zhvillimi i shërbimeve me brez të gjerë dhe Administrim i sistemeve cctld .al**

Në vitet e fundit Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshem në zhvillimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve broadband për pajtimtarët.

Numri i operatorëve që ofrojnë shërbime broadband dhe internet nëpërmjet rrjeteve fikse të komunikimeve elektronike aktualisht është rreth 80 ndërsa kemi 4 operatorë që ofrojnë shërbime broadband nëpërmjet rrjeteve mobile.

Numri i pajtimtarëve të cilët kanë akses në internet broadband nga rrjetet fikse deri në fund të 2014 është 206 mijë ndërsa akses në internet broadband nga rrjetet mobile 3G kanë rreth 1 milion pajtimtarë.

Vlen të theksohet se pikë kyç për zhvillimin e mëtejshëm të broadband janë rrjetet e komunikimeve elektronike të bazuara në fibër optike.

Aktualisht në Shqipëri janë të instaluara afërsisht 5000 km fibra optike në rrugë kryesore ndërrurbane dhe në zona urbane deri në fund të vitit 2014.

Nr. domain-eve të regjistruar për vitin 2014 është **4960** dhe kemi një numër total prej **13760** domain-e.

Me vendimin nr.2513, datë 06.11.2014 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”

Këto ndryshime i dhanë një nxitje të metejshme regjistrimit të domain-eve nëpërmjet regjistruarëve të akredituar dhe gjithashtu u mundësoi të gjithë subjekteve që kanë domain-e të regjistruar pranë AKEP të zgjidhnin regjistruarët e preferuar dhe të kalonin domain-et e tyre tek regjistruarët preferencialë. Ky proces u realizua nëpërmjet kështimit publik me sipërmarrësit dhe të interesuarit.

Aktualisht që nga muaji maj 2013 janë 5 regjistrare të autorizuar nga AKEP.

### **Nderhyrja legjislative:**

Nisur nga fakti që Ligji nr.9918/2008 ka implementuar pjesërisht Direktivën 2002/21/EC<sup>1</sup> (CELEX 32002L0021) e amenduar, si dhe dy Rregulloret e KE dhe Këshillit, dhe nga fakti se ende ka mospërputhshmëri midis legjislacionit të brendshëm dhe parashikimeve të Direktivës si dhe akteve të tjera rregullatore europiane në këtë fushë, sugjerojmë propozimin e ndryshimeve në ligjin ekzistues të cilat synojnë një përafrim të plotë me standartet dhe parimet e BE në fushën e komunikimeve elektronike.

Konkretisht sjellim në vëmendjen tuaj se Direktiva kuadër 2002/21/EC (CELEX 32002L0021) e amenduar parashikon qartësisht se në përputhje me parimin e ndarjes së funksioneve rregullative dhe operacionale, shtetet duhet të garantojnë pavarësinë e autoritetit kombëtar rregullator me qëllim për të siguruar paanshmërinë e vendimeve të tyre. Kjo kërkesë e pavarësisë nuk

---

<sup>1</sup> Directive 2002/21/EC of the European Parliament and of the Council of 7 March 2002 on a common regulatory framework for electronic communications networks and services (Framework Directive)

paragjykon autonominë institucionale dhe detyrimet ligjore e nënligjore të tyre. Autoritetet kombëtare rregullatore duhet të kenë në posedim të gjitha burimet e nevojshme, për sa i përket stafit, ekspertizës dhe mjeteve financiare, për kryerjen e funksioneve të tyre.

Përvec Direktivës kuadër, një dokument shumë i rëndësishëm dhe i qënësishëm është Raporti i fundit i CULLEN për një analizë të plotë të situatës së disa vendeve “enlargement countries monitoring Report” i Shkurtit 2014, ku theksohet se :

“Kuatru rregullator i BE-së në mënyrë eksplicite njih buxhetin dhe burimet e financimit si kusht thelbësor për garantimin e pavarësisë si dhe mjaftueshmërinë e burimeve të tyre financiare dhe kapaciteteve njerëzore, për t’u mundësuar atyre kryerjen e funksioneve të përcaktuara për ta. Burimet financiare në dispozicion janë aspekte veçanërisht të rëndësishme dhe mundësojnë për të tërhequr, punësuar dhe mbajtur personel të kualifikuar administrativ në mënyrë që tu mundësohet ushtrimi sa më efektiv i kompetencave të tyre.

Vihet re një tendencë shqetësuese në kundërshti me kërkesat e BE-së – thekson Raporti –, “ku tentohet të vendosen masa që kufizojnë të drejtat e Organeve rregullatore mbi Buxhetet e tyre, si dhe mundësitë ligjore për të vendosur mbi strukturat dhe nivelet e pagave të stafit të tyre”

## II. RAPORTI I PUNËS SË AKEP PËR VITIN 2014


### 2.1. ZHVILLIMI I TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE


#### 2.1.1 Tregues Financiarë të sektorit

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2013 ishin rreth 50206 milion leke, të cilat përbëjnë një rënie me 9% në krahasim me vitin 2012. Peshën kryesore të këtyre të ardhurave e zënë ato që vijnë nga shërbimet e ofruara nëpërmjet rrjeteve celulare, të cilat për 2013 janë rreth 74 % të të ardhurave totale të sektorit, ndërsa të ardhurat e gjithë sipërmarrësve të rrjeteve fikse (Albtelecom Fiks + OA) zënë rreth 26% të të ardhurave të sektorit.

Sipas të dhënave, të ardhurat totale të sipërmarrësve për vitin 2014 ishin rreth 41632 miliard lek, që përbën një reduktim me 17 përqind nga viti 2013.

**Figura 1: Të ardhurat totale të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike (2013-2014)**





*Burimi: Te dhenat e operatoreve te deklaruar ne AKEP*

Struktura e të ardhurave sipas sipërmarrësve në 2014 nuk ka ndryshime të dukshme nga 2013. Katër sipërmarrësit më të mëdhenj zotërojnë rreth 93% të të ardhurave të sektorit ndërsa operatorët alternativë 7%. Të ardhurat e sipërmarrëve më të mëdhenj janë reduktuar ndjeshëm në 2014, gje që ka cuar edhe në reduktim të të ardhurave të sektorit. Të ardhurat e operatorëve celularë në 2014 u reduktuan me 13%, nga 37 miliard lek në 2013 në 32 miliard lek në 2014.

### 2.1.2 Shërbime të rrjeteve Celulare

Tabela e mëposhtme paraqet disa tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2012-2014 dhe normën e ndryshimit vjetor të tyre.

**Tabela 1.2: Tregues kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2012-2014**

Treguesi	2012	2013	2014	Ndryshimi vjetor %
<b>Numri i përdoruesve aktive</b>	3,537,285	3,685,983	3,370,970	-9%
<b>Numri i përdoruesve sipas kartave SIM</b>	5,619,607	5,282,350	4,883,843	-8%
<b>Numri pajtimtarëve që kanë përdorur akses në Internet broadband UMTS në total:</b>	649,713	1,231,259	1,425,384	16%
<b>nëpërmjet aparatit celular</b>	594,308	1,119,892	1,253,485	12%
<b>nëpërmjet USB(jo aparate celulare)</b>	55,405	111,367	177,613	59%
<b>Thirrje telefonike (dalëse)të gjeneruara nga përdoruesit (minuta)</b>	6,053,089,264	6,769,300,966	7,301,024,035	8%
<b>Numri i mesazheve SMS të gjeneruara</b>	1,382,610,330	1,689,200,882	1,826,346,190	8%



<b>Volumi total i të dhënave të transmetuara me GPRS/UMTS (Gbyte)</b>	796,000	2,529,549	6,269,940	148%
<b>Thirrje hyrëse nga rrjete të tjera (minuta)</b>	1,046,035,623	990,247,214	1,061,412,059	7%
<b>thirrje hyrëse kombëtare</b>	290,628,294	335,122,643	596,861,301	78%
<b>thirrje hyrëse ndërkombëtare</b>	755,407,329	655,124,571	464,550,758	-29%
<b>SMS hyrëse nga rrjete të tjera (terminim SMS)</b>	75,084,782	75,386,098	111,100,522	47%

Nga të dhënat e tabelës vihet re se të numri i përdoruesve të shërbimeve bazë GSM ka rënie me 8-9%, ndërkohë që treguesit e volumit të shërbimeve të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS janë me rritje 8-47%. Thirrjet hyrëse ndërkombëtare kanë reduktim me 29%, ndërkohë që terminimi i thirrjeve nga rrjetet kombëtare ka rritje me 78%, e cila vjen rritja e trafikut off-net. Treguesit volumit të shërbimeve 3G janë të gjithë me rritje. Numri i përdoruesve të këtyre shërbimeve është rritur me 16%, ndërsa volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare me GPRS/UMTS është rritur me 148%.

### ➤ Numri i përdoruesve celularë


Numri i përdoruesve celularë matet dhe raportohet në dy mënyra:

- Numri i përdoruesve sipas kartave ‘SIM aktive’ që i referohet numrit të kartave SIM që janë aktive<sup>2</sup> në rrjet celular në fund të periudhës së raportimit;
- Numri i ‘përdoruesve aktivë’ që janë përdorues të kartave SIM që kanë përdorur shërbime celulare në 3 muajt e fundit

Numri i përdoruesve celularë aktivë në fund të vitit 2014 arriti në 3.4 milion, krahasuar me 3.7 milion në fund të vitit 2013, pra një reduktim me 9%. AMC dhe Vodafone patën reduktim të numrit të përdoruesve aktive me 19% dhe 7% respektivisht, ndërsa Altelecom (EM) dhe Plus patën rritje me 2% dhe 18% respektivisht. Figura e mëposhtme, paraqet ecurinë e numrit të përdoruesve celularë aktivë në periudhën 2010-2014.


<sup>2</sup>Secili operator ka politikën e veta se kur një kartë SIM (me parapagim) është aktive (që mund të kryejë komunikim) në varësi të kohës së rimbushjes apo përdorimit të fundit të saj.

**Figura 2: Ecuria e numrit të përdoruesve celularë aktiv 2010-2014**



Në fund të vitit 2014, numri i përdoruesve të telefonisë së lëvizshme sipas kartave SIM aktive, arriti në 4.9 milion krahasuar me 5.3 milion në fund të vitit 2013. Ndryshimi përbën një rënie vjetore prej 7.6%, dhe ai varion sipas operatorëve: AMC dhe Vodafone patën rënie me 8 dhe 12% respektivisht, Plus pati 12% rritje, ndërsa numri i pajtimatrëve sipas këtij treguesi të Albtelecom (Eagle Mobile) ishte pothuajse i pandryshuar (reduktim me 0.1%).

**Figura 3: Ecuria e numrit të përdoruesve celularë sipas kartave SIM 2000-2014**



Proporcioni i përdoruesve aktive ndaj kartave SIM aktive është në nivel 69% për të katër operatorët së bashku, duke variuar nga 59% për AMC në 79% për Vodafone. Norma e penetrimit (përdorues për 100 banorë) në fund të vitit 2014 ishte 119% për përdorues aktive (krahasuar me 130% në 2013) dhe 172% sipas kartave SIM (krahasuar me 187% në 2013). Të dy treguesit e matjes së numrit të përdoruesve celularë janë me rënie në 2014, e cila mund të ketë ardhur për shkak të reduktimit të zotërimit të disa kartave SIM nga përdoruesit.

Në vitin 2014 është vënë re rritje e përqindjes së numrit të përdoruesve me parapagim në krahasim me vitin 2013. Tabela e mëposhtme paraqet peshën që zënë përdoruesit me kontratë në numrin total të përdoruesve, aktivë dhe sipas kartave SIM. Në fund të vitit 2014 përdoruesit me parapagim përbënin 92% të numrit total të përdoruesve aktivë celularë krahasuar me 87% në 2013 dhe 94 % të numrit të përdoruesve sipas kartave SIM aktive, krahasuar me 91% në 2013.

**Tabela 4: Struktura e përdoruesve celularë Kontratë/Parapagim (2013-2014)**


		<b>AMC</b>	<b>Vodafone</b>	<b>Eagle Mobile</b>	<b>Plus</b>	<b>Total</b>
		Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim	Kontratë/parapagim
<b>Përdorues Aktiv</b>	2013	13% / 87%	7% / 93%	24% / 76%	44% / 56%	13% / 87%
	2014	5% / 95%	7% / 93%	22% / 78%	11% / 89%	8% / 92%
<b>SIM Aktivë</b>	2013	9% / 91%	5% / 95%	15% / 85%	31% / 69%	9% / 91%
	2014	3% / 97%	5% / 95%	14% / 86%	8% / 92%	6% / 94%

Vodafone me numrin më të madh të përdoruesve celularë, ka vetëm 5-7% përdorues me kontratë dhe 93-95% me parapagim dhe nuk ka ndryshim në krahasim me 2013. AMC ka pasur ndryshim të madh të këtij treguesi nga 87-91% përdorues me parapagim në 2013 në 95-97% në 2014. Ndryshimin më të madh në strukturën e përdoruesve e ka pasur Plus: nga 56-69% përdorues me parapagim në 2013 ky tregues ka arritur në 89-92% në fund të 2014. Rritja e përqindjes së përdoruesve me parapagim vlerësohet të ketë ardhur nga migrimi i përdoruesve me kontratë në përdorues me parapagim për shkak të ofertave/paketave më atraktive me cmime më të favorshme për përdoruesit me parapagim se sa për përdoruesit me kontratë.

➤ **Trafiku telefonik dhe struktura e thirrjeve**

Gjatë vitit 2014 thirrjet dalëse të përdoruesve celularë u rriten me 8% në krahasim me vitin 2013. Rritjen më të madhe e kanë pasur Altelecom (EM) dhe Plus me 69% dhe 58% respektivisht, ndërsa Vodafone dhe AMC kanë pasur rritje me 6% dhe reduktim me 6% respektivisht. Gjatë vitit 2014 për herë të parë u vu re reduktim i sasisë së thirrjeve brenda rrjetit, me 3% në krahasim me vitin e mëparshëm. Reduktimi ka ndodhur tek AMC me 12 dhe Vodafone me 2%, ndërkohë

që Albtelecom dhe Plus kanë rritje me 22 dhe 36%. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombetare (off-net) ka pasur rritje me 72%, ku rritjen më të madhe e kanë pasur Albtelecom dhe Vodafone me 128% dhe 89% përkatësisht. Ndërkohë rritjen më të madhe e ka pasur trafiku (thirrjet) dalës ndërkombëtar, i cili gjatë vitit 2014 u rrit më shumë se 4 herë në krahasim me vitin 2013. Rritja varin nga rreth 3 here tek AMC dhe Vodafone në 8-12 herë tek Albtelecom dhe Plus. Këto ndryshime kanë sjellë dhe ndryshim të strukturës së trafikut dalës gjatë vitit 2014 sic mund të vihet re nga grafiku i mëposhtëm:



Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse u reduktua në 83% në 2014 krahasuar me 93% në 2013. Pesha e këtyre thirrjeve për Vodafone dhe AMC në 2014 ishte 87-88% krahasuar me 94-95% në 2013. Edhe tek Albtelecom dhe Plus është venë re reduktim i peshës së këtyre thirrjeve nga 78-79% në 2013 në 58-67% në 2014. Thirrjet ndërkombëtare kanë pasur rritjen më të madhe në 2014 dhe pesha e tyre arriti në 8% krahasuar me 2% në 2013. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare pati rritje në 2014 dhe pesha e tyre në totalin e thirrjeve dalëse celulare, arriti në 8% në 2014 krahasuar me 5% në 2013. Megjithë ndryshimet e mësipërme, përqindja e thirrjeve brenda rrjetit ndaj thirrjeve drejt rrjeteve celulare kombëtare (brenda dhe jashtë rrjetit) për AMC dhe Vodafone në 2014 ishte 93-95% krahasuar me 95-97% në 2013.

Struktura e trafikut dalës tregon se edhe në 2014 ka vazhduar tendenca e viteve të fundit dhe përdorim i madh i paketave tarifore me tarifa shumë të ulëta për thirrjet brenda rrjeteve por me reduktime të moderuara të tyre dhe rritje të ofertave të thirrjeve jashtë rrjetit dhe sidomos me rritje të mëdha të ofertave për thirrjet dalëse ndërkombëtare.

Pesha e thirrjeve brenda rrjetit ndaj totalit të thirrjeve dalëse u reduktua në 83% në 2014 krahasuar me 93% në 2013. Pesha e këtyre thirrjeve për Vodafone dhe AMC në 2014 ishte 87-88% krahasuar me 94-95% në 2013. Edhe tek Albtelecom dhe Plus është venë re reduktim i peshës së këtyre thirrjeve nga 78-79% në 2013 në 58-67% në 2014. Thirrjet ndërkombëtare kanë

pasur rritjen më të madhe në 2014 dhe pesha e tyre arriti në 8% krahasuar me 2% në 2013. Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare pati rritje në 2014 dhe pesha e tyre në totalin e thirrjeve dalëse celulare, arriti në 8% në 2014 krahasuar me 5% në 2013. Megjithë ndryshimet e mësipërme, përqindja e thirrjeve brenda rrjetit ndaj thirrjeve drejt rrjeteve celulare kombëtare (brenda dhe jashtë rrjetit) për AMC dhe Vodafone në 2014 ishte 93-95% krahasuar me 95-97% në 2013. Struktura e trafikut dalës tregon se edhe në 2014 ka vazhduar tendenca e viteve të fundit dhe përdorim i madh i paketave tarifore me tarifa shumë të ulëta për thirrjet brenda rrjeteve por me reduktime të moderuara të tyre dhe rritje të ofertave të thirrjeve jashtë rrjetit dhe sidomos me rritje të mëdha të ofertave për thirrjet dalëse ndërkombëtare.

### ➤ Të ardhurat e operatorëve celularë

Të ardhurat e operatorëve celularë në 2014 u reduktuan me 13%, nga 37 miliard lek në 2013 në 32 miliard lek në 2014. Rënien më të madhe e patën Plus dhe Vodafone me 16-17%, ndërsa Albtelecom dhe AMC patën rënie të vogla me 6-7%. Pjesa e tregut e Vodafone u reduktua nga 50% në 2013 në 47% në 2014.

**Figura 5: Ecuria e të ardhurave të operatorëve celularë 2004-2014<sup>3</sup>**



<sup>3</sup>Të ardhurat totale janë në milion lek dhe i referohen të ardhurava nga komunikimet elektronike sipas deklarimeve të operatorëve celularë në modulën on-line të AKEP.

Të ardhurat e operatorëve celularë gjenerohen nga dy grupe të përgjithshme: të ardhura nga shërbimet me pakicë dhe të ardhura nga shërbimet me shumicë (interkoneksioni dhe roaming ndërkombëtar). Të ardhurat nga shërbimet me pakicë u reduktuan me 9%, nga 21 miliard lek në 2013 në 19 miliard lek në 2014. Reduktimi varion nga 6% për Vodafone në 18% për Plus. Vodafone ka rritur pjesën e tregut në të ardhura me pakicë nga 51% në 2013 në 54% në 2014.

Të ardhurat nga shërbimet me shumicë të operatorëve celularë për vitin 2014 u reduktuan me 17% në krahasim me vitin 2013. Në këtë rënie ka ndikuar rënia me 34% e të ardhurave nga shërbimet me shumicë të Vodafone, dhe me 15% e të ardhurave të Plus, ndërkohë që të ardhura me shumicë të AMC dhe Altelecom kanë pasur ndryshime shumë të vogla. Proporcioni i të ardhurave nga shërbimet me shumicë për 2014 ishte mesatarisht 41% e të ardhurave totale të katër operatorëve, me variancë të vogël midis AMC, Altelecom dhe Plus në nivele 46-48%, ndërkohë që ky proporcion për Vodafone ishte 33%.

### ➤ **Pjesët e tregut**

Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e pjesëve të tregut për 2010-2013 për numër pajtimtarësh, thirrje dalëse, SMS dhe të ardhura. Nga të dhënat vihet re se:

Për treguesit e numrit të përdoruesve:

- AMC në 2014 ka humbur 4 pikë përqindje në pjesën e tregut për përdorues aktive, ndërsa tre operatorët e tjerë kanë rritur pjesët e tregut me nga 1-2 pikë përqindje pjesët e tyre të tregut: Vodafone duke arritur në 46%, EM në 13%, dhe Plus në 8%.
- Vodafone në 2014 ka pasur reduktim me 2 pikë përqindje në pjesën e tregut të përdoruesve të kartave SIM, e cila ka shkuar në rritje me 1 pikë përqindje të pjesëve të tregut të EM dhe Plus, ndërsa AMC nuk ka ndryshim në pjesën e tregut të këtij treguesi.
- Pjesët e tregut të përdoruesve me kontratë kanë ndryshime të ndjeshme, ku AMC dhe Plus kanë reduktime me 17 dhe 10 pikë përqindje të pjesëve të tregut, ndërsa Vodafone dhe EM kanë rritje me 15 dhe 13 pikë përqindje respektivisht.
- Pjesët e tregut të thirrjeve dalëse në 2014 në krahasim me 2013 tregojnë për rritje nga 7 në 11% të Altelecom (EM) dhe nga 3 në 5% për Plus, ndërkohë që AMC ka reduktim nga 39 në 34% dhe Vodafone reduktim me 1 pikë përqindje, duke zotëruar 50% pjesë tregu të thirrjeve dalëse në 2015.
- Pjesa e tregut e Vodafone për SMS është reduktuar me 7 pikë përqindje por Vodafone vazhdon të ketë një pjesë tregu të lartë prej 66%. Plus dhe Altelecom (EM) kanë rritje të pjesëve të tregut me 4 dhe 5 pikë përqindje, ndërsa AMC ka reduktim me 2 pikë përqindje.
- Pjesa e tregut në të ardhura e Vodafone për 2013 rezulton të jetë 47% që përbën rënie nga niveli 50% në 2013. AMC dhe Altelecom (EM) kanë rritje me 2 dhe 1 pikë përqindje në

2014, duke arritur në 35% dhe 12% pjesë tregu respektivisht. Plus edhe në 2014 kishte 6% pjesë tregu në të ardhura si edhe në vitin 2013.

**Tabela 6: Pjesët e tregut celularë për disa tregues kryesorë 2010-2014<sup>4</sup>**

	Viti	AMC	Vodafone	Albtelecom(EM)	Plus Communication	HHI
<b>Përdorues Aktivë</b>	2014	33%	46%	13%	8%	3458
	2013	37%	45%	12%	6%	3574
	2012	40%	42%	12%	6%	3544
	2011	37%	44%	13%	6%	3510
	2010	44%	36%	19%	1%	3594
<b>Përdorues (Karta SIM)</b>	2014	39%	40%	14%	7%	3370
	2013	39%	42%	13%	6%	3490
	2012	33%	36%	25%	5%	3046
	2011	37%	35%	21%	8%	3099
	2010	44%	37%	18%	1%	3630
<b>Përdorues me Kontratë</b>	2014	20%	37%	34%	10%	2969
	2013	37%	22%	21%	20%	2694
	2012	31%	18%	36%	15%	2806
	2011	35%	24%	34%	7%	3006
	2010	43%	30%	27%	0%	3478
<b>Thirrje dalëse</b>	2014	34%	50%	11%	5%	3802
	2013	39%	51%	7%	3%	4180
	2012	39%	50%	8%	3%	4094
	2011	37%	51%	10%	2%	4074
	2010	46%	45%	9%	0%	4222
<b>SMS dalëse</b>	2014	19%	66%	10%	5%	4842
	2013	21%	73%	5%	1%	5796
	2012	20%	73%	6%	1%	5766
	2011	27%	64%	8%	1%	4890
	2010	34%	57%	9%	0%	4486

<sup>4</sup>Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.

<b>Të Ardhura</b>	2014	35%	47%	12%	6%	3614
	2013	33%	50%	11%	6%	3746
	2012	29%	56%	10%	5%	4102
	2011	34%	52%	12%	2%	4008
	2010	40%	48%	12%	-	4048

### ➤ Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor për përdorues celularë në 2010 deri në 2014, sipas dy treguesve të përdoruesve: përdorues aktiv dhe karta SIM aktive. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Këta tregues janë llogaritur për të gjithë trafikun e gjeneruar dhe marrë gjatë periudhës pjestuar me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës (mesatarja e numrit të përdoruesve në fillim dhe në fund të periudhës). Thirrjet dalëse përfshijnë gjithë trafikun e origjinuar nga përdoruesit celularë ndërsa thirrjet hyrëse përfshijnë thirrjet e marra nga përdoruesit, nga rrjete të tjera dhe nga i njëjti rrjet. Përdorimi mujor i SMS i referohet vetëm mesazheve të dërguara. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme për përdorimin mesatar të një përdoruesi celular, i përlogaritur me të dhënat e katër operatorëve celularë. Gjithashtu treguesit janë përlogaritur për numrin e përdoruesve celularë aktiv dhe sipas kartave SIM.

**Tabela 7: Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare 2010-2014<sup>5</sup>**

	2010	2011	2012	2013	2014	Ndryshimi 2014/2013
<b>Përdorues Aktiv</b>						
<b>Thirrje dalëse</b>	110	130	152	156	172	11%
<b>Thirrje të marra</b>	124	147	168	167	168	1%

<sup>5</sup>Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.



<b>MOU*</b>	<b>234</b>	<b>277</b>	<b>319</b>	<b>324</b>	<b>341</b>	<b>5%</b>
<b>SMS</b>	14	19	35	39	43	11%
<b>Përdorues Karta SIM</b>						
<b>Thirrje dalëse</b>	80	83	93	103	120	16%
<b>Thirrje të marra</b>	91	94	103	111	117	5%
<b>MOU*</b>	171	<b>177</b>	<b>195</b>	<b>214</b>	237	11%
<b>SMS</b>	10	12	21	26	30	15%

Siç mund të vihet re nga tabela në vitin 2014 ka rritje të përdorimit të thirrjeve dhe mesazheve SMS. Sasia e minutave dhe mesazheve SMS të gjeneruara (dalëse) mesatarisht gjatë një muaji në 2014 është rritur me 11% në krahasim me 2013 nga një përdorues aktiv dhe me 15-16% nga përdorues të kartave SIM.

Gjatë vitit 2014, një përdorues celular aktiv (që ka kryer komunikim në 3 muajt e fundit) ka kryer mesatarisht 172 minuta thirrje dalëse dhe ka marrë 168 minuta thirrje hyrëse, duke rezultuar në 341 minuta komunikim thirrje telefonike në muaj dhe ka dërguar 43 SMS në muaj. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit të kartave SIM aktive: 120 minuta dalëse, 117minuta hyrëse, apo 237 minuta komunikim thirrje dhe 30 SMS në muaj.

AKEP gjykon se minutat reale të përdorimit mesatar janë më afër treguesve të matur me përdorues aktivë, pasi një numër i konsiderueshëm pajtimtarësh të kartave SIM janë vetëm përdorues sezonalë apo sporadikë (emigrantë, vizitorët që përdorin karka SIM të operatorëve celularë shqiptarë gjatë qëndrimit të përkohëshëm apo vizitave në Shqipëri).

### ➤ **Tarifat celulare**

Tregues të tarifave celulare apo të shpenzimeve të përdoruesve celularë përfshijnë treguesit e ARPU<sup>6</sup> dhe ARPM<sup>7</sup>, që masin të ardhurën mesatare të operatorëve (shpenzimin mesatar të

<sup>6</sup>ARPU (Average Revenue Per Users-E Ardhura Mesatare Për Përdorues): E ardhura mesatare për përdorues e matur si raporti i të ardhurave në retail të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktive) gjatë një viti.

<sup>7</sup>ARPM (Average Revenue Per Minute-E Ardhura Mesatare Për Minutë): Treguesi i ARPM llogaritet nga AKEP në baze të të dhënave që dergojnë operatorët për të ardhurat dhe thirrjet telefonike. Për shkak të ofertave/shportave që kanë një pagesë fikse dhe përfshijnë përveç thirrjeve edhe SMS dhe kapacitet Internet, vlerat e këtij treguesi mund të

përdoruesve) për përdorues dhe për minutë. ARPM apo e ardhura mesatare për minutë tregon cmimin që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike, ndërsa ARPU tregon sa lek shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj. Vlerat e këtyre treguesve për periudhën 2010-2014 janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 8: Ecuria e ARPM dhe ARPU 2010-2014**

	ARPM (Lek/minute)	ARPU (Lek/vit)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndryshimi Vjetor (%)
<b>2010</b>	6.49	8,594		
<b>2011</b>	5.35	8,319	-18%	-3%
<b>2012</b>	3.92	7,132	-27%	-14%
<b>2013</b>	3.13	5,863	-20%	-18%
<b>2014</b>	2.63	5,447	-16%	-7%

*Shënim: Vlerat pa TVSH*


Nga tabela vihet re se ARPM dhe ARPU kanë tendençë rënëse dhe për vitin 2014 vlerat e tyre janë reduktuar me 16% dhe 7% respektivisht. Në vitin 2014 një përdorues celular ka paguar mesatarisht 3.16 lek/minutë (me TVSH) për thirrjet telefonike dhe ka shpenzuar mesatarisht 545 lek/muaj (me TVSH) për shërbime celulare.

Niveli i këtyre treguesve në Shqipëri është shumë më i ulët se niveli mesatar në vendet e BE dhe ndër më të ulëtit në rajon. ARPM për Shqipërinë ishte në nivelin 2.2 eurocent në vitin 2013 dhe 1.9 eurocent në 2014. Nga krahasimi duket se Shqipëria ka ARPM të njëjtë me vlerat më të ulëtat të ARPM në vendet e BE në 2011, Lituania me 1.9 eurocent dhe Rumania me 2.2 eurocent. Nderkohe mesatarja e BE në 2011 ishte 9.1 eurocent, apo rreth 5 herë më e lartë se ARPM e Shqipërisë në 2014.

---

mos pasqyrojnë sakte të ardhurën mesatare retail për një minutë thirrje, megjithatë ai është një tregues i përafërt dhe mund të konsiderohet vlera maksimale kur si të ardhura përdoren të ardhurat totale retail


**Tabela 9: ARPM në vendet e BE dhe Shqipëri (2011/2014)**



Burimi: KE, Digital Agenda Scoreboard dhe AKEP

ARPU tregon tendencë të ngjashme me ARPM, të vendeve të BE me njera tjetrën dhe të Shqipërisë në krahasim me vendet e BE. ARPU në Shqipëri ishte 42 euro/vit në 2013 e njëjtë me nivelin më të ulët në BE (Latvia) dhe në 2014 RPU në Shqipëri arriti në 39 euro. Niveli mester i ARPU në BE në 2012 ishte 187 euro apo rreth 5 herë më e lartë se ARPU e Shqipërisë në 2014.

**Tabela 10: ARPU në vendet e BE dhe Shqipëri (2012/2014)**



Burimi: KE, Digital Agenda Scoreboard dhe AKEP

Treguesit e mësipërm janë matës të nivelit mesatar të shpenzimeve të përdoruesve celularë. Sic është evidentuar edhe në analizën e tregut celular në 2014, tarifat celulare kanë diferenca të

mëdha midis tarifave të aplikuara në paketat standarde dhe ofertave/shportave të vecanta të konsumit:

- Oferta/opsionet kanë ulje shumë të mëdha për thirrje brenda rrjetit dhe shume më pak për off-net;
- Tarifat standarde janë shumë të larta në krahasim me ofertat/opsionet;
- Programet tarifore me kontrate kane shpesh minuta pa limit (ose me mijra minuta ne muaj-realisht pa limit) brenda grupeve (institucion, biznes) qe jane falas ose me pagese fikse shumë të vogël .

Gjatë vitit 2014 e në vazhdim, si rrjedhojë e masave të marra nga AKEP për tarifën e terminimit dhe masat e propozuar në analizën e tregut celular, ka pasur zhvillime pozitive në drejtim të rritjes së sasisë së minutave off-net të përfshira në paketa, ofrimin e paketave/opsioneve pa dallim të thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit celular të cilat kanë cuar dhe në ndryshim të strukturës së thirrjeve dalëse të evidentuara në seksionet e mëparshme. Ndryshime janë bërë edhe në programet tarifore standarde me parapagim, ku shumica e tyre tashmë nuk bëjnë diferencim të tarifave brenda dhe jashtë rrjetit celular, por niveli i këtyre tarifave është shumë i lartë dhe varion nga 26 në 39 lek/minutë me TVSH, që janë shumë më të larta se cmimi mesatar për minutë 3.16 lek i aplikuar në 2014. Masat rregulluese të vendosura nga AKEP në vijim të analizës së tregut celular në 2014 synojnë të adresojnë këtë problematikë në tregun celular në Shqipëri.

### **2.1.3. Telefonia fikse**

#### **➤ Numri i pajtimtarëve**

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2014 arriti në rreth 247 mijë, që përbën një reduktim me 12% në krahasim me vitin 2013. Rënia ka ardhur për shkak të vazhdimit të reduktimit të numrit të pajtimtarëve të Altelecom, me 13% si dhe rënies me 9% të numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë. Norma e pënetimit për telefoninë fikse arriti në 8.7%, që është shumë më e ulët se në vendet e BE apo edhe të rajonit. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe Altelecom dhe operatorëve alternativë në periudhën 2000-2014.

**Figura 11: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2014**





Tabela e mëposhtëme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të operatorëve kryesorë në periudhën 2010-2014. Nga të dhënat vihet re se Altelecom dhe AMC (telefoni fikse nga rrjet celular) kanë pasur reduktim me 13% dhe 63% respektivisht, ndërsa Abcom dhe Nisatel kanë pasur rritje me 14 dhe 29% respektivisht.

**Tabela 12: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse 2010-2013**

	Altelecom	Abcom	ASC	Nisatel	AMC Fiks	OA te tjere	Total
<b>2010</b>	277,763	19,975	7,408	5,900	NA	20,456	331,502
<b>2011</b>	258,943	27,167	10,129	4,950	7,565	30,090	338,844
<b>2012</b>	230,397	33,000	7,649	5,500	6,119	28,996	311,661
<b>2013</b>	210,382	13,680	15,047	7,166	6,950	27,975	281,200
<b>2014</b>	182,591	15,531	15,047	9,236	2,550	22,115	247,070
<b>Ndryshimi 2014/2013</b>	-13%	14%	0%	29%	-63%	-21%	-12.1%


Figura e mëposhtme paraqet pjesët e tregut të operatorëve kryesorë të telefonisë fikse, ku vihet re Albtelecom ka 7% pjesë tregu në 2014, ndërsa dy operatorët më të mëdhenj alternativë, ASC dhe Abcom, kanë secili 6% pjesë tregu.

**Figura 13: Pjesët e tregut të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2010-2014**




Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 41% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në Tiranë. Qarqet me penetrim më të madh të telefonisë fikse janë Tirana, Vlora, Gjirokastra dhe Korca me 11-13.4%, ndërsa qarqet me penetrim më të ulët janë Kukësi dhe Dibra me më pak se 3%.

**Figura 14: Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse sipas qarqeve 2014**



**Figura 15: Norma e penetrimit e linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve 2014**



#### ➤ Tarifat e telefonisë fikse

Gjatë vitit 2014 ka vazhduar tendenca viteve të fundit të operatorëve të telefonisë fikse për promovim të paketave tarifore me përfshirje minutash thirrje telefonike në pajtim mujor (bundles of minutes) si dhe kombinim të shërbimeve të telefonisë dhe aksesit në Internet (bundles of services). Dy operatorët më të mëdhenj alternativë, Abcom dhe ASC, tradicionalisht janë ofrues

të shërbimeve akses në internet, telefoni dhe transmetim të shërbimeve televizive, dhe ofrojnë dhe paketa të integruara më të tre shërbimet në një shportë dhe me tarifë mujore të përbashkët. Gjatë vitit 2014 edhe Albtelecom filloi ofrimin e paketave trefishe, Telefoni, Akses në Internet dhe IPTV, dhe vihet re se në fund të 2014 rreth 20% e pajtimtarëve familjarë me akses broadband të Albtelecom ishin përdorues të këtyre paketave 3-fishe.

Albtelecom gjatë vitit 2014 kreu rritje të tarifave të disa lloje të thirrjeve telefonike dhe tarifës së pajtimit mujor për kategorinë familjare nga 530 lekë/muaj (me TVSH) në 700 lekë/muaj (me TVSH). Rritja e pajtimit mujor u shoqërua me përfshirje të 60 minutave ndërkombëtare dhe minutave brenda rrjetit Albtelecom në kohë off-peak në pagesën fikse të pajtimit mujor, heqje të tarifës fikse për thirrje si dhe përfshirje të akses në Internet me kapacitet 1GB doëload. Rritja e pajtimit mujor dhe përfshirja e minutave falas në pajtim mujor janë në linjë me mënyrën e tarifimit në vend të tjera të telefonisë fikse dhe që synojnë njëkohësisht të nxisin konsumin e thirrjeve telefonike fikse. Paketa e cituar është një ndër opsionet e paketave tarifore të Albtelecom, pasi sic është vënë në dukje më sipër Albtelecom ofron një sërë paketash tarifore dhe opsione (shporta me minuta) të integruar në dy apo dhe 3 dhe 4 shërbime të komunikimeve elektronike. Shërbimet e integruara dhe alternativat tarifore të Albtelecom tregojnë për rritje të fleksibilitetit dhe inovacionit të Albtelecom në ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe shërbimeve të reja në kushtet e migrimit drejt rrjetit NGN/NGA të Albtelecom. Shërbimet trefishe (Internet, TV dhe Telefoni fikse) tashmë janë shërbimet më atraktive në treg nga Albtelecom dhe operatorët e tjerë kryesore alternativë si Abcom, ASC dhe Abissnet.


#### **2.1.4. Aksesimi me brez të gjërë në Internet: rrjete fikse dhe celulare**

##### **➤ Numri pajtimtarëve**

Numri pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse në fund të vitit 2014 arriti në rreth 207 mijë, krahasur me 183 mijë në vitin 2013, që përbën një rritje vjetore prej 13.3%. Figura dhe tabela e mëposhtëme parqesin ecurinë e numrit të pajtimtarëve me akses në Internet nga rrjete fikse dhe ndryshimin e tyre për periudhën 2010-2014. Të gjithë operatorët kryesorë të Internetit fiks patën rritje të numrit të pajtimtarëve në 2014. Ndërkohe ASC ka pasur rritje të ndjeshme në vitin 2014 për shkak të blerjes së disa operatorëve më të vegjël.



**Figura 16 Ecuria e numrit të pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse**




**Tabela 17: Ecuria e numrit të pajtimatrëve me akses broadand nga rrjete fikse**

	Albtelecom	Abcom	Abissnet	ASC	OA te tjere	Total Broadband Fiks
<b>2010</b>	70,597	13,575	7,000	5,666	23,162	120,000
<b>2011</b>	60,055	29,321	15,321	10,129	24,871	139,697
<b>2012</b>	66,757	35,870	17,719	11,777	27,965	160,088
<b>2013</b>	73,242	43,430	20,562	15,432	29,890	182,556
<b>2014</b>	82,118	47,480	23,259	26,379	27,660	206,896
Ndryshimi 2013/2014	12%	9%	13%	71%	-7%	13.3%


Për sa i përket pjesëve të tregut vihet re se Albtelecom zotëron vetëm 40% të numrit të pajtimtarëve me akses broadband, duke e ruajtur këtë nivel edhe në 2014. Operatori i dytë më i madh, ABCOM zotëron 23% pjesë tregu. Megjithatë numri i ofruesve të shërbimit të aksesit në Internet është i madh (rreth 80 operatorë aktivë), katër operatorët më të mëdhenj zotërojnë 87% të këtij tregu.

**Figura 18 Ecuria e pjesëve të tregut të aksesit broadband nga rrjete fikse (2010-2014)**



Norma e penetrimit (numri i pajtimtarëve për 100 banorë) të aksesit broadband nga rrjete fikse në fund të vitit 2014 ishte 7.31% krahasur me 6.40% në 2013. Figura e mëposhtme paraqet numrin e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse sipas qarqeve në fuind të vitit 2014. Tirana është qarku që ka normën e penetrimit më të lartë me 12.7%, ndërsa Dibra dhe Kukësi janë qarqet me normën më të ulët nën 3%.

**Figura 19: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas qarqeve (2014)**



Numri i pajtimtarëve celularë që kanë përdorur akses broadband nga rrjetet celulare (3G me karta USB/modem dhe nga aparate celulare) në vitin 2014 ishte 1.4 milion apo 16% më shumë se në vitin 2013. Përdorimi i aksesit broadband nga rrjetet 3G është ritur me 59% për aksesin nëpërmjet USB/Modem dhe me 12% nëpërmjet aparateve celulare. Të tre operatorët celularë të rrjeteve 3G, Vodafone, AMC dhe Albtelecom (EM), kanë pasur rritje të ndjeshme të përdorimit me USB/Modem me 31-124%, ndërsa përdorimi nëpërmjet aparateve celulare ka ndryshime të mëdha me 51% rritje për Vodafone dhe reduktim me 15 dhe 41% për EM dhe AMC.

**Tabela 20: Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur akses broadband 3G 2010-2014**

	AMC		Vodafone		Albtelecom (EM)		Total	
	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular	USB/Modem	Aparat celular
<b>2011</b>	<b>9,000</b>	46,000	<b>25,493</b>	202,756	<b>N/A</b>	N/A	<b>34,493</b>	248,756
<b>2012</b>	<b>17,833</b>	222,882	<b>37,572</b>	371,426	<b>N/A</b>	N/A	<b>55,405</b>	594,308
<b>2013</b>	<b>32,138</b>	279,428	<b>66,086</b>	568,207	<b>13,143</b>	272,257	<b>111,367</b>	1,119,892
<b>2014</b>	61,549	163,797	86,580	858,366	29,484	231,322	<b>177,613</b>	<b>1,253,485</b>
<b>Ndryshimi 2014/2013</b>	92%	-41%	31%	51%	124%	-15%	59%	12%

## **2.2. RREGULLIMI EKONOMIK I TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

### **2.2.1. Analizat e Tregjeve**

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918/2008, dhe Rregullores “Për Analizën e Tregut”, gjatë vitit 2014 kreu proceset e mëposhtme për analizat e tregut:

- ✓ Miratimi i versionit final të Analizës së tregjeve të linjave me qira
- ✓ Miratimi i versionit final të Analizës së tregjeve të aksesit broadband me shumicë dhe LLU
- ✓ Miratimi i versionit final të Analizës së tregut të terminimit të SMS-ve
- ✓ Këshillim publik dhe miratimi i versionit final të Analizës së tregut celular

#### **🚩 Analiza e tregut të linjave me qira:**

AKEP në vijim të procesit të këshillimit publik të kryer në vitin 2013, më 4.02.2014 miratoi dhe publikoi dokumentin final të analizës së tregut të linjave me qira dhe vendimet përkatëse për FNT në tregjet e analizuara. Analiza e tregut të linjave me qira përfshinte analizën e tregjeve përkatës të mëposhtëm:

- (1) Tregu me pakicë i minimumit të linjave me qira (i cili përfshin lloje të specifikuar të linjave me qira deri në dhe përfshirë 2Mbit/sek).
- (2) Tregu me shumicë i segmenteve terminuese të linjave me qira.
- (3) Tregu me shumicë i linjave kryesore (trunk) të linjave me qira.

Në versionin final të dokumentit të analizës së tregut dhe vendimet përkatëse, AKEP arriti në konkluzionin se tregu me pakicë i linjave me qira dhe tregu me shumicë i segmenteve të linjave kryesore (trunk apo backbone) të linjave me qira nuk janë më tregje përkatës të justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, dhe AKEP hoqi detyrimet e mëparshme të Albtelecom për FNT në këto tregje. AKEP në këtë analizë vendosi për përcaktimin e Albtelecom sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira. Ndër arsyet kryesore të AKEP për de-rregullimin e dy tregjeve të cituara më lart (tregjet 1 dhe 2), dhe heqjen e statusit me FNT dhe masave rregulluese për Albtelecom, ishin:

- ✓ Rënia e pjesëve të tregut të Albtelecom në nivel me pakicë dhe ekzistenca e shumë ofruesve të tjerë për shërbime me pakicë të linjave të dedikuara;
- ✓ Rritja e investimeve në rrjete backbone dhe fibra optike nga operatorë të tjerë në treg dhe ekzistenca e alternativave në treg për kapacitete në nivel trunk: nëpërmjet fibrave optike dhe lidhjeve me radiovalë.
- ✓ Ndryshimet teknologjike kanë mundësuar ofrimin e kapaciteteve me qira me teknologji të reja dhe me kosto më të lira.

Përvoja në vendet e tjera ku këto tregje janë hequr nga lista e Komisionit Evropian të tregjeve të justifikueshem për ndërhyrje ex-ante që në vitin 2007.

Me Vendimin nr.2415, datë 4.02.2014, AKEP përcaktoi Altelecom si sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira, që përfshijnë kapacitet që lidhin centralet/nyjet kryesore të rrjetit Altelecom me pikat fundore të rrjetit në adresat e pajtimatrëve të Altelecom, pavarësisht teknologjisë së përdorur për ofrimin e kapaciteteve me qira apo të dedikuara. Masat rregulluese për FNT të Altelecom përfshijnë detyrimet për transparencë, mos-diskriminim, akses, rregullim tarife, orientim në kosto, ndarje llogarish (AS/CA<sup>8</sup>).

Detyrimet e Altelecom për akses në segmentet terminuese të linjave me qira përfshijnë dhe ofrimin e linjave me qira (kapaciteteve) me shumicë mbi Ethernet në rrjet tradicional dhe/ose NGN<sup>9</sup>, akses në linja me qira për lidhje të nyjes së agregimit të linjave lidhëse të MSAN<sup>10</sup>-ve me MSAN-n përkatës, si shërbim ndihmës për operatorin që kërkon akses në MSAN për LLU. Detyrimet për linja me qira tradicionale përfshirë Ethernet në rrjet tradicional do të jenë të përkohëshme deri në përfundim të fazës tranzitore të bashkëzistencës së rrjetit tradicional fiks dhe NGN dhe sipas mundësive teknike të Altelecom.

#### **Analiza e tregut me shumicë të aksesit broadband:**

AKEP në vijim të procesit të këshillimit publik të kryer në vitin 2013, më 4.02.2014 miratoi dhe publikoi dokumentin final të analizës së tregut me shumicë të aksesit broadband dhe vendimet përkatëse për FNT në tregjet e analizuara. Analiza e tregut të aksesit broadband me shumicë përfshinte analizën e tregjeve përkatës të mëposhtëm:

- (i) Tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plotë dhe të ndarë - full LLU dhe shared LLU) nga vendodhje fikse.
- (ii) Tregu me shumicë i aksesit broadband (bitstream).

Nëpërmjet dokumentit final të analizës së tregut dhe vendimeve përkatëse, AKEP përcaktoi Altelecom si sipërmarrës me FNT në tregjet e analizuara.

Detyrimet e Altelecom për FNT në tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturë fizike, përfshirë aksesin në qarkun local (LLU) referuar ligjit nr. 9918/2008 përfshijnë:

- ✓ Detyrimi i Mosdiskriminimit (*Neni 39*)
- ✓ Detyrimi i transparencës (*Neni 40*)
- ✓ Detyrimi për ndarjen e llogarive (*Neni 41*)
- ✓ Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (*Neni 42*)
- ✓ Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (*Neni 45*)

---

<sup>8</sup>Account Separation and Cost Accounting

<sup>9</sup>Next Generation Networks-Rrjetet e Gjeneratës Tjetër (të bazuar në sistem protokollit IP)

<sup>10</sup>MSAN-Multi-service access node: nyje në rrjetin fiks të aksesit të gjeneratës tjetër (NGA) që lidhin pjesën kryesore të rrjetit me fibra optike me linjat fundore të telave të bakrit të pajtimtarit. Zëvendësojnë centralet lokale tradicionale.

Detyrimet e Albtelecom për këtë treg përshijnë dhënien e aksesit në linjat fundore të rrjeteit të tij të aksesit për operatorë të tjerë, që këta të fundit të kenë mundësi të ofrojnë shërbime aksesit broadband pajtimtarëve të rrjetit Albtelecom, si dhe akses në infrastrukturë jo-aktive që shërben për të arritur pikat e aksesit të Albtelecom në rrjetin NGA (MSAN-e).

Shërbimi me shumicë i aksesit broadband (bistream) në rrjetin Albtelecom përfshin dhënien e aksesit nga Albtelecom në rrjetin e vet për operatorë të tjerë, që këta të fundit të kenë mundësi të ofrojnë shërbime aksesit broadband pajtimtarëve të rrjetit Albtelecom. Ky shërbim kërkon më pak pika aksesit për operatorët e tjerë, krahasuar me LLU, duke u mundësuar operatorëve të tjerë ofrimin e shërbimeve broadband një grupi më të madh të pajtimtarëve të Albtelecom, pa pasur nevojën e prezencës së operatorëve të tjerë me infrastrukturë të shtrirë afër vendbanimit të pajtimtarëve apo centraleve/nyjeve kryesore të Albtelecom në qytete të ndryshme. Detyrimet e Albtelecom për FNT në tregun me shumicë të aksesit bitstream përfshijnë:

- ✓ Detyrimi i Mosdiskriminimit (*neni 39*)
- ✓ Detyrimi i transparencës (*Neni 40*)
- ✓ Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (*Neni 42*)
- ✓ Detyrimi për kontroll të tarifave (*Neni 45*)

AKEP në detyrimet e përcaktuara për Albtelecom në këtë treg vendosi lënien e detyrimit për akses në shtresën 2 (Ethernet) dhe në shtresën 3 (IP), dhe heqjen e detyrimit për akses bitstream në nivel DSLAM, pasi ky akses është shumë i përafërt me aksesin për LLU. Gjithashtu AKEP hoqi detyrimin e Albtelecom për akses për rishitje, pasi aksesit në nivel IP është shumë afër rishitjes, ndërsa rishitja vetë nuk ka nevojë për shërbime aksesit pasi të gjitha ofrohen nga operatori inkumbent. AKEP vendosi për Albtelecom detyrim të kontrollit të tarifës për shërbimet e aksesit bitstream me metodën e rregullimit “*retail minus*”, si metoda e rekomanduar nga KE dhe BEREC për këto shërbime.

#### **Analiza e tregut me shumicë të terminimit të SMS-ve:**

AKEP në vijim të procesit të këshillimit publik të kryer në vitin 2013, më datë 27.03.2014 miratoi dhe publikoi dokumentin final të analizës së tregut të terminimit të SMS-ve në rrjete individuale celulare. AKEP me Vendimet nr.2438-2441, datë 27.03.2014, përcaktoi katër operatorët celularë si sipërmarrës me FNT për terminimin e SMS-ve në rrjetet e tyre individuale dhe miratoi masat rregulluese përkatëse që përfshijnë reduktimin e tarifës së terminimit të SMS-ve për të katër operatorët nga 1.44 lek/SMS në 1.00 lek/SMS duke filluar nga 1.04.2014, detyrimet e transparencës dhe mos-diskriminimit. Operatorët nuk kanë detyrim për publikim oferte reference dhe u hoq detyrimi për ndarjen e llogarive (AS/CA) për terminimin e SMS-ve.

#### **Analiza e tregut me shumicë të terminimit të thirrjeve dhe tregut me pakicë celular:**

AKEP në vitin 2014 kreu procedurat e analizës së tregut celular që përmbante analizën e tregjeve përkatës të mëposhtëm:

- Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare;
- Tregu me pakicë i shërbimeve celulare.

AKEP publikoi dokumentin e analizës për këshillim publik më 23.07.2014 deri më 24.09.2014, dhe në përfundim të periudhës së këshillimit në AKEP u depozituan komente nga katër operatorët celularë si dhe nga Autoriteti i Konkurrencës. AKEP më 6.11.2014 publikoi versionin final të dokumentit të analizës së tregut celular dhe vendimet përkatëse për FNT dhe masat rregulluese në treg.

Në lidhje me tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve AKEP përcaktoi katër operatorët celularë si operatorë me FNT dhe vendosi që të katër operatorët celularë të vazhdojnë të kenë detyrimet e përcaktuara në 2012 dhe më pas:

- ✓ Mosdiskriminimi (*neni 39*),
- ✓ Transparenca (*neni 40*),
- ✓ Dhenie Akses dhe Interkoneksion dhe perdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (*neni 42*),
- ✓ Kontrolli i tarifave dhe sistemi i mbajtjes së llogarive (*neni 45*)
- ✓ Ndarja e llogarive (*neni 41*)

Nga këto detyrime AKEP vendosi që të kryejë disa ndryshime në detyrimin e ndarjes së llogarive dhe kontrollin e tarifave. Bazuar në problematikën në tregun me pakicë, AKEP gjykoi që detyrimi për ndarjen e llogarive të vazhdojë për Vodafone dhe AMC, për shkak të pozitës që kanë në tregun me pakicë, si dhe për EM (Albtelecom) për shkak se është pjesë e operatorit inkumbent fiks (integrim horizontal). Për Plus ky detyrim konsiderohet i tepërt për shkak të pjesës së vogël të tregut në nivel me pakicë, dhe AKEP vendosi heqjen e këtij detyrimi për Plus.

AKEP duke marrë në konsideratë efektet e mundshme të tarifave në fazën e dytë të përcaktuara në rregullimin e kryer me Vendimet e AKEP më dt. 13.03.2014, përfundimet në analizën e tregut me pakicë, dhe rekomandimet e AK në këshillim publik, vendosi që të kryente disa ndryshime në tarifatat e terminimit të përcaktuara me dt. 13.03.2013:

Tarifa e terminimit e Vodafone, AMC dhe EM të reduktohet me dt. 1.12.2014, në nivelin 1.48 lek/minutë, që përbën tarifën mesatare benchmark për vendet anëtare dhe kandidatet në BE që kanë aplikuar LRIC të pastër në 2013 (të përcaktuar në dokumentin e miratuar më dt. 13.03.2014);

Tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication të qëndrojë 6.52 lek/minutë deri në një vendim tjetër të AKEP.

AKEP, në vijim të rekomandimeve të AK, angazhimeve të mëparshme dhe të procesit të këshillimit publik të MTR (për një analizë më të detajuar të tregut me pakicë celular), dhe mbi të gjitha për përmbushjen e rolit të vet rregullator sipas ligjit 9918, në procesin e analizës së tregut celular në vitin 2014 kreu një analizë më të detajuar të tregut me pakicë celular, për një rregullim sa më efektiv të këtij tregu duke përdorur të gjitha instrumentat ligjore të Ligjit 9918 dhe legjislacionit Shqiptar në tërësi, sidomos të Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës, duke marrë në konsideratë praktikatat më të mira në vendet e BE dhe rajonit me legjislacion të ngjashëm (EU acquis), me qëllimin final maksimizimin e përfitimeve të konsumatorit/biznesit Shqiptar nga shërbimet celulare. AKEP analizoi shumë aspekte të tregut celular me pakicë si:

Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë celulare dhe shërbimeve të reja 3G dhe përfitimet e përdoruesve celularë ku vihet re:

- (1) Rritje e numrit të përdoruesve aktivë megjithëse në terma të moderuar
- (2) Rritje e ndjeshme e përdorimit mesatar të shërbimeve celulare të thirrjeve dhe SMS-ve
- (3) Rritje e ndjeshme e përdorimit të shërbimeve të reja 3G
- (4) Reduktime të shpenzimeve mesatare të përdoruesve celulare për thirrje dhe për SMS
- (5) Rritje të opsioneve për thirrje dhe SMS off-net në muajt e fundit në vijim edhe të reduktimit të tarifave të terminimit nga AKEP në Mars 2013.

#### **Pjesët e tregut të operatorëve celulare për tregues të ndryshëm:**

- Vodafone në 2013 zotëron 45-50% pjesë tregu në përdorues aktivë celulare, thirrje dhe të ardhura;

Pjesët e tregut të Vodafone në numër pajtimtarësh (aktivë dhe SIM) nuk kanë diferencë të madhe nga AMC, si operatori i dytë më i madh, ndërkohë që diferenca rezulton të jetë e madhe në pjesët e tregut në të ardhura, retail dhe totale nga komunikimet elektronike. Ndërkohë AMC ka një pjesë të konsiderueshme të ardhurash nga interesa, dhe diferenca midis Vodafone dhe AMC në pjesë tregu në të ardhura totale të sipërmarrësve (nga komunikimet elektronike dhe të tjera) reduktohet ndjeshëm në 10 pikë përqindje

- Pjesa e tregut e Vodafone në të ardhura totale në 2013 është 50%, që përbën reduktim me 6 pikë përqindje nga 2012;  
Në shumicën (17) e vendeve të BE (27) pjesa e tregut për pajtimtarë e operatorit lider celular në vitin 2012 ishte në nivelin 40% ose më e madhe, si dhe diferenca në pjesë tregu midis operatorit lider dhe operatorit në vend të dytë në 17 vende ishte 9 pikë përqindje (sa diferenca Vodafone-AMC në 2013) ose më shumë;
- Pjesa e tregut e operatorit lider celular për pajtimtarë në të gjitha vendet e rajonit SEE është mbi 40%;

Në Kosovë, Maqedoni dhe Turqi operatori lider ka pjesë tregu në të ardhura më të madhe se 50%, dhe në Mal të Zi, Maqedoni dhe Turqi diferenca në pjesë tregu në të ardhura midis operatorit lider dhe operatorit në vend të dytështë 17 deri në 33 pikë përqindje (ne Kosove është 41 pikë përqindje).

#### **Ecurinë e strukturës së trafikut dalës të operatorëve celularë:**

Trafiku on-net në 2013 përbën 93% të trafikut total celular, një rënie e vogël me 1 pikë përqindje nga 2011 (94%).

Përqindja e lartë e on-net është karakteristike për të katër operatorët celularë, përfshirë operatorët më të vegjël.



Rritja e proporcionit të thirrjeve on-net duket se është tendencë dhe në vende të tjera (studim për 16 vende evropiane tregon se ky proporcion arrin në 70%, dhe në Rumani edhe në 89%).

Të dhënat e gjashtëmujorit të parë 2014 tregojnë për rënie të proporcionit të thirrjeve on-net të dy operatorëve të mëdhenj nga 95% në 2013 në 90% në gjashtëmujorin e parë 2014 dhe deri në 86-88% në Qershor 2014. Kjo tendencë ka vazhduar edhe në tremujorin e tretë 2014, ku proporcioni i thirrjeve on-net të Vodafone dhe AMC është reduktuar në 83-85%.

Ecurinë e tarifave me pakicë ku në tregues të ndryshëm si të ardhurat mesatare për minutë (ARPM), të ardhurat mesatare për përdorues (ARPU), si dhe nivelin dhe strukturën e tarifave me pakicë, duke u fokusuar në tarifatat on-net dhe off-net, tarifatat standarde dhe opsionet/ofertat e operatorëve, nga ku vihet re se:

Në 2010-2013, në të katër rrjetet celulare ka një rënie të treguesit ARPM, që është e adhura për minutë për operatorin apo që mund të konsiderohet si shpenzimi mesatar për një minutë thirrje për përdoruesin. Ky tregues për vitin 2013 ishte 3.75 lek/minutë me TVSH dhe varion nga 3.08 në 6.08 lek/minutë sipas operatorëve.

ARPU-e adhura mesatare për përdorues apo shpenzimi mesatar për një përdorues celular ka qenë në rënie në periudhën 2010-2013 për të katër operatorët celulare dhe duket se vlerat po konvergojnë me njëra tjetrën. Për vitin 2013 ARPU ishte 5863 lek/vit, e cila mund të interpretohet se një përdorues celular në 2013 ka shpenzuar mesatarisht 586 lek/muaj me TVSH. ARPM dhe ARPU e Shqipërisë (mesatare dhe sipas operatorëve) janë në nivelet më të ulëta në rajon dhe BE.

Programet tarifore standarde me parapagim të operatorëve celulare kanë pasur ndryshime të vogla në vite, dhe vihet re se konkurrenca dhe përdorimi janë fokusuar në ofertat, të cilat janë në numër dhe me zbritje të mëdha të tarifave sidomos për grupet e mbyllura dhe brenda rrjetit. Vodafone Club, Whats Up, dhe RiniRing janë treg nga grupet e krijuara brenda përdoruesve me parapagim që kanë oferta me skonto të mëdha për thirrjet brenda tyre.

#### **✚ Strukturat e tarifave dhe planeve tarifore të katër operatorëve kanë ngjashmëri me njëri-tjetrin:**

- Ofrojnë tarifa standarde shumë të larta në krahasim me kostot dhe ofertat/opsionet;
- Oferta/opsionet kanë ulje shumë të mëdha për thirrje brenda rrjetit dhe shumë më pak për off-net;

Programet tarifore me kontratë kanë shpesh minuta pa limit (ose me mijra minuta në muaj-realisht pa limit) brenda grupeve (institucion, biznes) që janë falas ose me pagesë fikse shumë të vogël.

Tarifatat me pakicë në vendet të rajonit si Maqedonia, Mali i Zi, Rumani dhe Italia në shumicën e rasteve nuk kanë dallim on-net/off-net. Tarifatat standarde për përdoruesit me parapagim për një minutë thirrje on-net/off-net në Maqedoni dhe Mal të Zi janë 9-20 lek/minutë me TVSH.

Një nga problemet më evidente është niveli shumë i lartë i tarifave të paketave standarde. Siç mund të vihet re nga tarifatat e dhëna në Aneks 1, tarifa e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare, në programet standarde me parapagim është në nivelin 29-39 lek/minutë që janë:

- deri në 10 herë më të larta se ARPM në 2013: 3.75 lek/minutë me TVSH.
- 1.5-4 herë më të larta se tarifatat standarde në vendet e rajonit.

Këto vlera tregojnë se përdorimi i ofertave është shumë i madh ndërsa i paketave standarde është shumë i ulët. Ofertat kanë zbritje të shumta për tarifatat on-net, duke përfshirë sasi shumë të madhe minutash on-net, dhe njëkohësisht ato janë në numer të madh dhe me kohëzgjatje të madhe, çmimi mesatar i ofertave i bën ato shumë më të favorshme për përdoruesit se paketat standarde. Problematike paraqitet situata edhe për tarifatat e tjera për thirrjet drejt rrjeteve fikse dhe SMS-ve në paketat standarde.

Praktika në vende të tjera të rajonit si dhe më gjerë, tregon se operatorët celularë po përdorin gjithmonë e më shumë tarifa standarde pa dallim on-net/off-net dhe oferta me minuta gjithëpërfshirëse, pa dallim on-net dhe off-net apo dhe drejt fikse. Kjo tendencë, por në shkallë më të ulët, po vihet re dhe në Shqipëri kohët e fundit, madje duke përfshirë dhe minuta ndërkombëtare. Operatorët celularë kanë filluar të reflektojnë reduktimet e tarifave të terminimit në rrjetet e huaja ndërkombëtare duke reduktuar tarifatat e thirrjeve të përdoruesve fundorë, por nuk duket se kanë stimuj të fortë për të bërë të njëjtën gjë me tarifatat e thirrjeve drejt operatorëve konkurrentë celularë brenda vendit.

#### **Praktika në vende të tjera për trajtim të on-net/off net sugjeron për:**

Për qasje të kujdesshme për të rritur përfitimet e konsumatorëve:

- Franca dhe Turqia kanë marrë masa për të rritur përfitimet e ulëta për përdoruesit (penetrim, përdorim i ulët)
- Rumania qasje për ndryshime strukturore në retail nga të katër operatorët pasi ka pasur penetrim dhe përdorim të lartë dhe tarifa të ulëta.
- Në vendet me EC acquis ka ndërhyrë autoriteti i konkurrencës si parandalues i sjelljeve antikonkurrese, dhe këto masa konsiderohen të mjaftueshme pa nevojë ndërhyrje direkt në retail nga rregullatori.

Në disa vende ka ndërhyrë rregullatori me masa në nivel me shumicë.

Testi i tre kritereve tregon se tregu me pakicë celular nuk mund të konsiderohet si i justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante, pasi kriteri II (nuk tenton drejt konkurrencës efektive) dhe III (ligji i Konkurrencës nuk është i mjaftueshëm për rregullim të sjelljeve antikonkurrese) nuk plotësohen.

## Masat rregulluese specifike për problematiken on-net/off-net:

AKEP bazuar në analizën e kryer të shumë treguesve dhe tendencave në Shqipëri dhe vende të tjera si dhe në rekomandimet e AK, gjykohet se:

- duhet të vendosen rregulla detyruese për mos-diskriminim në tarifa me pakicë (on-net dhe off-net) si dhe,
- të ketë një kufizim apo rregullim të mënyrës së aplikimit të ofertave promocioneve që bëjnë operatorët me qëllim rritjen e përdorimit të paketave standarde dhe përfitimeve nga paketat/tarifat standarde.

Me qëllim reduktimin/eliminim e problemit të diskriminimit on-net/off-net AKEP vendosi për aplikimin e detyrimit të mos-diskriminimit të brendshëm (internal non-discrimination) në nivel me shumicë për FNT për terminimin e thirrjeve për të katër operatorët celularë. AKEP formuloi këtë detyrim si më poshtë:

- *Sipërmarrësi (X...) ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare;*
- *Tarifat e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare nuk duhet të jenë më të larta se tarifat e thirrjeve brenda rrjetit;*
- *Sasia e minutave brenda rrjetit të përfshira në oferta/pagesë fikse të paketave tarifore nuk duhet të jetë më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare;*
- *Përcaktimet e pikave 1 dhe 2 më sipër aplikohen për të gjitha paketat tarifore standarte, ofertat, shportat, opsionet dhe skontot të ofruara për pajtimtarët;*

Detyrimi për aplikim të tarifave të njëjta me pakicë on-net/off-net nënkupton që edhe ofertat/shportat/opsionet apo skontot në tërësi duhet të kenë nivel të njëjtë on-net/off-net: tarifa dhe/ose sasi minutash të përfshira në ofertë/pagese fikse.

Aplikimi i detyrimit të mësipërm është i drejtpërdrejtë, i thjeshtë dhe më efikas dhe më proporcional se lidhja e tarifës së terminimit me tarifën mesatare on-net.

Detyrimi i mësipërm pra përfshin detyrimin që operatorët të mos bëjnë dallim në minutat e përfshira në oferta, nëse ato janë on-net apo off-net. Kjo do të reduktonte numrin e ofertave që janë të fokusuar për konsum on-net si dhe në total numrin e ofertave, pasi operatorët do të duhet të jenë me rationale me ofertat.

Njëkohësisht, për shkak se detyrimet e mësipërme mund të anashkalohen përsëri duke përdorur oferta shumë të ulëta, AKEP propozon që të vendosë detyrime për operatorët celularë për sa i përket rishikimit të tarifave të planeve standarde dhe përdorimit të ofertave:

- Secili operator celular duhet që në muajin Janar të çdo viti të paraqesë në AKEP tarifat e planeve standarde dhe ndryshimet e kryera në vitin paraardhës;  
Ofertat/promocionet apo skontot e përkohshme në tërësi;
- Duhet të kenë afat vlefshmërie të përcaktuar qartë që në fillim të aplikimit dhe jo më të gjatë se 3 muaj.
- Operatori nuk duhet të paraqesë të njëjtën ofertë me emër të ndryshuar kur elementi kryesor i saj nuk ka ndryshuar;

- Skontot në oferta që zgjasin më shumë se 3 muaj duhet të përfshihen në paketat/tarifat standarde.

Vendimet e datës 6.11.2014 parashikonin që përcaktimet e mësipërme të jenë detyruese për operatorët celularë duke filluar aplikimin e tyre nga data 1.01.2015. Pas publikimit të vendimeve të AKEP për FNT të operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve dhe masat rregulluese përkatëse, katër operatorët celularë depozituan ankime administrative ndaj vendimeve të AKEP. AKEP me Vendimet nr.2542-2546, datë 13.03.2014 miratoi disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet 2523-2526, datë 6.11.2014:

Përcaktimin e një glide-path (reduktim të përshkallëzuar) në kohë të tarifës së terminimit të Plus sipas tabelës së mëposhtme:

#### ✚ Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (rishikim)

	1.04.2014	1.12.2014	1.04.2015	1.07.2015	1.01.2016
<b>Vodafone/AMC</b>	2.66	1.48	1.48	1.48	1.48
<b>Albtelecom (EM)</b>	4.00	1.48	1.48	1.48	1.48
<b>Plus</b>	6.52	6.52	4.00	2.66	1.48

*Shenim: vlerat në lek/minute pa TVSH*

Përcaktimin si afat të fillimit të zbatimit të detyrimeve për mos-diskriminimin në tarifat on-net/off-net, afatet e mëposhtme:

- **data 1.07.2015:** për programet tarifore, ofertat, opsionet etj., për përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit e rinj me kontratë, përfshirë rinovimet e kontratave ekzistuese që kryhen pas kësaj datë;
- **data 1.01.2016:** për të gjitha programet e tjera tarifore të aplikuara për përdoruesit aktualë me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike).

Afatet e mësipërme nënkuptojnë që:

- duke filluar nga data 1.07.2015 nuk lejohet aplikimi i tarifave të ndryshme on-net/off-net për përdoruesit me parapagim, përdoruesit e rinj me kontratë dhe përdoruesit aktualë me kontratë që kryejnë rinovim të kontratës pas datës 1.07.2015;
- duke filluar nga data 1.01.2016 nuk lejohet aplikimi i tarifave të ndryshme on-net/off-net edhe për përdoruesit me kontrata specifike si dhe përdoruesit aktualë me kontratë;

Secili operator celular ka kohën e mjaftueshme për të kryer ndryshimet e nevojshme dhe njoftuar përdoruesit për ndryshimet në tarifa, përfshirë përdoruesit me kontratë.

## 2.2.2. Masat rregullatore

### 🚧 Ofertat Referencë të Aksesit të Albtelcom:

Në vijim të Vendimeve nr.2415, dhe nr.2417, datë 4.02.2014, për përcaktimin e Albtelcom sipërmarrës me FNT në tregjet me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe të aksesit me shumicë broadband (LLU dhe bitstream), Albtelcom ka publikuar oferta refence të aksesit për:

- Segmentet terminuese te linjave me qira
- Akses në rrjetin e hapur lokal (RUO)
- Akses bitstream

### 🚧 Rishikim i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare:

AKEP më 16.01.2014 publikoi për këshillim publik dokumentin për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare. AKEP propozoi reduktimin e mëtejshëm të tarifave të terminimit celular sipas metodës benchmark, duke përdorur tarifën mesatare të terminimit në vendet e BEREC që kanë aplikuar metodën ‘pure LRIC’. AKEP me Vendimet nr.2341-2345, datë 13.03.2014 miratoi dokumentacionin final për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, duke vendosur për reduktime të mëtejshme të tarifave të terminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë, sipas vlerave të tabelës së mëposhtëme.

**Tabela 1: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit celular në Shqipëri 2014-në vijim**

	<b>1.09.2013</b>	<b>1.04.2014</b>	<b>1.04.2015</b>	<b>1.01.2016-</b>
<b>Vodafone/AMC</b>	4.57	2.66	2.04	1.48
<b>Albtelcom (EM)</b>	4.57	4.00	2.66	1.48
<b>Plus</b>	8.85	6.52	4.00	1.48

*Shënime:*

*Tarifat në lekë/minutë pa TVSH*

*Vlerat e tarifave për Vodafone/AMC më 1 Prill 2014 dhe 2015=tarifa mesatare e BREC 1.01.2013 dhe 1.07.2013*

*Vlera në 1.01.2016: 1.48 lek/min=1.06 Eurocent/min= Tarifa Mesatare e 13 vendeve qe kanë aplikuar Pure LRIC të pastër në 2013*

Vlerat e përcaktuara në vendimet e datës 13.03.2014 (në tabelen e mësipërme) u rishikuan gjatë procesit të analizës së tregut celular, dhe me vendimet për FNT dhe masat rregulluese për terminimin e thirrjeve, këto vlera u përcaktuan nga AKEP sipas tabelës së mëposhtëme:

**Tabela 2 : Rishikim i tarifave të terminimit celular në Shqipëri 2014- (versioni final)**

	<b>1.09.2013</b>	<b>1.04.2014</b>	<b>1.12.2014</b> <i>(deri ne nje vendim tjetër te AKEP)</i>
<b>Vodafone/AMC</b>	4.57	2.66	1.48
<b>Albtelecom (EM)</b>	4.57	4.00	1.48
<b>Plus</b>	8.85	6.52	6.52

*Shenim: vlerat ne lek/minute pa TVSH*

Reduktimet e mësipërme për tre operatorët e mëdhenj/më të hershëm në treg kryhen me qëllim përshpejtimin e eliminimit të diferencave në tarifatat on-net/off-net dhe si një ndër masat me efikasitet për këtë problematikë. Operatorëve më të vegjël iu reduktohen ndjeshëm kostot për thirrjet off-net dhe në këtë mënyrë kanë mundësi më të mëdha replikimi/konkurrimi të ofertave/paketave tarifore të operatorëve më të mëdhenj.

Gjatë këshillimit publik tre operatorët më të mëdhenj/më të hershëm në treg paraqitën kundërshtime për asimetrinë e lartë të tarifës së terminimit të Plus në raport me tre operatorët e tjerë, dhe në kushtet e propozimit për vendosje të detyrimit të mos-diskriminimit midis tarifave me pakicë on-net/off-net, tarifa e lartë e terminimit në Plus krijon problem në zbatimin e detyrimit pasi thirrjet drejt Plus kanë kosto shumë më të lartë (tarifa e terminimit) se drejt operatorëve të tjerë. AKEP sqaron se megjithë asimetrinë e lartë, tarifa mesatare e ponderuar e terminimit që tre operatorët e mëdhenj do paguajnë për thirrjet off-net duke filluar nga 1.12.2014 vlerësohet të jetë 1.80-2.08 lek/minute.<sup>11</sup>

#### **Tarifatat e Terminimit të SMS-ve në rrjetet celulare:**

Në vijim të analizës së tregut të terminimit të mesazheve SMS në rrjetet celulare, AKEP me Vendimet nr.2438-2441, datë 27.03.2014 për përcaktimin me FNT të katër operatorëve celularë për terminimin e SMS-ve në rrjetet e tyre dhe masat rregulluese për FNT, miratoi dhe reduktimin e tarifave të terminimit të SMS-ve sipas tabelës së mëposhtme:

**Tabela 3: Tarifatat e terminimit të SMS-ve**

	<b>Deri më 31.03.2014</b>	<b>1.04.2014-në një vendim tjetër të AKEP</b>
<b>Vodafone Albania</b>		
<b>AMC</b>		
<b>Albtelecom</b>	<b>1.44</b>	<b>1.00</b>
<b>Plus Communication</b>		

*Shënim: tarifatat në lek/SMS (pa TVSH).*

<sup>11</sup> E llogaritur në bazë të tarifave të terminimit të secilit operator më 1.12.2014 të ponderuara me sasitë përkatëse të trafikut off-net drejt secilit operator tjetër celular në tre-mujorin e tretë 2014

**Tarifat e interkoneksionit në rrjetet fikse:**

Në vijim të analizës së tregut të telefonisë fikse në 2013 dhe Vendimet e AKEP nr.2337-2339, datë 30.07.2013 dhe 31.07.2013, gjatë vitit 2014 u aplikuan reduktimet e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse të Albtelecom dhe operatorëve të tjerë fiks sipas tabelave të mëposhtme:

**Tabela 4: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetin Albtelecom 2013-2015**

	Aktuale- 31.12.2013	Faza I	Faza II	Ndryshimi	
		1.01.2014- 31.08.2014	1.09.2014- deri në një Vendim tjetër AKEP	Faza I/Aktuale	Faza II/Aktuale
<b>Terminim Origjinim (lekë/minutë)</b>	–				
<b>Lokal</b>	1.50	1.34	1.19	-11%	-21%
<b>Njëfish</b>	2.50	1.34	1.19	-46%	-52%
<b>Dyfish</b>	3.50	2.68	1.85	-24%	-47%
<b>Tranzitim(lekë/minutë)</b>					
<b>Njëfish</b>	1.50	1.71	1.32	14%	-12%
<b>Dyfish</b>	2.50	1.71	1.32	-32%	-47%
<b>Tarifë fikse për thirrje<sup>12</sup>(lekë /thirrje)</b>					
<b>Tarifë për thirrje</b>	0.83	0.53	0.38	-36%	-54%

*Shënim: Tarifat janë pa TVSH.*

<sup>12</sup>Aplikohet për terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve.

**Tabela 5: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetet e operatoreve alternative fikse 2013-2015**

	1.09.2010	Faza I	Faza II
		1.01.2014	1.09.2014-deri në një Vendim tjetër të AKEP
<b>Tarifa lek/minutë</b>			
<b>Lokal</b>	1.5-1.95	1.50	1.34
<b>Mesatare-Njëfish/dyfish</b>	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77
<b>Tarifë fikse për thirrje (lek/thirrje)</b>	0.83	0.53	0.38

*Shënim: Tarifat janë pa TVSH.*

**Tabela 6: Vlerat maksimale të tarifave të terminimit në rrjetin AMC për thirrjet drejt AMC Fiks 2013-2015**

	1.09.2010	Faza I	Faza II
		1.01.2014	1.09.2014-deri në një Vendim tjetër të AKEP
<b>Terminimi lek/minutë</b>	1.50 ose 2.5	1.34	1.19
<b>Tarifë fikse për thirrje</b>		0.53	0.38

*Shënim: Tarifat janë pa TVSH.*

AKEP me Vendimin nr.2502, datë 22.09.2014, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Rishikimi i tarifave të terminimit në rrjetet fikse”, nëprmet së cilit propozoi reduktimin e segmenteve të terminimit nga 2 në 1 dhe eliminimin e asimetrisë midis tarifave të terminimit të Albtelecom dhe operatorëve alternativeë duke filluar nga 1.01.2015, si dhe një reduktim tjetër më 1.07.2015. Bazuar në komentet e operatorëve si dhe për shkak se në vitin 2015 do të kryhet analiza e radhës e tregut të telefonisë fikse, AKEP gjykoji që të shtyjë miratimin e rishikimit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse, për ta bërë pjesë të procesit të analizës së tregut të telefonisë fikse në vitin 2015.



### **2.2.3. Rregullorja për të dhënat statistikore**

AKEP gjatë vitit 2014 kreu amendimin e Rregullores së të dhënave statistikore që operatorët depozitojnë në AKEP, duke kryer ndryshime në formularët e të dhënave. Procesi u krye pas një konsultimi të gjerë me lojtarët kryesorë të tregut si dhe me MIAP dhe INSTAT. Rregullat e reja synojnë në rritjen e cilësisë dhe periodicitetit të të dhënave, dhe periodicitetit të publikimeve të AKEP për të dhënat e tregut. Në këtë process shërbeu dhe seminari i organizuar nga MIAP me ITU dhe në bashkëpunim me AKEP dhe INSTAT në Maj 2014.

## **2.3. STATUSI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR SHËRBIMET PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE ELKTRONIKE**

AKEP gjatë vitit 2014 në përputhje me planin afatmesëm të përcaktuar në dokumentin “Statusi Aktual dhe Plani Kuadër 2013-2016 i Shërbimit Universal”, ka punuar për hartimin e rregullave për ofrimin e numeratorit telefonik të përgjithshëm dhe shërbimeve të kërkimit të informacionit në numerator. AKEP ka përgatitur një draft-rregullore për këtë qëllim i cili është dërguar operatorëve kryesorë për komente paraprake, të cilat do të diskutohen në një takim të përbashkët pune në Janar 2015. Dokumenti i përgatitur përmban rregulla për:

- ❖ Krijimin e bazës së të dhënave nga secili operator publik telefonik për pajtimtarët që dëshirojnë të jenë pjesë e numeratorit telefonik të përgjithshëm;
- ❖ Detyrim për ofrimin nga operatorët publikë telefonikë të të dhënave për numeratorin ofruesit të autorizuar të numeratorit telefonik të përgjithshëm;
- ❖ Rregulla për ofrimin e shërbimeve të kërkimit të informacionit në numerator;
- ❖ Të drejta për pajtimtarët që të jenë ose jo pjesë e numeratorit, për t'u tërhequr nga publikimi në numerator dhe për të ndryshuar të dhënat e publikuar në numerator.

Siç është përcaktuar në planin afatmesëm të AKEP, rregullat do synojnë që të mundësohet ofrimi i shërbimit të numeratorit dhe shërbimeve të kërkimit në numerator nga vetë tregu (palë të intersuar mund të jenë ose jo operatorë) dhe në rast se kjo nuk arrihet, AKEP do vijojë me procedurat për përcaktimin e ofruesit/ofruesve të këtyre shërbimeve sipas proceduarave të përcaktuara në ligj.

## **2.4. ZHVILLIMI I TREGUT TË SHËRBIMIT POSTAR**

### **2.4.1. Kuadri ligjor dhe rregullator**

AKEP me ligj nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligj nr. 8530/1999*) përcaktohet si organi rregullator, i cili mbikëqyr edhe kuadrin rregullator të përcaktuar nga ky ligj dhe politikat e zhvillimit të sektorit të shërbimeve postare. Sipas ligjit nr. 8530/1999 AKEP-i paraqet në Kuvend raportin vjetor të veprimtarisë lidhur me shërbimin postar, pjesë e të cilit duhet të jetë:

- Një analizë të ofrimit të shërbimit bazë postar, me një vlerësim të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimit, situatës së shërbimeve të rezervuara;
- Një analizë e tregut të shërbimeve postare dhe perspektivat e zhvillimit të tij;

Raportin e punës së AKEP për fushën e shërbimit postar.

#### 2.4.2. Ligji për shërbimet postare

Shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, rregullohen me ligjin Nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji 8530**). Ky ligj ka pësuar disa ndryshime gjatë periudhës 1999 – 2010, por mbetet pjesërisht i harmonizuar me direktivat e BE-së për shërbimin postar. Gjatë vitit 2014, Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) nxorri për këshillim publik projekt-ligjin e ri “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i cili synon reflektimin e direktivave më të fundit të KE-së (viti 2008) për shërbimin postar në legjislacionin Shqiptar.

Një aspekt i rëndësishëm në veprimtarinë e AKEP për vitin 2014 ka qenë plotësimi i objektivave rregullatore, në nxitjen e zhvillimit të sektorit postar, duke zbatuar procedurat e licencimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kontrollin e respektimit të kërkesave ligjore në shërbimet e ofruara nga operatorët, duke u kujdesur që konkurrenca ndërmjet operatorëve dhe ofruesve të shërbimeve postare të mbështetet në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së ndershme.

Me Vendimin Nr. 11/2014, 20.02.2014 të Kuvendit “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve elektronike dhe Postare”, u krijua Sektori i Shërbimeve Postare në përbërje të Drejtorisë së Tregjeve, Tarifave dhe Shërbimit Postar, në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave rregullatore, të përcaktuara nga ligji nr. 8530/1999.

#### Rritja e kapaciteteve

Duke qenë se përvoja e AKEP në rregullimin e sektorit postar ka qenë e pakët dhe për shkak se një strukturë e dedikuar për shërbimin postar u bë e mundur vetëm në mesin e vitit 2014 (me miratimin në Kuvend të strukturës së re organizative të AKEP), gjatë kësaj periudhe një rëndësi e veçantë i është kushtuar rritjes së kapaciteteve të AKEP për shërbimin postar. Në këtë periudhë struktura përkatëse në AKEP për shërbimin postar zhvilloi një takim me rregullatorin e Kroacisë HAKOM, me qëllim marrjen e përvojës për rregullimin e sektorit postar për çështje të tilla si:

- Kuadri ligjor dhe rregullator;
- Shërbimi universal;
- Rregullimi i tarifave dhe ndarja e llogarive.

Vlen të theksohet se me miratimin e projekt-ligjit të ri për shërbimin postar, nevojat e AKEP për kapacitete për shërbimin postar do të jenë më të mëdha, pasi projek-ligji parashikon ndryshime të mëdha në mënyrën e rregullimit të sektorit dhe më shumë kompetenca.

## **Panoramë e tregut të ofrimit të shërbimit postar**

Vitet e fundit në tregun postar kanë ndodhur një sërë zhvillimesh të rëndësishme që përfshijnë disa ndryshime në kuadrin ligjor si dhe ndarjen e funksioneve rregullatore nga ato të politikëbërjes. Ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur në tregun postar në drejtim të zhvillimeve të shërbimeve postare të ofruara në veçanti nga operatori publik postar. Një numër i madh objektivash janë realizuar me sukses si:

- Përmirësimi i kuadrin ligjor dhe rregullator;
- Sigurimi i shërbimit bazë postar;
- Futja e shërbimeve të reja postare;
- Zhvillimi i infrastrukturës postare;
- Harmonizimi i standardeve kombëtare me ato të Bashkimit Europian dhe të UPU-së;
- Futja e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore etj.

### **2.4.3. Aspekte të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe të dhënat statistikore**

## **Procedura të licensimit/revokimit**

### **Licencimi i ofruesve të shërbimeve postare**

Sipas kërkesave të Rregullores Nr. 21, datë 18.03.2011 për “*Licencën e Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare*”, në plotësim të rregullave për procedurën e licensimit dhe kushteve të ofrimit të shërbimeve postare, deri në fund të vitit 2014 janë të pajisur me licencë për ofrimin e shërbimeve postare **12 (dymbëdhjetë) subjekte**<sup>13</sup>:

- **Operatori publik postar - Posta Shqiptare sh. a.**
- **Ofrues të shërbimeve postare (11 subjekte)**
  - *DHL International (Albania) sh.p.k.*
  - *Albanian Courier sh.p.k. (A.C.)*
  - *Albanian Courier Service sh.p.k. (A.C.S.)*
  - *T.N.T Express Albania sh.p.k.*
  - *Sky Net Logistic sh.p.k.*
  - *United Transport sh.p.k. (UniTrans)*
  - *Ulysses Enterprises sh.p.k. (FedDex)*
  - *Youth Albania Professional Services (YAPS)*
  - *RAD MAIL sh.p.k.*
  - *Albanian Delivery Express sh.p.k.*
  - *ORBIT Transport Courier Logistics & Removals sh.p.k.*

---

<sup>13</sup>AKEP, ka publikuar në faqen zyrtare, “Regjistri i Licencave të Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare” me të dhënat e subjekteve të licencuar.

Ofruesit e Shërbimeve Postare Albanian Delivery Express sh.p.k. dhe ORBIT Transport Courier Logistics & Removals sh.p.k., të cilët janë pajisur me licencë në vitin 2014, nuk kanë mundur të fillojnë ofrimin e shërbimeve postare gjatë vitit 2014.

### **Revokimi i licencave**

Për mosplotësim të kërkesave të ligjit Nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i është revokuar Licenca e Përgjithshme për ofrimin e shërbimeve postare, **3 (tre) subjekteve**:

- Postalink sh.p.k. (revokuar licenca me VKD nr. 2515, datë 06.11.2014 për shkak të mosofrimit të shërbimeve të njoftuara)
- Agjensia e Abonimit të Shtypit sh.p.k. (revokuar licenca me VKD nr. 2514, datë 06.11.2014 për shkak të mos-pagesës së detyrimeve financiare për AKEP).
- Sky Net Albania sh.p.k. (çregjistruar me kërkesën nr.1578, datë 18.09.2013 prot. AKEP).

#### **2.4.4. Kontrolli i veprimtarisë së ofruesve të shërbimit postar**

Në zbatim të kërkesave të Ligjit 8530, me qëllim mbikqyrjen, kontrollin, monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve postare në përputhje dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve postare, sipas Tematikës dhe Objektivit të Inspektimit, në muajt Nëntor - Dhjetor 2014 u kryen kontrole në 5 (pesë) ofrues të shërbimeve postare:

- DHL International (Albania) sh.p.k.
- Albanian Courier sh.p.k. (A.C.)
- United Transport sh.p.k. (UniTrans)
- Ulysses Enterprises sh.p.k. (Fedex)
- Youth Albania Professional Services (YAPS)

Objekti i kontrollit ishte:

- Mbikqyrja e respektimit të kushteve të licencës;
- Respektimi i zonës së rezervuar.

Subjekteve të kontrolluara ju caktuan detyra mbi rritjen e cilësisë së shërbimit si dhe plotësimin dhe publikimin e dokumentacionit mbi rregullat e ofrimit të shërbimeve postare, në përputhje me Ligjin nr. 8530 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP.

AKEP ka monitoruar situatën e publikimit të informacionit për kushtet e shërbimit postar në faqet Web të ofruesve të shërbimeve postare.

#### **2.4.5. Publikimi i të dhënave të tregut postar dhe projekti ATLAS**

Bazuar në detyrimet e AKEP për publikimin e të dhënave të tregut postar, gjatë vitit 2014 AKEP ka grumbulluar dhe përpunuar të dhënat përkatëse nga operatorët postarë dhe ka publikuar raportin për treguesit statistikorë dhe financiarë të shërbimeve postare për vitin 2012, vitin 2013 si dhe raportin për treguesit postarë për 6 mujorin e I-rë 2013 dhe 6 mujorin e I-rë 2014. Njëkohësisht është punuar për publikim më të dukshëm dhe konçiz të të dhënave në faqen *web* të AKEP, çka është kryer në fund të vitit 2014.

Gjatë vitit 2014, AKEP është angazhuar në realizimin e projektit për krijimin e një database të rrjetit dhe të dhëna të tjera të shërbimit postar, nëpërmjet krijimit të një Atlasi të menaxhuar nga AKEP për publikimin e të dhënave në interes të tregut dhe për grupet e interesuara.

Për këtë qëllim, në muajin Nëntor 2014 u organizua një takim me përfaqësuesit e Operatorit Publik dhe Ofruesve të Shërbimeve Postare, ku u dhanë udhëzime për dërgimin e të dhënave të rrjetit postar, me qëllim përditësimin e tyre në Atlasin e AKEP. Operatorët kanë dërguar të dhënat në AKEP dhe në vitin 2015 projekti do të vazhdojë me hedhjen e të dhënave të rrjetit postar në ATLAS-in e AKEP dhe publikimin e tij për akses *online* nga palët e interesuara.

Zhvillimi i tregut postar shqiptar është nxitur nga rritja e infrastrukturës së tregut postar dhe tendencave të reja teknologjike, të cilat kanë çuar në rritjen e konkurrencës përmes rritjes së cilësisë, shërbimeve më të mira dhe më efçente.

#### **Shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare sh.a.**

##### **Shërbimi bazë postar - Posta Shqiptare sh.a.**

Operatori Publik - Posta Shqiptare sh.a., sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka të drejtën e dhënë për ofrimin shërbimit bazë postar<sup>14</sup>, që duhet t’i ofrohet çdo përdoruesi, në të gjithë territorin, me një çmim unik të përballueshëm dhe me cilësi të mirë.

Kërkesat e veçanta për sigurimin e shërbimit bazë postar nga operatori publik postar janë përcaktuar në Marrëveshjen e lidhur midis “Posta Shqiptare” sh.a. me Ministrin. Marrëveshja përcakton detyrimin për realizimin e shërbimit në jo më pak se 5 ditë në javë. Deri në fund të vitit 2014 ka rezultuar se çdo zyrë postare e Posta Shqiptare i ofron shërbimin bazë postar një numri mesatar të popullsisë prej 5103 banorë në një sipërfaqe prej 52 Km<sup>2</sup>.

Në shërbimin bazë postar, për vitin 2014 janë pranur 18.735.676 objekte postare në krahasim me 15.409.108 të pranuar në vitin 2013, ose 21 % më tepër në vitin 2014 se në vitin 2013.

---

<sup>14</sup> “Shërbimi bazë postar” kupton pranimin, përpunimin, vijimin dhe dorëzimin e objekteve të thjeshta të postës së letrave të adresuara, deri në 2 kg, të kolipostës së adresuar deri në 10 kg, shërbimin e urdhërpagesave postare dhe shërbimin e objekteve të regjistruara dhe të siguruar. Për kolipostën e adresuar ndërkombëtare që hyn në shtete të tjerë, kufiri i shërbimit bazë shtrihet deri në 20 kg. (Ligji 8530)

## Zona e Rezervuar.

Zona e rezervuar është përdorur si një mekanizëm për kompensimin e kostove për sigurimin e shërbimit bazë postar.

Sipas përcaktimeve të ligjit 8530 ofruesit e shërbimeve postare ofrojnë shërbime postare të tjera nga ato të rezervuara, që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar.

Në Draft-ligjin e ri për shërbimin postar, heqja e zonës së rezervuar është një ndryshim i rëndësishëm në dallim nga legjislacioni në fuqi për shërbimet postare. Ky ndryshim shoqërohet me krijimin e një skeme të re të financimit të kostove neto të shërbimit universal.

Këto ndryshime kanë hequr konceptin e zonës së rezervuar dhe orientojnë në hapjen e plotë të tregut postar. Njëkohësisht e drejta për ofrimin e shërbimit universal nuk është mbi baza ekskluzive.

**Posta Shqiptare sh.a.** përveç shërbimit bazë postar ofron dhe shërbimin e postës ekspres (EMS), postën e letrave, të pakove, shërbime financiare, filatelinë, shitjet, shërbim interneti, etj Posta Shqiptare sh.a. për përmbushjen e detyrimit ligjor, ofron shërbimet postare dhe financiare, përfshirë dhe shërbimin bazë postar, në **553** zyra, me **622** sportele për ofrimin e shërbimit bazë postar, nga të cilët **327** sportele janë të automatizuara/kompjuterizuara, duke mbuluar me shërbim të gjithë teritorin e vendit deri në zonat më të thella rurale.

## Shërbimet e ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve Postare

Ofruesit e shërbimeve postare janë të licencuar për ofrimin e shërbimeve postare, të tjera nga ato të rezervuara, që nuk përfshihen në shërbimin bazë postar<sup>15</sup>.

Shërbimi ekspres përbën pjesën më të madhe në totalin e të ardhurave të realizuara për këta ofrues.

Përdorimi i teknologjive të reja ka sjellë një rritje të cilësisë së shërbimeve postare dhe të performancës së përgjithshme të operatorit publik dhe ofruesve të shërbimeve postare si dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për shërbimin postar dhe informatizimin e shërbimeve postare i cili mundëson:

- Regjistrimin e objekteve postare në pranim, përpunim, transport, deri në dorëzimin përfundimtar;
- Gjurmimin *online* të objekteve postare dhe informacionin në kohë reale për statusin e objektit si dhe ndërfaqe elektronike të aksesueshme.

Ky zhvillim reflektohet dhe në rritjen e volumit të shërbimeve postare për objektet postare të pranuar, të dhëna në Tabelat e mëposhtme.


---

<sup>15</sup> - Shërbimi special i dorëzimit të objekteve postare të postës së shpejtë, brenda vendit - Posta Ekspres;  
- Shpërndarja e objekteve të paadresuara për publicitet;  
- Përgatitja e objekteve postare;  
- Shërbimi i përpunimit dhe transportit të objekteve postare të postës së jashtme.


**Tabela 1 – Volumi i objekteve postare në vitin 2014**

	<b>Shërbime postare të ofruara</b>	<b>Objekte postare</b>
<b>I</b>	<b>Posta Shqiptare sh.a</b>	
<b>1</b>	<b>Shërbime bazë postare</b>	
1.1	<i>Postë brenda vendit</i>	18.194.650
1.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	541.026
<b>1.3</b>	<b>Totali (1.1 + 1.2)</b>	<b>18.735.676</b>
<b>2</b>	<b>Dërgesa ekspres</b>	
2.1	<i>Postë brenda vendit</i>	585.039
2.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	10.883
<b>2.3</b>	<b>Totali (2.1 + 2.2)</b>	<b>595.922</b>
<b>2.4</b>	<b>Totali (1.3 + 2.3)</b>	<b>19.331.598</b>
<b>II</b>	<b>Ofrues të shërbimeve postare</b>	
<b>3</b>	<b>Dërgesa ekspres</b>	
3.1	<i>Postë brenda vendit</i>	1.861.821
3.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	64.806
<b>3.3</b>	<b>Totali (3.1 + 3.2)</b>	<b>1.926.627</b>
<b>4</b>	<b>Gjithësej (Totali 1.3 + 2.3 + 3.3)</b>	<b>21.258.225</b>

**Figura 2: Objekte postare shërbimi bazë postar/shërbimi ekspres - 2014**



**Tabela 3 - Ecuria e pjesëve të tregut sipas volumit të objekteve postare 2012 - 2014**



Viti kalendarik	Posta shqiptare	Ofruesit shërbimeve postare	Totali
Viti 2012	19252962	3338844	22591806
Viti 2013	15705591	1813921	17519512
Vitit 2014	19331598	1926627	21258225
<b>Ndryshimi 2014/2013</b>	23.1%	6.2%	21.3%

- Për objektet postare të pranuar në vitin 2014 nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve postare të marra së bashku, rezulton se:
- Objektet postare të pranuar gjatë vitit 2014 janë ritur me **21.3 %** në krahasim me vitin 2013.

Për sa i përket volumit total të objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2014, Posta Shqiptare zë **90.9%** pjesë tregu, ndërsa Ofruesit e Shërbimeve Postare **9.1%**.



#### 2.4.6. Rrjeti postar

Treguesit kryesorë të rrjetit të vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimeve postare nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimit Postar rezultojnë si më poshtë:

**Tabela 4 – Treguesit teknik dhe të rrjetit postar**

Emri i personit (juridik/fizik)	Zyra postare të hapura për publikun	Zyra postare jo të hapura për publikun	Numri i sporteleve për shërbime universale	Numri i automjeteve të transportit
Albanian Courier	103	1	0	46
Albanian Courier Service	99	1	0	2
DHL International Albania	22	1	0	11
Posta Shqiptare	553	17	622	426
RAD MAIL	1	0	0	21
SKY NET Albania	2	0	0	2
TNT Express Albania	32	0	0	27
Ulysses Enterprises	13	1	0	6
United Transport	102	1	0	4
YAPS	1	1	0	8
<b>Totali për 2014</b>	<b>928</b>	<b>23</b>	<b>622</b>	<b>553</b>
<b>Totali për 2013</b>	<b>1278</b>	<b>34</b>	<b>622</b>	<b>593</b>
<b>Totali për 2012</b>	<b>839</b>	<b>21</b>	<b>610</b>	<b>593</b>

Posta Shqiptare e cila ofron shërbim në të gjithë vendin në **553** zyra të hapura për publikun ka treguesit më të mirë të rrjetit, e ndjekur nga United Transport, Albania Courier, Albanian Courier Service, TNT Express Albania dhe DHL International Albania. Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit bazë **622** sportele nga të cilët **327** sportele janë të automatizuar/kompjuterizuar.

Në përgjithësi prezenca e zyrave postare të ofruesve të tjerë, përveç Posta Shqiptare sh.a., është në qytetet kryesore të vendit.

Përsa i përket infrastrukturës së mjeteve postare Posta Shqiptare ka në përdorim 426 automjete transporti, Albanian Courier 46, TNT Express 27, RAD MAIL 21, DHL 11, të pasuar nga Ofruesit e tjerë.

#### 2.4.7. Tregues statistikore

Sipas të dhënave të dërguara nga Posta Shqiptare sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare për vitin 2014, disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve postare, në raport me popullsinë dhe sipërfaqen e Republikës së Shqipërisë rezultojnë të jenë:

#### **✚ Tregues për shërbimin bazë postar të realizuar nga Posta Shqiptare:**

- Objekte postare të pranuar nga Posta Shqiptare për shërbimet bazë postare 18.735.676 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.821.977 janë: **6.6 objekte / banorë**.
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 553, për ofrimin e shërbimeve bazë postare nga Posta Shqiptare në raport me popullsinë 2.821.977 janë: **5.103 banorë / zyrë**.
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 553, për ofrimin e shërbimeve bazë postare nga Posta Shqiptare në raport me sipërfaqen 28.748 Km<sup>2</sup> janë: **52 m<sup>2</sup> / zyrë**.

#### **✚ Tregues të realizuar nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare:**

- Objekte postare të pranuar gjithësej 21.258.225 në raport me popullsinë (banorë rezident) 2.821.977 janë: **7.5 objekte / banorë**.
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 928 në raport me popullsinë 2.821.977 janë: **3.040 banorë / zyrë**.
- Numri i zyrave postare gjithësej të hapura për publikun 928 në raport me sipërfaqen 28.748 Km<sup>2</sup> janë: **31 Km<sup>2</sup> / zyrë**.

### **2.4.8. Rezultatet financiare – 2014**

#### **✚ Të ardhurat**

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2014 nga operatori publik dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë 2,986,218,654 Lekë. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash 2,037,596,000 Lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2014.

Posta Shqiptare zotëron 68 % të tregut, e pasuar nga DHL Albania me 13 % të tregut dhe më pas nga TNT Express Albania me 6 %, Albanian Courier me 5 %, United Transport me 3 % .

Siç mund të vihet re në grafikun 7, të ardhurat në vitin 2014 janë rritur me 10 % krahasuar me vitin 2013.

#### **✚ Investimet**


Në vitin 2014 janë realizuar investime në vlerën 141,184,903 Lekë, ose 2.4 herë më shumë se në vitin 2013.

Në figurat 5-8 jepen në formë më të detajuar realizimi i të ardhurave dhe investimet në tregun postar për vitin 2014, si dhe ecuria e këtyre treguesve krahasuar me vitet paraardhëse.


**Tabela 5 Të ardhurat sipas subjekteve**

Emri i personit (Juridik/ Fizik)	Totali i të ardhurave
ALBANIAN COURIER	150784717
Albanian Courier Service	4479895
DHL International Albania	402552406
Posta Shqiptare	2037596000
RAD MAIL	58362089
SKY NET LOGISTIC	12805409
TNT EXPRESS ALBANIA	164016920
ULYSSES ENTERPRISES	33581730
UNITED TRANSPORT	77481490
YAPS	44557998


**Grafiku 6**



**Grafiku 7**



**Grafiku 8**



#### **2.4.9. Statusi i shërbimit universal për shërbimin postar**

AKEP ka për prioritet në veçanti, sigurimin e shërbimit postar universal, të konceptuar si një e drejtë aksesit në shërbimet postare për përdoruesit, duke siguruar një minimum shërbimesh me

një cilësi dhe çmime të përballueshme për përfitimin e të gjithë përdoruesve pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike.

#### **2.4.10. Prioritete**

AKEP, nëpërmjet masave rregullatore për sektorin postar synon plotësimin e nevojave të tregut të brendshëm për shërbimet postare eficiente, të besueshme dhe me cilësi të mirë, të disponueshme për të gjithë qytetarët.

AKEP, me miratimin e ligjit të ri të shërbimit postar do të vlerësojë reformën në sektorin postar dhe procesin e zhvillimit të tij përmes metodologjisë IPDP (Integrated postal reform and development plans), kryesisht në komponentet:

- aktet rregulluese sektoriale;
- sigurimi i shërbimit universal;
- cilësia dhe modernizimi i shërbimeve;
- fleksibiliteti i fushës së mbuluar nga shërbimi universal;
- financimi i shërbimit universal;
- përcaktimi i ofruesit të shërbimit universal;
- rregullimi i aksesit në rrjetin postar.

## **2.5. ADMINISTRIMI I BURIMEVE TË FUNDME DHE REGJIMI I AUTORIZIMEVE**

### **2.5.1. Administrimi i spektrit të frekuencave**

Një aspekt shumë i rëndësishëm i veprimtarisë së AKEP-it është administrimi i regjistrimit të sipërmarrësve, burimeve natyrore të fundme (spektri i radiofrekuencave dhe numeracioni) si dhe certifikatave e licensave. Kjo veprimtari bazohet në rregullimet ligjore përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008, i ndryshuar, sipas të cilave për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatorë të përcaktuara nga ky ligj AKEP-i ka kompetencë:

- Regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit.
- Bashkëpunon me Ministrin për hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave;
- Përgatit Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe administron brezat e frekuencave të caktuara për qëllime civile, për përdorim publik ose privat, me përjashtim të brezit të frekuencave, të caktuara për transmetime radio e televizive, të cilat administrohen nga AMA;
- Lëshon autorizimet individuale për përdorimin e frekuencave;
- Kryen procedurat e përcaktuara, sipas këtij ligji, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës;
- Bashkërendon punën me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave, për pjesën e spektrit që administron;
- Harton, miraton dhe administron Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;
- Cakton numrat dhe seritë numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Siguron disponueshmërinë e një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e numrit;
- Merr masat që, sipërmarrësit të zbatojnë detyrimet, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të vendit, të sigurisë publike edhe në rast lufte apo gjendje të jashtëzakonshme;
- Krijon, mirëmban dhe përditëson bazën e të dhënave elektronike për sektorin e komunikimeve elektronike dhe siguron që këto të dhëna, në formë informacioni, t'i bëhen të vlefshme publikut, në përputhje me rregullat për informimin publik dhe të ruajtjes së konfidencialitetit.

Mbulimin e kësaj veprimtarie e kryen Drejtoria e Administrimit të Frekuencave, Numeracionit dhe Autorizimeve.

#### **Bashkëpunimi me Ministrin për menaxhimin e spektrit të Frekuencave:**

AKEP ka dhënë kontributin e tij maksimal me pjesëmarrjen në grupet ndërinstitucionale të ngritur për menaxhimin e spektrit të frekuencave.

## **🚧 Përgatitja e Planit të Përdorimit të Frekuencave dhe administrimit të brezave të frekuencave të caktuara për qëllime civile:**

AKEP për të studiuar mënyrën e implementimit të ndryshimeve të ndodhura në PKF në Planin e Përdorimit të Frekuencave ngriti një grup pune. AKEP me Vendimin Nr.2418, datë 06.02.2014 miratoi Planin e Përdorimit duke bërë të mundur:

- (1) Teknikisht dhe ekonomikisht planifikimin optimal, caktimin dhe përdorimin efikas të frekuencave, duke marrë parasysh që spektri i radiofrekuencave dhe orbita gjeostacionare janë në vetëvete burime të rralla dhe të fundme;
- (2) Përfitim të kushteve për përgatitjen e rregullave mbi kushtet teknike dhe operative për përdorimin e disa frekuencave;
- (3) Mbrojtjen nga interferencat e dëmshme;
- (4) Rregullimin e Planit me modifikimet në nivel ndërkombëtar, si edhe bashkërendimet që rezultojnë nga përmbushja e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe me fqinjët dhe vendet e tjera;
- (5) Rregullimin e përdorimit të brezave të frekuencave ndërmjet shërbimeve radio dhe përdoruesve;
- (6) Implementimin e teknologjive të reja dhe zhvillimin e komunikimeve radio.

Ky Plan Përdorimi i Frekuencave përfshin:

- (a) Brezat e frekuencave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave për përdorime “civile”, të cilat mund të përdoren për qëllime civile, si dhe zbatimet e shërbimeve radio të përcaktuara në këto breza frekuencash;
- (b) Rregullat lidhur me përdorimin e brezave të frekuencave, përfshi karakteristika të administrimit të frekuencave për rrjete të radiokomunikimeve dhe radio stacionet dhe të pajisjeve radio, metodën e dhënies së frekuencave, raste të ndryshëm nga autorizimi individual i përdorimit të frekuencave, kërkesat teknike dhe kushtet e punës lidhur me operimin e radio sistemeve;
- (c) Implementimin e ndryshimeve të rëndësishme që kanë pësuar brezat GSM, IMT, BWA, etj. përsa i përket teknologjive të aplikuara në këto breza ashtu edhe shërbimeve të ofruara.

## **🚧 Lëshimi i autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave:**

AKEP ka punuar në mënyrë të vazhdueshme për heqjen e barrierave administrative në procesin e lëshimit të Autorizimeve Individuale. Për këtë ka informatizuar sistemin e aplikimeve për pajisjen me autorizim për frekuenca dhe për numra. Këshilli Drejtues miratoi aktet rregullatore “Rregullore për Autorizimin Individual” dhe “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për caktim dhe përdorim të numrave dhe serive numerike dhe PKN” duke bërë të mundur dhe implementimin e procesit “Aplikim Online” për kërkesat e caktimit të frekuencave, caktimit të numrave dhe raportimin e interferencave. I gjithë procesi ka kaluar nëpërmjet këshillimit publik dhe takimeve e workshop-eve me sipërmarrësit.

Nga fillimi i vitit 2014, për operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP:

- ✓ 40 autorizime individuale për përdorimin e frekuencave në 1160 lidhje fikse të reja/ndryshuara, nga të cilat:
  - VFAL 8 (115 lidhje të reja, 269 ndryshime, 84 revokime)
  - AMC 4 (560 lidhje të reja, 34 ndryshime, 16 revokime)
  - PLUS 1 (10 lidhje për 3G test, 0 ndryshime, 11 revokime)
  - Albtelecom 2 (33 lidhje të reja, 73 ndryshime, 0 revokime)
  - Të tjera 25 (65 lidhje të reja, 0 ndryshime, 53 revokime)
  
- ✓ 195 Autorizime Individuale për përdorimin e frekuencave në 200 sisteme PMR radiokomunikim dhe radioalarmi.

Ndryshimi në numrin e autorizimeve të lëshuara dhe të revokuara në vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 ka ndodhur përveç të tjerash edhe për shkak të evoluimit të rrjeteve të komunikimit pa tel që mbështesin shërbimet dhe aplikimet e reja broadband nëpërmjet:

- ofrimit të mundësive të reja për ndërtimin e një infrastrukture të integruar të rrjeteve pa tel dhe fibrave optike dhe
- rritjes së kapaciteteve të transmetimit për lidhjet ekzistuese etj.

#### **Rinovimi i Autorizimit Individual të AMC për përdorimin e brezave GSM:**

Sipas ligjit nr.9918/2008 (indryshuar) rinovimi i autorizimeve për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim kryhet mbi bazën e rregullave dhe procedurat e rinovimit të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Afati i Autorizimit Individual të sipërmarrësit AMC për përdorimin e frekuencave në brezin GSM përfundonte në muajin Gusht 2014.

AKEP në zbatim të detyrimeve që përcakton ligji nr. 9918/2008 për rinovimin e Autorizimit Individual kreu veprimet proceduriale të parashikuara në ligj duke dhënë edhe një kontribut të rëndësishëm bashkëpunues me Ministrin e linjës në procesin e hartimit dhe miratimit të aktit miratues të Këshillit të Ministrave për këtë qëllim, VKM Nr. 496, date 22. 07. 2014, për “Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”.

Bazuar në përcaktimet e parashikuara në kete ligj dhe VKM, AKEP hartoi një raport vlerësues për sipërmarrësin AMC i cili shërbeu edhe si bazë për negociimin e çmimit dhe vijimin e procedurës së rinovimit. Në përfundim të procedurës AKEP me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 2536, datë 15.01.2015 miratoi rinovimin e Autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të brezit 900 dhe 1800 MHz të sipërmarrësit Albania Mobile Communications Sh.A. (AMC).



#### **✚ Kryerja e procedurave të përcaktuara, sipas ligjit, për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës:**

Me qëllim të shfrytëzimit sa më efektiv të spektrit dhe me kujdesin që të ofrojë shërbime me cilësi dhe me çmime konkurruese për konsumatorin AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.2507, datë 30.10.2014 bëri “ Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt:“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1965 – 1980 MHz çiftuar me 2155- 2170 MHz dhe 5 MHz spektër i paçiftuar 1915 – 1920 MHz”.

AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi pajisi ofertuesin fitues me Autorizimin Individual përkatës.

Me Vendimin Nr.2527, datë 12.11.2014 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin e Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX” dhe Njoftimin për tender publik.AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi po ndjek të gjitha procedurat e duhura deri në përfundimin të tij.

Me vendim Nr.2532, date 23.12.2014, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi përfundimin e këshillimit publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS” dhe propozimin për Ministrin për vazhdimin e procedurës për dhënien në përdorim të tyre.AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi po ndjek të gjitha procedurat e duhura deri në përfundimin të tij.

Me vendim Nr.2531, date 23.12.2014, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi propozimin për Ministrin për fillimin e procedurës për dhënien në përdorim të frekuencave nga brezi 900 MHz për sistemet GSM. AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi po ndjek të gjitha procedurat e duhura deri në përfundimin të tij.

#### **✚ Bashkërendimi i punës me administratat e vendeve fqinje dhe të vendeve të tjera për caktimin dhe përdorimin e radio-frekuencave, për pjesën e spektrit që administrojnë:**

AKEP këto vitet e fundit ka shtuar të gjitha përpjekjet për të bërë të mundur nënshkrimin e marrëveshjeve teknike me qëllim koordinimin ndërkufitar. Kryesisht është punuar për arritjen e marrëveshjeve të koordinimit për sistemet GSM/DCS1800 për të shmangur në maksimum interferencat në zonat kufitare. Deri tani janë realizuar marrëveshjet me Autoritetin e Kosovës,të Malit të Zi dhe Autoritetin Maqedonas ndërkohë që kanë filluar komunikimet në nivel teknik edhe me autoritetin homolog Grek.

#### **✚ Regjimi i Autorizimit të Përgjithshëm dhe dhënia e të drejtës së përdorimit të frekuencave**

Sipas ligjit 9918/2008 autorizimi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë bëhet:

- a) Përmes njoftimit, kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuar;
- b) Pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme.

Ligji 9918/2008 përcakton kompetencën e AKEP-it për regjistrimin e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në përfundim të procesit të njoftimit, kompetencën e hartimit të rregullave për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes bregdetare, si dhe rregullave dhe kërkesave teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore.

Autorizimi i hyrjes në treg të subjekteve për ofrim rrjetesh dhe shërbimesh publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2014, është bërë bazuar në dispozitat e rregullores “Për Autorizimin e Përgjithshëm” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1774 datë 02.02.2012, e ndryshuar gjatë vitit 2014 me qëllim përshtatjen e ndryshimeve ligjore të ligjit 9918, dhe për të përmirësuar aplikimin përkatës *on-line*.

Aplikimi *on-line* bazuar në kushtet e anekseve të rregullores, ka bërë të mundur marrjen e një informacioni të detajuar dhe të nevojshëm mbi:

- rrjetet/shërbimet që ofron sipërmarrësi;
- statusin ligjor, shoqëruar me ekstraktin e QKR-së;
- teknologjinë e përdorur dhe mediumet e komunikimit;
- kushtet e ofrimit të aksesit dhe shërbimit pajtimtarit-kontrata tip;

Aplikimi *on-line* për autorizim të hyrjes në tregun e komunikimeve elektronike, veç të tjerave, saktëson detajet e kontaktit të sipërmarrësit pasi vetë moduli i aplikimit kërkon adresë e-mail funksionale në mënyrë që sipërmarrësi të marrë të dhënat për login “përdoruesin, fjalëkalimin, kodin e konfirmimit”, pranimin apo kthimin për rishikim të aplikimit.

Me zbatimin e kësaj rregulloreje “Regjistri i Sipërmarrësve” është më i detajuar dhe i organizuar, duke lehtësuar identifikimin e sipërmarrësit dhe rrjetet/shërbimet e ofruara prej tij.

Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit dhe Regjistri i Sipërmarrësve përmbajnë të njëjtat të dhëna për rrjetin dhe shërbimet që ka deklaruar sipërmarrësi. Gjithashtu sipërmarrësit kanë të njëjtin numër identifikimi të aplikimit si në Çertifikatë ashtu dhe në Regjistër.

Gjatë procesit të aplikimeve *online* vlen të cilësohet fakti që sipërmarrësit e rinj të cilët kanë aplikuar për herë të parë, kanë përfunduar me sukses aplikimin dhe janë pajisur me Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit. Kjo tregon se mënyra e aplikimit online është e lehtë dhe e asimilueshme edhe nga sipërmarrës të rinj.

Përveç guidës së aplikimit të publikuar në faqen *web* të AKEP dhe manualeve të përdorimit që ndodhen në modulën e aplikimeve online, Drejtoria e Ministrimit të Frekuencave, Numeracionit dhe Autorizimeve ju ka ardhur në ndihmë sipërmarrësve me udhëzime të detajuara për kryerjen e procesit të aplikimeve online.

Në zbatim të Urdhërit nr. 950, datë 22.02.2013 “Për caktimin e administratorit të Regjistrisë të Sipërmarrësve për Ofrimin e Rrjeteve dhe Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike dhe Regjistrisë të Licencave të Përgjithshme të Operatorëve Publikë dhe Ofruesve të Shërbimeve Postare”, nga AKEP janë kerkuar informacione periodike mujore për sipërmarrësit që kanë njoftuar online për fillim/ndryshim/mbyllje aktiviteti për rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimeve elektronike. Mbetet detyrë e vazhdueshme për sipërmarrësit e regjistruar mbi verifikimin ndryshimeve nëse kanë ndodhur në Ekstraktin e Regjistrisë Tregtar në QKR dhe vijimi procedurave për përditësimin e ndryshimeve të tyre. Gjithashtu më tepër vlerësim kërkon detyra mbi njoftimin e sipërmarrësve të cilët nuk kanë ofruar rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike deri në datën që kanë deklaruar në njoftimin e regjistrimit.

Në zbatim të Urdhërit nr. 1263, datë 18.07.2014 “Për caktimin e administratorit të Regjistrisë të Informacionit Periodik të Raportuar nga Sipërmarrësit”, Drejtorja e Administrimit të Frekuencave, Numeracionit dhe Autorizimeve ka plotësuar dhe përditësuar online të dhënat sipas regjistrisë të sipërmarrësve, që kanë njoftuar për Fillim/Ndryshim/Mbyllje të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm.

Me qëllim kalimin në procedurë aplikimi online edhe të procesit të zbatuar nga subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë/autorizim/çertifikatë sipas akteve normative të nxjerra nga AKEP-i:

1. *Rregullore Nr.7, datë 23.12.2008, “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të anijes””.*
2. *Rregullore Nr.6, datë 23.12.2008, “Për dhënien e “Certifikatës Operatorit Radiodetar””.*
3. *Rregullore datë 23.12.2008, “Për dhënien e licencës “Për stacionet radio të avionit””.*
4. *Rregullore Nr.5, datë 23.12.2008, “Për dhënien e Autorizimit “Për stacionet radio bregdetare””.*
5. *Rregullore Nr.14, datë 13.04.2010, “Për dhënien e licencës “Autoriteti i Llogarive Detare dhe Kodin AAIC””.*
6. *Rregullore datë 13.04.2010, “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë””.*
7. *Rregullore Nr.21, datë 18.03.2011, “Për dhënien e Licencës së Përgjithshme për Ofrimin e Shërbimeve Postare”,*

u krye ndërhyrje legjislative në këto akte duke parashikuar dispozita të cilat rregullojnë zbatimin e procedurës së aplikimit online. Në këtë mënyrë u arrit që të kryhen të gjitha aplikimet për licencë/autorizim/çertifikatë nëpërmjet modulit të aplikimeve online.

Gjatë vitit 2014 përveç regjistrisë të sipërmarrësve janë përditësuar dhe regjistrat e shërbimeve të tjera me të dhënat e kërkuara sipas ligjit nr. 9918 dhe akteve rregullatore përkatëse, duke kryer periodikisht publikimin e tyre në “web site” të AKEP.

Sipas rregullores “Për shërbimet radioamatore në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me VKD të AKEP Nr.1222, datë 13.04.2010, e ndryshuar, është vijuar procesi për ndjekjen e procedurave për pajisje me licencë dhe çertifikatë për radioamatorë, mbajtja e korrespondencës me aplikantët dhe zbardhja e licencave të përkohshme për radioamatorët e huaj.

Gjatë vitit 2014, sipas procedurës së trajtimit të kërkesave për shërbimet e lëvizëshme ajrore dhe detare, është vazhduar me regjistrimin e subjekteve aplikuese për licenca/autorizime dhe çertifikata.

Sipas kërkesave të parashikuara në rregulloret për shërbimet e lëvizëshme ajrore dhe detare, janë evidentur në regjistra të veçantë të dhënat për subjektet e licensuara për stacionet radio të anijes, avionit, stacionet radio bregdetare, për autoritetin e llogarive detare dhe kodin AAIC dhe personat e pajisur me çertifikatën e operatorit radiodetar, të cilat janë publikuar në faqen web të AKEP.

AKEP me anë të Vendimit të Këshillit Drejtues, Nr. 2429, datë 13.03.2014 dhe Vendim Nr. 2443, datë 10.04.2014 miratoi disa ndryshime dhe shtesa në aktin normative Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, e ndryshuar. Këto ndryshime konsistojnë në:

- a) Ndryshime dhe shtesa në Kreun e II-të të Rregullores “Procedurat dhe kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm”
- b) Ndryshime dhe shtesa në Aneksin A “Njoftim regjistrimi për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, të Rregullores nr. 24.
- c) Ndryshime dhe shtesa në Aneksin C të Rregullores nr.24, dt. 02.02.2012 mbi “Kushtet e përgjithshme të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike në regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm”

Ndryshimet e miratuara me VKD Nr. 2443, datë 10.04.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, janë reflektuar në Aneksin A të Rregullores duke krijuar një seksion të veçantë A/1 për Njoftimin e Regjistrimit të Rrjeteve Kabllore Televizive dhe/ose Rrjete Satelitore si dhe në përmbajtjen e Çertifikatës së Konfirmimit të Njoftimit për sipërmarrësit e regjistruar për rrjet të komunikimeve elektronike, rrjet kabllor televiziv dhe ose satelitor për ofrimin e programeve audio dhe/ose audiovizive dhe plotësimin e saj me të dhënat e deklaruara nga sipërmarrësit për zonën e ofrimit të rrjetit, sipas kërkesave të germës a) të pikës 2 të nenit 55 “Llojet e licencave dhe autorizimeve dhe afatet e tyre” të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

*AKEP gjatë vitit 2014 ka regjistruar edhe ofruesit e rrjeteve audiovizive, kjo bazuar në ligjin ligjin Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në republikën e shqipërisë” dhe ligjin 9918, i ndryshuar. Për të lehtësuar këtë procedurë dhe për të mundësuar një administrim më të mirë të tyre u bënë edhe modifikimet e nevojshme në modulën e aplikimeve online.*

Më poshtë paraqiten në mënyrë tabelare sipërmarrësit dhe autorizime /licenca/ çertifikata të regjistruara në AKEP deri në fund të vitit 2014 si dhe të ndarë edhe për disa nga shërbimet kryesore të ofruara.

**Tabela 1: Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike deri më 31.12.2014**

<i>Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, periudha 02.02.2012-31.12.2014</i>			
<i>Sipërmarres te regjistruar sipas regjimit AP</i>	<i>Të regjistruar</i>		<i>Të çregjistruar</i>
Sipërmarrës të regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;	215		19
Sipërmarrës që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale	119, cilësojmë se 21 prej tyre ofrojnë dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike = 98		5
<b>Totali</b>	<b>215+98= 313</b>		<b>24- 1 sipërmarres i dubluar = 23 total</b>
<b>Telefoni - 102</b>	<b>Fiks</b>	<b>Mobile</b>	<b>Kartë me parapagim</b>
	96	4	9
<b>Internet</b>	<b>167</b>		
<b>Shërbim me vlerë të shtuar</b>	<b>35 në total ndërsa vetëm këtë shërbim e ofrojnë 26</b>		
<b>Transmetim të dhënash</b>	<b>60</b>		
<b>Linja me qera</b>	<b>17</b>		

<b>Sipërmarrës që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale</b>	<b>119 të regjistruar</b>	<b>21 prej tyre ofrojnë dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike</b>
---	---------------------------	--

**Tabela 2:** Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Periudha 03.01.2014- 31.12.2014

<b>Regjistri i Sipërmarrësve që kanë njoftuar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, periudha 03.01.2014-31.12.2014</b>			
Sipërmarrës që kanë njoftuar fillim të ofrimit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike		<b>106</b> Certifikata të Konfirmimit të Njoftimit	Sipërmarrës të pajisur për herë të parë me CKNJ-83
Sipërmarrës të çregjistruar		<b>10</b>	
<b>Telefoni - 19</b>	<b>Fiks</b>	<b>Kartë me parapagim</b>	<b>Mobile</b>
	17	2	0
<b>Internet</b>			36
<b>Shërbim me vlerë të shtuar</b>			4
<b>Transmetim të dhënash</b>			2
<b>Linja me qera</b>			0

<b>Sipërmarrës që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundësojnë transmetimin e programeve audiovizuale</b>	<b>47 të regjistruar</b>	<b>8</b> prej tyre ofrojnë dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike	<b>39</b> janë vetëm kabllore
---	--------------------------	---	-------------------------------

Subjektet e pajisur me Certifikata/Licenca për periudhën janar 2014- 23 dhjetor 2014 janë:

<b>Nr.</b>	<b>Autorizime/Licenca/Çertifikata</b>	<b>Të regjistruar</b>
<b>1.</b>	Certifikate Operatori Radiodetar	12
<b>2.</b>	Licencë për stacionet radio anije të lëshuara	8
<b>3.</b>	Licencë Radioamator i Huaj të lëshuara	20
<b>4.</b>	Autorizim për stacionet radio bregdetare të lëshuara	1

### 2.5.2. Administrimi i planit të numeracionit dhe dhënia e të drejtës së përdorimit të numrave

#### **✚ Hartimi, miratimi dhe administrimi i Planit Kombëtar të Numeracionit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë:**

Me 1 Janar 2014 u implementuan ndryshimet e Planit Kombëtar të Numeracionit të miratuara me Vendimin nr.2350, datë 13. 09. 2013 të Këshilli Drejtues të AKEP. Këto ndryshime konsistojnë në kalimin e PKN nga organizimi në një numër të madh zonash gjeografike në 12 rajone gjeografike me synimin që më vonë të kalohet në një zonë të vetme gjeografike.

#### **✚ Caktimi i numrit dhe serive numerike të sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike:**

Aplikimi për numrat dhe seritë numerike është pothuaj i automatizuar duke eliminuar kështu thuajse të gjitha procedurat ndërmjetëse administrative që zgjasnin këtë proces. Është ngritur sistemi i menaxhimit të Planit të Numeracionit që përfshin të gjithë kategoritë e numrave dhe matricën e ndërfaqur online. Gjatë viti 2014 janë përpunuar dhe procesuar:

- Alokime numra dhe seri numerike janë trajtuar 50 aplikime.

Anullim numeracioni janë trajtuar 30 caktime për efekt pagese dhe 10 me kërkesën e subjekteve.

### 2.5.3. Ofrimi i shërbimit të portabilitetit të numrave

#### **✚ Sigurimi i disponueshmërisë së bazës qendrore të të dhënave për portabilitetin e numrit:**

Në mënyrë të vazhdueshme AKEP ka ndjekur funksionimin e sistemit të portabilitetit të numrit CRDB.

Në përgjithësi procesi ka ecur mirë edhe këtë vit ka patur një numër të madh abonentësh të cilët kanë përdorur shërbimin e portabilitetit të numrit, një tablo me shifrat e numrave të bartur në fund të viteve 2013 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

Shërbimi Telefonik	I lëvizshëm		Fiks	
	2013	2014	2013	2014
Numra të bartur	<b>101622</b>	<b>102796</b>	<b>4875</b>	<b>5336</b>

Sipas të dhënave të CRDB (bazës së të dhënave të këtij sistemi) rezulton një shifër prej afro 5300 numrash fiks të bartur.

Shërbimi i Portabilitetit të Numrit ka hyrë në vitin e pestë që nga kryerja e bartjes së parë, dhe bazuar në Rregulloren për “Portabilitetin e Numrit” gjatë vitit 2014 AKEP ka kryer një këshillim publik mbi performancën e ofrimit të këtij shërbimi dhe mbi ecurinë e procesit gjatë 3 viteve të para të ofrimit të shërbimit. Vlen të theksohet se pjesmarrësit në këtë këshillim publik kanë qenë të kënaqur me cilësinë e ofrimit dhe me teknologjinë e përdorur. Bazuar në komentet e sipërmarrësve pjesmarrës në këtë proces si dhe në analizat e kryera nga AKEP janë propozuar

dhe më pas janë kryer disa modifikime me qëllim përmirësimin në proces, ku konkretisht është zgjidhur problemi i pajtimtarëve me detyrime të pashlyera në operatorin dhënës.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Aplikacioneve (DTIA) është kryer me sukses Menaxhimi i sistemit dhe komunikimit midis operatorëve dhe ofruesit të CRDB (baza referencë e centralizuar). Gjenerimi i raporteve përkatëse në lidhje me procesin e bartjes së numrit dhe operatorëve. Funksionimi i sistemit të CRDB ka qenë sipas Rregullores dhe me një disponueshmëri prej 100% dhe realizimi i procesit të bartjes së numrave për pajtimtarët. AKEP gjatë vitit 2015, duke u nisur dhe nga përfundimi i afatit pesë vjeçar i përcaktuar në rregullore për ofruesin e CRDB, do të kryejë përsëri një analizë të këtij shërbimi dhe bazuar në të do të vendosë mënyrën dhe operimin për vitet në vazhdim.

### **Mbi procesin e riregjistrimit të Numrave Celulare**

AKEP në kuadër të përmirësimit të procesit të regjistrimit të pajtimtarëve dhe nisur nga situata mbi sigurinë e krijuar në vend, pas inspektimeve intensive të kryera në të gjithë vendin mbi rishitjen e kartave, u ka kërkuar sipërmarrësve të komunikimeve elektronike celulare riregjistrimin të të gjithë numrave të celularëve në sasi mbi 20 copë të cilët janë të lidhur me një pajtimtar të caktuar dhe mbylljen e tyre pas afatit të përcaktuar për riregjistrimin e tyre. Operatorët celularë i janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të AKEP dhe kanë kryer disa fushata lajmërimi dhe komunikimeve drejt pajtimtarëve seri më datë 06.03.2015, e vendosur si afat maksimal për riregjistrimin e kategorive të numrave të cilat ishin të regjistruar në emër të një pajtimtari të vetëm dhe të pajustificueshme për përdorim personal apo familjar, si dhe të numrave të telefonit të cilët janë të aktivizuar prej minimumi 6 muajsh dhe nuk janë të përdorur.

Vlen të theksohet se nga raportimet e operatorëve celularë janë mbyllur rreth 500.000 numra celularë me parapagim të cilët nuk u janë drejtuar pikave të shitjeve të operatorëve për të kryer regjistrimin e saktë të pajtimtarit. Masa të tjera të marra nga AKEP janë ato në fushën e përmirësimit dhe forcimit të akteve nënligjore, respektivisht duke filluar që nga data 01.04.2014 hyri në fuqi formulari i ri i regjistrimit të pajtimtarit, ku pajtimtarët të cilët bënin pjesë në kontrata kolektive duhet të regjistroheshin individualisht për çdo numër që kishin në përdorim. AKEP me qëllim zhdukjen e këtij fenomeni bazuar dhe në eksperiencat e vendeve të rajonit ka propozuar dhe mbështetur ndryshimet e kryera në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë lidhur me tregtimin e paautorizuar të produkteve/kartave SIM telefonike, të cilat tashmë konsiderohen si vepër penale dhe dënohen si të tilla.

AKEP vazhdon të ndjekë me vëmendje ecurinë e këtij procesi pamvarësisht nga sa është arritur deri tani.



## 2.6. MONITORIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE, CILËSISË DHE INSPEKTIMI I VEPRIMTARISË

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Autorizimet Individuale, AKEP-i kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve dhe monitorimin e përdorimit të spektrit prej tyre.

Detyrat për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit dhe monitorimit të spektrit si dhe vendosja e masave administrative kryhen nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit. Kjo drejtori ka në përbërje të saj:

- ✚ Sektorin e Monitorimit të Frekuencave dhe Interferencave;
- ✚ Sektorin e Monitorimit të Cilësisë dhe Koordinimit të Inspektimeve.

### 2.6.1. Monitorimi i spektrit të frekuencave

AKEP në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e pikave repetitive në territorin e vendit, ka realizuar objektivat e mëposhtme:

- ✓ Monitorimin dhe kontrollin periodik të frekuencave që përdoren në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit.
- ✓ Monitorimin dhe zgjidhjen e problematikave të dala nga interferencat e operatorëve/sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.
- ✓ Bashkëpunimin ndërinstytucional.
- ✓ Bashkëpunimin rajonal lidhur me problematikat që dalin në harmonizimin e përdorimit të frekuencave në rajonet kufitare dhe interferencat.

#### ✚ Monitorimi i radiolidhjeve fikse në pikat transmetuese të vendit

Monitorimi u krye dy herë në vit në pikat e mëposhtme:

Nr.	Vendi ku u kryhen matjet	Rrethi	Periudha e matjeve
1	Kërtushaj, Vorë, Ardenicë	Durrës, Tiranë, Fier	Gjatë muajit Janar
2	Pinet, Kodër Durrës, Zvërnec,	Tiranë, Durrës, Vlorë	Gjatë muajit Shkurt
3	Likovun, Grabian, Dajt	Fier, Lushnje, Tiranë	Gjatë muajit Mars
4	Tarabosh, Tyrbe, Petresh, Krrabë,	Shkodër, Lezhë, Elbasan, Tiranë	Gjatë muajit Prill
5	Çervenakë, Korçë, Gllavë,	Pogradec, Korçë, Tepelenë	Gjatë muajit Maj

6	Sopot, Mile, Midë, Tregtan,	Gjirokastër, Sarandë, Pukë, Kukës	Gjatë muajit Qershor
7	Tarabosh, Tyrbe, Petresh, Krrabë,	Shkodër, Lezhë, Elbasan, Tiranë	Gjatë muajit Korrik
8	Çervenakë, Korçë, Gllavë,	Pogradec, Korçë, Tepelenë	Gjatë muajit Gusht
9	Sopot, Mile, Midë, Tregtan,	Gjirokastër, Sarandë, Pukë, Kukës	Gjatë muajit Shtator
10	Likovun, Grabian, Dajt	Fier, Lushnjë, Tiranë	Gjatë muajit Tetor
11	Kërtushaj, Vorë, Ardenicë	Durrës, Tiranë, Fier	Gjatë muajit Nëntor

### ➤ **Subjektet që ofrojnë Shërbim Audiovizual**

Gjatë monitorimit të pikave të mësipërme janë identifikuar disa subjekte, kryesisht ato që ofrojnë shërbim audiovizual (broadcast), të cilat përdorin lidhje fikse pa u pajisur me Autorizim Individual. Për këto subjekte në disa raste u mbajt proces-verbal ku u njoftuan për të aplikuar për lidhje fikse radio pikë-pikë dhe në disa raste të tjera u mor masa e sekuestrimit të pajisjeve.

### ➤ **Subjekte që ofrojnë shërbimet internet dhe data**

Gjatë monitorimit të pikave të mësipërme janë identifikuar disa subjekte të cilat përdorin lidhje fikse radio, për të cilat u mor masa e sekuestrimit të pjsjeve dhe vendosjes së gjobave.

### ➤ **Subjekte të cilat ofrojnë internet nëpërmjet sistemeve që operojnë në brezin e frekuencave 2.4 dhe 5.8 GHz**

Gjatë Monitorimit të pikave në të gjithë territorin e vendit janë identifikuar shumë subjekte që shpërndajnë internet duke mos respektuar rregulloren nr. 33 dt. 15.05.2014 për "*Kushtet e përdorimit të frekuencave pa Autorizim Individual dhe Kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza*".

Pikat ku përdoren më shumë këto frekuenca janë: Mali i Dajtit, Petresh, Ardenicë, Likovun, Tyrbe dhe Vorë. Gjatë monitorimit janë bërë matje të frekencave në këto breza dhe është marrë masa e sekuestrimit të pajisjeve për të gjitha subjektet që përdorin këto breza.

Disa nga këto subjekte kanë aplikuar në AKEP, për tu pajisur me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave në lidhje fikse radio. Në monitorimin që u bë në 6 mujorin e dytë të vitit u vu re se shumica e këtyre subjekteve të cilat përdornin brezin 2.4 dhe 5.8 GHz nuk i përdornin më këto frekuenca, duke gjetur alternativë të tjera për shpërndarje interneti si shpërndarje me fibër optike etj.

### ➤ **Blokim i pajisjeve dhe ndalimi i funksionimit të tyre**

Gjatë monitorimit dhe kontrollit periodik të frekuencave që përdoren në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit, në zbatim të nenit 134 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", janë bllokuar 38 pajisje transmetuese, të cilat operonin pa Autorizim Individual dhe 65 antena që operonin në frekuencat e brezit 5.8 GHz, në kundërshtim me rregulloren nr. 33 datë 15.05.2014 për "*Kushtet e përdorimit të frekuencave pa Autorizim Individual dhe Kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza*".

### ➤ **Interferenca që shfaqin rrezikshmëri**

Gjatë vitit 2014 ka patur ankesa nga subjektet e radionavigacionit brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë si:

Ankesë nga AEK (Agjensia për Komunikimet Elektronike të Maqedonisë), ankesë nga Ministria e Punëve Publike të Italisë, ankesë nga HAKOM (Autoriteti Rregullator i Kroacisë) si dhe ankesë nga Albcontroll (ANTA).

- Në rastin e ankesës nga AEK, nga monitorimi i kryer në zonën e Korçës u identifikua se dy radiot CITY FM dhe EMANUEL me pikë transmetimi në Çardhakë, Korçë intermodulonin me njëra-tjetrën duke prodhuar frekuencën intermoduluese 122.5 MHz e cila përdoret nga agjencia e trafikut ajror të Maqedonisë për komandimin e ulje - ngritjeve të avionëve. Specialistët e AKEP në këtë rast morën masën e bllokimit të radios EMANUEL e cila sinjalin e transmetimit nuk e ka sipas standartit. Në këtë monitorim morën pjesë dhe specialistë nga AMA dhe Agjensia për Komunikimet Elektronike të Maqedonisë.
- Në ankesën e bërë nga Ministria e Punëve Publike të Italisë, u krye monitorim në zonën e Shkodrës dhe u identifikua sinjali interferues i cili e kishte burimin në malin e Taraboshit. Gjatë monitorimit në këtë pikë u konstatua se subjekti ABC News përdorte një radiolidhje në frekuencën 1300 MHz (kjo frekuencë përdoret nga radari i Brindizit (Itali) për radionavigacion). Specialistët e AKEP në këtë rast morën masën e bllokimit të pajisjes.
- Në ankesën që është bërë nga HAKOM specialistët e rregullatorit Kroat kanë gjetur burimin e interferencës. AKEP i ka përcjellë AMA-s shkresën për zgjidhjen e këtij problemi.

Problematike ngelet fakti e interferencave që shfaqen në hapsirën ajrore shqiptare për avionet që tranzitojnë vendin tonë dhe janë në lartësi mbi 7 km nga toka.

Në këtë rast shqetësimin dhe zhurmat i dëgjojnë pilotët dhe jo komanduesit në tokë. AKEP nuk disponon mjete për të bërë matje në këto lartësi.

### ➤ **Interferenca që dëmtojnë cilësinë e shërbimit**

Në krahasim me vitet e tjera, për vitin 2014 nuk ka patur shumë shqetësime për interferenca, me përjashtim të ankesës që ka bërë ALBTELEKOM në lidhjet fikse radio në Sopot-Qafëgjashtë, Llogara-Palermo, Likovun Fier dhe Tregtan Kukës.

Në radiolidhjen Sopot-Qafëgjashtë specialistët e monitorimit të spektri identifikuan se në Sopot të Gjirokastrës një subjekt i cili nuk u identifikua përdorte brezin 5.9 GHz për transmetim interneti i cili interferonte linkun Sopot-Qafëgjashtë. Specialistët e AKEP në këtë rast bllokuan 5 radiolidhje të tilla që operonin në brezin e frekuencave 5.9 GHz (point to point).

Në radiolidhjen Llogara-Palermo është e njëjta situatë si në Sopot, por me subjekt UCOM.

Në radiolidhjen Likovun-Fier (12.9 GHz), u identifikua se subjekti Astrit Hoxha përdorte të njëjtën frekuencë në drejtimin Roskovec-Likovun, në këtë rast inspektorët e AKEP-it bënë sekuestrimin e të dy antenave të këtij subjekti.

Në radiolidhjen Tregtan-Kukës, gjatë matjeve që u kryen nuk u gjet ndonjë burim interferimi duke qënë se hasën vështirësi, sepse në se gjatë monitorimit të interferencës, sinjali i dobishëm nuk çkyçet, është e pamundur të gjëndet sinjali parazitar (interferues). Në shkresën që kemi dërguar tek Altelekom kemi kërkuar që të çkyçet radioja nga drejtimi Kukës-Tregtanë se do të kërkohej matje të tjera.

### **2.6.2. Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe standardet**

Gjatë vitit 2014 për monitorimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe standardet AKEP ka kryer monitorimin e segmenteve kryesorë rrugorë kombëtare.

*Qëllimi i matjeve ishte identifikimi i fuqisë së sinjalit të BTS-ve, pa gjeneruar thirrje nga telefonat celularë (Idle Mode).*

- Hartimin e raportit përmbledhës mbi mbulimin me sinjal GSM për të katër operatorët si dhe për sinjalin WCDMA për të tre operatorët të cilët ofrojnë këtë shërbim, për akset e mësipërme.
- Evidentimin e akteve me mungesë sinjali ose me nivel shumë të dobët sinjali për akset e mësipërme.
- Dërgimin e shkresave për të katër operatorët e shërbimit mobile për marrjen e masave për përmirësimin e sinjalit në akset me mungesë sinjali ose me sinjal shumë të dobët.

🇹🇫 Matje të kryera në Republikën e Kosovës në mbështetje të kushteve dhe përcaktimeve të ‘Marrëveshjes Teknike për harmonizimin e shfrytëzimit të radio frekuencave në zonat ndërkufitare’ të nënshkruar midis dy Autoritetiteve Rregullatore të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) të Republikës së Shqipërisë dhe (ARKEP) të Republikës së Kosovës, të nënshkruar në Tiranë më datë 18/01/2013 (Ref. AKEP Nr 62/3 Prot.)

- Hartimin e raportit përmbledhës mbi nivelin e sinjaleve GSM&WCDMA të operatorëve mobile të Republikës së Shqipërisë në territorin e Republikës së Kosovës.
- Njoftimi i operatorëve: Albtelecom, Plus dhe Vodafone Albania, për marrjen e masave për respektimin e parametrave teknik për zonat ndërkufitare, si dhe njoftimin pranë AKEP për marrjen e këtyre masave.

- ✚ Realizimi i matjeve për monitorimin e segmenteve rrugorë Vlorë-Sarandë dhe pikave turistike të cilat përfshihen në këto dy rrethe.

*Qëllimi i këtij raporti ishte të paraqiste gjendjen reale të katër operatoreve të telefonisë mobile dhe kushtet që duhen plotësuar në bazë të rregullores për KPI (Key Performance Indicator).*

- Hartimin e raportit përmbledhës mbi mbulimin me sinjal GSM për të katër operatorët si dhe për sinjalin WCDMA për tre operatorët të cilët ofrojnë këtë shërbim, për matjet e mësipërme, si dhe përmbushja KPI (Key Performance Indicator).
- Njoftimi për të katër operatorët e shërbimit mobile për marrjen e masave për përmbushjen e KPI (Key Performance Indicator), në bazë të rregullores të cilësisë së shërbimit.

- ✚ Takimi me përfaqësuesit e të katër operatorëve mobile në Republikën e Shqipërisë mbi mundësinë e mbulimit me sinjal për pikat turistike si: **Theth, Vermosh, Lura, Kepi i Rodonit**, duke u mbështetur në rastin e Bogës.

- ✚ “Për kryerjen e matjeve për monitorimin lidhur me zbatimin e marrëveshjes së koordinimit me Malin e Zi në brezat GSM 900/1800”, në shqyrtim të ankesës me Nr.1082, datë 23.04.2014, të sipërmarrësit ALBtelecom dhe në kuadër të monitorimit të implementimit të marrëveshjes së firmosur më datë 07.02.2014 në Podgoricë mes dy vendeve fqinje midis Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare të Republikës së Malit të Zi (EKIP), bëri monitorimin e segmentëve rrugorë Lezhë-Hani i Hotit, Hani i Hotit-Muriqan, Muriqan-Shirok, Shkodër-Lezhë dhe Lezhë-Vorë.

- Hartimin e raportit përmbledhës mbi nivelin e fuqisë së sinjalit GSM 900/1800 në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga operatorët mobile që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Malit të Zi.
- Njoftimi i rregullatorit të Malit të Zi për implementimin e marrëveshjes së firmosur më datë 07.02.2014 në Podgoricë në mes të dy vendeve fqinje midis Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Shërbimeve Postare të Republikës së Malit të Zi (EKIP).

### 2.6.3. Inspektimi

Në drejtim të veprimtarisë së inspektimit AKEP ka realizuar të gjitha objektivat e përcaktuara për vitin 2014, duke punuar me përgjegjësi, profesionalizëm dhe përkushtim me qëllim përmbushjen e detyrave të tij, në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor aktual.

## **Ndjekja e Inspektimeve dhe problematika të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.**

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, planit vjetor dhe planeve një-mujore të miratuara nga KD i AKEP, nga Drejtoria e Monitorimit të Frekuencave ,Cilësisë dhe Inspektimit gjatë vitit 2014 **janë kryer gjithsej 47 inspektime** tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm. Nga këto inspektime **46** janë bërë sipas planit vjetor të miratuar dhe një inspektim jashtë planit sipas ankesës së bërë nga një sipërmarrës i komunikimeve elektronike: “Alma 2001” sh.p.k.

Gjatë këtyre inspektimeve u konstatua se **26** sipërmarrës ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike në përputhje me kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm (disa prej të cilëve iu lanë disa detyra dhe rekomandime), dhe **17** sipërmarrës nuk kishin zbatuar rregulloret e miratura nga AKEP dhe për këto shkelje u vendosën masa administrative me gjobë sipas ligjit. Gjithashtu, nga inspektimet e realizuara u konstatua se nuk ushtronin aktivitet të komunikimeve elektronike sipërmarrësit “Levis Aura” sh.p.k, “Wirtel” sh.p.k dhe “Bindi” sh.p.k , pasi kishin kaluar në status pasiv.

Objekti i inspektimeve sipas planit vjetor ka qenë:

- Verifikimi i zbatimit të kushteve të autorizimit të përgjithshëm;
- Verifikimi i zbatimit të Rregullores për ”Portabilitetin e numrit“;
- Verifikimi i zbatimit të Rregullores për “Caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike“;
- Verifikimi i zbatimit të Rregullores për “Administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtare (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve“;
- Verifikimi i zbatimit të Rregullores për “Dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave“;
- Verifikimi i zbatimit të Rregullores “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve“ miratuar me Vendimin nr.2161, datë 21.09 2012, të Këshillit Drejtues të AKEP-it;
- Verifikimi i pajisjeve dhe aparaturave me certifikatën e konformitetit;
- Verifikimi i zbatimit të Rregullores “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”, miratuar me Vendimin nr. 1256, dt.16.04.2010, të Këshillit Drejtues.
- Verifikimi i zbatimit të Rregullores për “Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet që përdoren në këto breza”;
- Verifikimi i zbatimit të Rregullores për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në RSH”;
- Plotësimin e detyrimeve kundrejt AKEP.

### **2.6.4. Kundravajtjet administrative**

Gjatë inspektimeve, bazuar në nenin 137 të ligjit material nr.9918/2008 (indryshuar) , nenit 24 të Rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe

kundravajtjet administrative”, miratuar me VKD nr.1516, datë 31.01.2011, për 17 sipërmarrës të komunikimeve elektronike u vendos masë administrative me gjobë për shkelje të cilat janë pasqyruar në aktet e inspektimit.

Nga 17 masa administrative (me gjobë) janë arkëtuar në llogari të AKEP, 14 gjoba me vlerë **470.000 lekë** dhe 3 gjoba të pavjelura në proces ankimimi.

## **2.6.5. Bashkëpunimi**

### **🚩 Bashkëpunimi Institucional**

Për rritjen e efektivitetit të punës inspektuese për gjatë vitit 2014 specialistët e Sektorit të Monitorimit të Spektrit dhe Interferencave kanë bashkëpunuar me Sektorin e Treguesëve të Cilësisë dhe Koordinimit të Inspektimit për mbledhjen e pagesave të pa shlyera nga sipërmarrësit debitorë.

Në këtë kontekst bashkëpunimi, stuktura operative e ngritur në AKEP për ndjekjen e çështjes së debitorëve për periudhën 20 Tetor - 11 Dhjetor 2014 ka shkuar për të kontaktuar me **147** sipërmarrës debitorë ndaj AKEP, nga të cilët:

- **46** sipërmarrës kanë likujduar shumën **4.526.284 lekë** për periudhat vjetore si më poshtë vijon:
  - Për vitin 2014 kanë likujduar 30 sipërmarrës në shumën **3,886,369** lekë;
  - Për vitin 2013 kanë likujduar 7 sipërmarrës në shumën **295,655** lekë;
  - Për vitin 2012 kanë likujduar 5 sipërmarrës në shumën **279,260** lekë;
  - Për vitin 2011 kanë likujduar 2 sipërmarrës në shumën **50,000** lekë;
- **47** sipërmarrës debitorë kanë deklaruar se do të angazhohen për likujdimin e detyrimeve ndaj AKEP brenda muajit Dhjetor 2014.

Në muajin Qershor duke përdorur dhe QLMF u bë i mundur identifikimi i subjekteve që përdorin shërbimin PMR të cilët rezultojnë debitorë ndaj AKEP. Në këtë rast u detyruan pothuajse të gjithë debitorët PMR të bënin pagesat vjetore të prapambetura.

### **🚩 Bashkëpunimi ndërinstitucional**

Një rol të rëndësishëm në përmbushjen e detyrave funksionale lidhur me mbikëqyrjen e përdorimit të frekuencave nga sipërmarrësit dhe çdo subjekt përdorues i tyre sipas ligjit, luan edhe bashkëpunimi ndërinstitucional. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Sektori i Monitorimit të Spektrit dhe Interferencave ka bashkëpunuar ngushtësisht me AMA-n për marrjen e masave ndaj subjekteve broadcast që shkaktojnë interferenca.

Një ndihmë e madhe u dha dhe me rastin e vizitës së shenjtërisë së tij Papa Françesku. Në këtë rast u përdor QLMF për monitorimin e brezit VHF/UHF si dhe u rakordua puna me operatorët që ofrojnë shërbimin e telefonisë së lëvizshme për të krijuar një hapsirë të pastër (pa sinjal GSM dhe UMTS) në sheshin Nënë Tereza dhe tek përfaqësia e selisë së shenjtë në Tiranë.

### 2.6.6. Projekti ATLAS

Objekti i projektit është integrimi në një sistem Web-Gis i informacioneve hapsinore dhe jo hapsinore të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike:

- sistemeve të transmetimit të radio frekuencave
- sistemeve për infrastrukturën e komunikimeve elektronike
- integrimi i të gjithë informacioneve të infrastrukturës së komunikimeve elektronike në një sistem Web-GIS i cili i krijon mundësinë institucionit në një vendim-marrje të shpejtë mbi politikat e menaxhimit, monitorimit, kontrollit, raportimit etj.

Programi i hartuar është i konceptuar si një sistem multipërdoruesish, duke u ofruar kështu mundësinë administratorëve të sistemit, një menaxhim efikas, ndarje të roleve dhe detyrave të përdoruesve, përditësim dhe zgjerim të funksionaliteteve në të ardhmen.

#### *Sistemi përfshin:*

- Hartën e infrastrukturës së rrjetit: Kabëll Bakri (sipas operatorëve)
- Hartën e infrastrukturës së rrjetit: Fibër Optike (sipas operatorëve)
- Hartën e infrastrukturës: Bazament Antene (sipas operatorëve)
- Hartën e infrastrukturës së rrjetit: Radio (sipas operatorëve)
- Hartën e monitorimit të cilësisë së shërbimit (GSM, WCDMA, sipas operatorëve)
- Popullimi i shtresës Foto Atlasi në aplikimin ATLAS, me foto të ndryshme të antenave si dhe objekte të tjera me specifikime dhe informacione të detajuara.
- Moduli i raporteve të ndryshme për administratorët e sistemit.

Bazuar në të dhënat e administruara nga ky sistem rezultojnë rreth 4,801,895 metra kabëll fibër optike e shtrirë në të gjithë territorin e vendit. Për sipërmarrësit kryesorë, të dhënat jepen në tabelën e mëposhtme:

Spërmarrësi	Gjatësia Kabëll Optik (m)
<b>ABCOM</b>	302,154
<b>Abcom-Durres</b>	32,182
<b>Abcom-Elbasan</b>	12,840
<b>Abcom-Fier</b>	9,482
<b>Abcom-Lushnje</b>	11,510



<b>Abcom-Pogradec</b>	2,860
<b>Abcom-Shkoder</b>	30,660
<b>Abcom-Tirane</b>	202,620
<b>Abissnet (tirane)</b>	209,120
<b>Itirana</b>	111,998
<b>Nisatel</b>	395,533
<b>Nisatel Vlore</b>	155,025
<b>Nisatel Durres</b>	35,216
<b>Nisatel Harte DP</b>	205,292
<b>Ej&amp;Bi Shkoder</b>	42,598
<b>IBC Shkoder</b>	6,822
<b>Nevrus Mersuli</b>	64,382
<b>Primo</b>	237,359
<b>ATU</b>	800,381
<b>MC-Networking</b>	32,014
<b>Albtelekom</b>	2,170,477
<b>Pronet</b>	152,189
<b>Keminet</b>	14,870
<b>Apoll Net</b>	37,304
<b>Apoll Net rrjet kryesore</b>	17446
<b>Apoll Net rrjet dytesore</b>	19858
<b>Plus</b>	1,087
<b>Tring</b>	68,950
<b>Itel</b>	146,757
<b>AMC</b>	7,900

Moduli bën të mundur krijimin e hartave të prognozimit të përhapjes së sinjalit të përdorur nga operatorët që operojnë në vendin tonë, duke u bazuar në modelet më të përparura të rekomanduara nga ITU, ITU-R REC P.526, ITU-R REC P.530, ITU-R REC P.1546 për zonën e Tiranës dhe më tej.

### **2.6.7. Zhvillimi i projektit “Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Spektrit të Frekuencave për Shqipërinë”**

Më datë 7.03.2014 në Gjenevë, në selinë e ITU u zhvillua ceremonia e dorëzimit të Dokumentit “Termet e referencës për ngritjen e një Sistemi Kombëtar Monitorimi të spektrit të frekuencave për Shqipërinë”. Dokumenti i hartuar me konsulencën e ekspertëve të ITU, u dorëzua nga zoti Brahima Sanou, Drejtor i Telecommunication Development Bureau (BDT) – ITU.

Me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr.2442, datë 10.04.2014, u miratua në parim dokumenti “*Projekt për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave*”. Qëllimi i këtij projekti është të trajtojë karakteristikat thelbësore të teknikave dhe veprimtarisë së monitorimit të spektrit në një sistem të mundshëm kombëtar të vendit tonë. Ky studim për sistemin kombëtar shqiptar të monitorimit të spektrit ka filluar nga një grup pune i AKEP-it në bashkëpunim me asistencën e ITU dhe material bazë në trajtimin e çështjeve ka shërbyer Manuali i Radiomonitorimit të ITU (Radiomonitoring Handbook).

Sistemi i ri i monitorimit do të përmbajë tipet vijuese të stacioneve monitoruese Qëndër Kontrolli Kryesore (MCC) në Tiranë, mbështetur nga:

- 2 stacione fiks monitorimi (RFMS) për të mbuluar një zonë rreth 70 km rreth Tiranës për gjithë detyrat e monitorimit, përfshirë Okupimin e Brezit të Frekuencave (FBO) dhe Okupimin e Kanaleve të Frekuencave (FCO) dhe trajtimin e interferencave;
- 2 stacione të lëvizshëm monitorues (MMS) për gjithë tipet e operacioneve të monitorimit të lëvizshëm;
- 1 stacion monitorues i transportueshëm (TMS) për gjithë tipet e operacioneve të monitorimit, përfshirë FBO, FCO, dhe trajtimin e interferencave;
- 8 stacione të thjeshtë monitorues të komanduar në distance (SRFMS), për mbulimin e zonave më të largëta në Shqipëri.

Në muajin Qershor në kuadër të implementimit të projektit për ngritjen e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të spektrit të frekuencave, u hap procedura tenderuese me objekt prokurimi “*Projekt për rikostrucion të godinës të AKEP*” dhe në muajin dhjetor u lidh kontrata me firmën zbatuese të projektit.

Qëllimi i kësaj procedure është rikonstruksioni i godinës 3-katëshe të AKEP, e cila do të plotësojë të gjitha nevojat aktuale dhe të perspektivës me ambiente pune për një Qëndër Kombëtar Monitorimi të Spektrit të Frekuencave (Qëndër Kontrolli Kryesore – MCC).

Në muajin maj është njoftuar Albtelecom sh.a. se pas inspektimeve të kryera nga AKEP në bashkëpunim me ekspertin e ITU-së, studimeve të mbulimit për breza të ndryshëm në disa pika dominuese dhe analizave inxhinierike, u arrit në përfundimin se vendodhja e godinës së Albtelecom në qytetin e Krujës, plotëson kushtet për instalimin e 1 stacioni fiks monitorimi (RFMS) për të mbuluar një zonë 70 km rreth Tiranës, duke përfshirë dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Zona e sipërpërmendur është mjaft e okupuar nga radiokomunikimet dhe si rezultat është me rëndësi të veçantë për AKEP-in.

Albtelecom i është kërkuar leje për instalim në tarracën e katit të 3-të, të godinës së Albtelecom në qytetin e Krujës, të një kulle me lartësi 3.5 – 4 m, ku do të montohen antenat marrëse dhe leje për shrytëzimin e një ambienti rreth 10-12 m<sup>2</sup> që të akomodojë të gjitha pajisjet e nevojshme të monitorimit dhe të lejojë një teknik të punojë brenda.

Në muajin dhjetor është lidhur kontrata për ambientin e mësipërm me Albtelecom sh.a.

Në muajin tetor u publikua dokumenti standart i tenderit me objekt prokurimi “*Blerje pajisje marrëse që do të mbulojë diapazonin e frekuencave 20 - 3000 MHz dhe kontrollon brezin*”

VHF/UHF për matje, gjetje drejtimi dhe lokalizimi”, dhe në muajin dhjetor u lidh kontrata me fituesin e procedurës tenderuese.

Qëllimi i këtij prokurimi është blerja e pajisjes marrëse që do të mbulojë diapazonin e frekuencave 20 – 3000 MHz dhe duhet të kontrollojë brezin VHF/UHF për matje, gjetje drejtimi dhe lokalizimi, e cila do të jetë e gjeneratës që përdor teknologji dixhitale për filtrimin dhe procesimin e sinjaleve për të bërë të mundur funksionimin e stacionit të parë fiks të monitorimit (RFMS), për mbulimin e një zone prej 70 km rreth Tiranës, duke përfshirë dhe Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

#### **2.6.8. Përmirësimi dhe plotësimi i akteve administrative normative:**

Me qëllim përmirësimit dhe plotësimin e kuadrit rregullator lidhur me normimin e veprimtarisë së inspektimit dhe monitorimit gjatë vitit 2014 janë nxjerrë nga AKEP:

➤ **Rregullore Nr.34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”**

Drejtorja e Monitorimit të Frekuencave, Cilësisë dhe Inspektimit në hartimin e Aktit Administrativ Rregullor Nr.34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” ka marrë në konsideratë përcaktimin në mënyrë të qartë të:

- Procedurave të inspektimeve që kryen nga AKEP në zbatim të detyrimeve dhe ushtrimit të kompetencave ligjore, gjatë kontrollit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (*sipërmarrësve*) dhe postare, si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike (*subjekti*) sipas ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, akteve nënligjore, si dhe akteve administrative të nxjerra nga AKEP, në zbatim të këtij ligji;
- Procedurave të monitorimit të spektrit të frekuencave me qëllim që spektri i frekuencave të përdoret vetëm nga përdoruesit e lejuar, sipas dispozitave të ligjit 9918, i ndryshuar dhe krijimi i një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike;
- Rregullave mbi konstatimin dhe shqyrtimin e kundravajtjeve administrative nëpërmjet inspektimit, monitorimit të spektrit të frekuencave dhe veprimit “kryesisht” të AKEP, përcaktimi i procedurave dhe i afateve të ankimit ndaj akteve të monitorimi-inspektimit të AKEP që vendosin masa administrative, si dhe i procedurave të ekzekutimit të sanksioneve administrative.

Rregullorja “Për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative”, është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm i cili i shërben inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe postare ose çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, monitorimi i spektrit të frekuencave dhe vendosja e sanksioneve në rastet e vërtetimit të

kundërvajtjeve administrative, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore, kompetencat e AKEP dhe parimet e së drejtës.

➤ ***Rregullore Nr.35 datë 23.12.2014 për “Administrimin e Interferencave”***

Bazuar në objektivat e përcaktuara në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, është hartuar dhe miratuar nga KD i AKEP “Rregullorja për administrimin e interferencave”, ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar objektivat kryesore:

- Përcaktimi i Procedurës së administrimit të interferencave.
- Eliminimi ose minimizimi i interferencave të dëmshme për të krijuar një mjedis të përshtatshëm dhe pa interferenca të dëmshme për operimin e sistemeve dhe të stacioneve të transmetimit radio, që do të përdoren për qëllime private ose publike.
- Lokalizimin dhe identifikimin e Interferencave si rrjedhojë e përdorimit të paisjeve të pautorizuara
- Monitorimin e frekuencave dhe masat e vecanta që aplikohen në rastet e përfshirjes në interferenca të stacioneve të huaja.

Si rrjedhojë gjatë hartimit të kësaj Rregulloreje dhe duke marrë parasysh domosdoshmërinë e imlementimit të saj, ju kushtua vëmendje pjesëve thelbësore dhe integruese ndër të cilat vlen të përmendim:

- administrimin e interferencave duke patur parasysh objektivat e sipërcituara,
- tipet e interferencave zhurmat elektrike dhe zhurmat e radios, arsyet që shkaktojnë interferencat,
- ndjeshmëria pra përdoruesi i autorizuar duhet të vlerësojë paisjen për ndjeshmëri ndaj ndërhyrjeve në përputhje me standartet e përcaktuara për shmangien e rrezatimit jashtë brezit dhe rrezatimit të paligjshëm,
- identifikimin e burimit duke iu referuar faktit që përdoruesi i autorizuar n.p.m ankesës për interference duhet të japë detaje të ndërhyrjes për të mundësuar përcaktimin e vendodhjes së burimit të interferencës,
- si dhe detaje mbi shpeshësinë dhe nivelin e interferencave, e cila do të ndihmonte Autoritetin në këtë drejtim në kryerjen e detyrës,
- interferencat e lejuara në përputhje me përcaktimet e PKF,
- ndërhyrja ndaj përfituesve publikë dhe aparateve celulare, ndërhyrjet në paisje të tilla duhen raportuar nga ofruesi i shërbimit,
- ndërhyrjet në hapësirën ajrore si dhe në sistemet e sigurisë publike,
- procedura e ankesës për interferencat n.p.m depozitimit në AKEP të Formularit në Modulin e Aplikimeve On-Line,
- veprimtarinë e AKEP lidhur me këtë çështje pas pranimit të ankesës për interferencën nëpërmjet analizimit të ankesës dhe vlerësimit të përshtatshmërisë për të ndërmarrë veprime,
- koordinimi me vende të tjera si dhe me ITU për detyrat dhe orientimet në lidhje me analizën dhe zgjidhjen e ndërhyrjes, monitorimi dhe zbatimi i brezit.

## **2.7. ÇËSHËTJE QË LIDHEN ME TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT, ADMINISTRIMIN E DOMAIN CC.TLD.AL DHE NËN DOMAIN-EVE TË TIJ, SI DHE APLIKACIONET**

Tregu i ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve me brez të gjerë tashmë në Shqipëri përfaqëson një treg në rritje dhe me një zhvillim tepër dinamik në sinkron të plotë me zhvillimin që ky treg po pëson në Rajon, Europë dhe Botë. Duke patur parasysh këtë fakt, kompetencën ligjore që disponon AKEP si administrator i domaincc.TLD.AL, nën domainet e tij, dhe ENUM, si dhe aplikacionet si një aspekt shumë i rëndësishëm i së tashmes dhe prespektivës së teknologjisë së informacionit, AKEP gjatë vitit 2014 dizenjoi dhe bëri pjesë të strukturës dhe organikës tij Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Aplikacioneve.

Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë së Teknologjisë Informacionit dhe Aplikacioneve (DTIA) është kryerja e detyrave që lidhen me zbatimin e detyrimeve dhe ushtrimin e kompetencave ligjore të AKEP-it për shërbimet me brez të gjerë, aksesin në internet, administrimin e Domain.al, si dhe mbështetja teknike për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit të brendshëm dhe aplikacioneve që përdoren për ofrimin e shërbimeve ndaj sipërmarrësve dhe të tretëve

Funksionet kryesore të drejtorisë janë:

- Administrimi i domaincc.TLD.AL, nën domainet e tij, si dhe ENUM.
- Trajtimi i çështjeve që lidhen me aksesin në internet, shërbimet me brez të gjerë dhe masat mbrojtëse.
- Administrimi i sistemeve on line të shërbimeve administrative dhe rregullatore që kryen AKEP.
- Administrimi i aplikacioneve të AKEP.
- Studime, analiza dhe hartimi akte rregullatore për çështje që lidhen me objektin e veprimtarisë së drejtorisë.

Në përbërje të drejtorisë janë:

- 🚧 Sektori i Administrimit të Domain.AL dhe Shërbimeve me Brez të Gjerë;
- 🚧 Zyra e IT dhe Aplikacioneve

### **2.7.1. Ushtrimi i kompetencave ligjore mbi ofrimin shërbimeve me brez të gjerë dhe aksesin në internet**

#### **🚧 Formulimi, miratimi dhe ndjekja e zbatimit të strategjisë së AKEP për broadband.**

Mjetet e përdorimit të internetit janë të shumta, ku përfshihen kompjuterat, telefonat smart, tabletet, etj me të cilat konsumatorët sot kanë mundësinë që nëpërmjet internetit të aksesojnë live online video, video dhe muzikë në kanale media, të jenë online si pjesë e rrjeteve sociale, të kryejnë pagesa online madje edhe të identifikohen online. Të gjitha këto dhe të tjera shërbime, të

transferuara me shpejtësi të lartë, përbëjnë ato që quhen komunikime me brez të gjerë ose broadband.

Por broadband nuk ka të bëjë vetëm me rritjen e shpejtësive të transferimit të informacionit për përdoruesit në rrjete të ndryshme. Broadband sot është një element kyç në ekonominë e vendit për një zhvillim të qëndrueshëm. Përfitimet nga komunikimet broadband e kanë tejkaluar shoqërinë e informacionit dhe komunikimit dhe janë bërë të domosdoshme në sektorë të tjerë të ekonomisë dhe shoqërisë përfshirë edukimin, shëndetësinë, transportin, energjinë, financat, etj.

Shqipëria si vend në zhvillim ka bërë dhe po ben përpjekje të vazhdueshme në lidhje me nxitjen dhe zhvillimin e *broadband* në Shqipëri dhe në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për të përmirësuar disponueshmërinë, përballueshmërinë dhe aksesueshmërinë e shërbimeve të komunikimeve broadband. Qeveria Shqiptare ka miratuar një sërë ligjesh dhe dokumenta strategjike ku veçohen:

- Ligji nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike”
- Strategjia Kombëtare për zhvillimin e TIK në Shqipëri
- Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike
- Plani Kombëtar për Zhvillimin e Broadband

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) si institucion me ndikim të madh në zhvillimet broadband në Shqipëri, mbështet çdo iniciativë për zhvillimin e broadband, bazuar në përcaktimet ligjore si dhe rekomandime apo vendime të organizatave ndërkombëtare si Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU), Trupi i Rregullatorëve Europianë për Komunikimet elektronike (BEREC), etj.

Në vitet e fundit Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshem në zhvillimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve broadband për pajtimtarët.

Numri i operatorëve që ofrojnë shërbime broadband dhe internet nëpërmjet rrjeteve fikse të komunikimeve elektronike aktualisht është rreth 80 ndërsa kemi 4 operatorë që ofrojnë shërbime broadband nëpërmjet rrjeteve mobile.

Numri i pajtimtarëve të cilët kanë akses në internet broadband nga rrjetet fikse deri në fund të 2014 është 206 mijë ndërsa akses në internet broadband nga rrjetet mobile 3G kanë rreth 1 milion pajtimtarë.

Vlen të theksohet se pikë kyç për zhvillimin e mëtejshëm të broadband janë rrjetet e komunikimeve elektronike të bazuara në fibër optike.

Aktualisht në Shqipëri janë të instaluar afërsisht 5000 km fibra optike në rrugë kryesore ndërrurbane dhe në zona urbane deri në fund të vitit 2014.

Bazuar në detyrat funksionale janë kryer:

1. Analizë e shërbimeve me Brez të Gjerë (Broadband) e cila është bazuar në dokumentet e mëposhtme

- a. Planin Kombëtar për Zhvillimin e Broadband miratuar me VKM nr. 468 datë 30.05.2013.
  - b. Analizën e tregut me shumicë të aksesit broadband internet: Tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e plotë dhe të përbashket-LLU) nga vendodhje fikse; si dhe Tregu me shumicë i aksesit broadband (bitstream) miratuar me VKD nr. 2416 datë 04.02.2014.
  - c. Strategjinë e Qeverisë Shqiptare për Kalimin nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Dixhitale e Këshillit të Ministrave.
  - d. Dokumentet e AKEP miratuar me VKD që kanë lidhje me shërbimet me brez të gjere.
  - e. Dokumente të tjera të rëndësishme dhe shumë të nevojshme, si:
    - ITU & Cisco - Planinng for Progress - National Broadband Plans
    - ITU - Broadband Reports - Impact of Broadband on the Economy
    - ITU - Case Study Albania - Strategies for the promotion of broadband services and infrastructure, Case Study Macedonia, Romania, etc
    - ITU - Regulating broadband prices
    - ITU GSR 2014 - Monitoring implementation of Broadband Plans and Strategies
    - BEREC - Broadband Promotion Report 2013
    - BEREC – Report on mobile broadband prices
    - European Commission - Trends in European broadband markets
    - European Comission - Quality of Broadband in Europe 2013
    - OECD - Broadband Growth Policies
    - OECD - National Broadband Plans
    - UNDP - ICT for Development
    - World Bank - Building broadband - Strategies and policies
    - IRG - FSR Study on Broadband Promotion
2. Gjatë muajve tetor, nëntor dhe dhjetor 2014 është punuar për hartimin e dokumentit të AKEP për Broadband çështje e cila është në ndjekje e sipër dhe që kërkon kohë si dhe kontribut nga të gjitha drejtoritë e AKEP, për të përfshirë të gjitha detyrimet ligjore, VKM-të, aktet rregullatore dhe VKD-të e AKEP, rekomandimet e ITU, BEREC etj në këtë Strategji.
3. Me qëllim vlerësimin dhe analizimin e situatës së Broadband në Shqipëri, është kryer përgatitja e informacionit (të dhënave) që do tu kërkohen operatorëve dhe kryesisht për:
- a) Internet Exchange Points dhe Data Rooms, etj.
  - b) Kapacitetet e aksesin ndërkombetar në internet dhe kapacitetet me shumice që ju shesin ISP-ve të vogla në Shqipëri.
  - c) Internetin në shkolla.
  - d) Numrin e perdoruesve Internet 3G/Edge.
  - e) Km e fibres se shtire nga operatorët kryesore te fibres optike dhe në vecanti për FTTH të shtrirë, në shtrirje apo në planet e aferta për tu shtrirë (zonat, numri i FTTHve, FTTH aktive, etj).
  - f) Shpërndarjen e abonentëve nëpër rrethe, bashki dhe komuna, mënyrat e lidhjes së tyre, plane të aferta për rritjen e shtrirjes, etj).
  - g) Abonentet biznes të tyre.
  - h) Shërbimet Triple Play.
  - i) Kërkesa të tjera sipas Analizes Broadband miratuar me VKD nr. 2416 datë 04.02.2014

## **✚ Administrimi dhe mirëmbajtje e sistemeve informatike dhe rrjetit kompjuterik të AKEP:**

Bazuar në detyrat funksionale të drejtorisë përgjegjëse është kryer administrimi dhe manaxhimi i sistemeve IT, ku vlen të theksohet se ecuria dhe gjendja e sistemeve ka qënë optimale dhe nuk ka patur nderprerje të shërbimeve për punonjësit e AKEP, përveç disa shkëputjeve të shkurtra të aksesit në internet nga ana e ISP, por që janë brenda kushteve të marrëveshjes së nivelit të shërbimit përkatës. . Kryesisht është kryer:

- Menaxhim i sistemeve Mailserver, Active Directory, FileServer.
- Administrimi dhe monitorim i ecurisë së punës dhe problematikave të sistemit E-Arkiva.
- Menaxhim i user-ave dhe raportimi i problematikave të tyre në lidhje me sistemet informatike si E-Protokoll, Mail Server, etj.
- Kryerja e trajnimeve në nivel drejtorie dhe personale për sistemin E-Protokoll.
- Administrim dhe mirëmbajtje e rrjetit informatik, server-a pajisjeve elektronike PC, printer, switch-e, firewall dhe centralit telefonik.

## **✚ Bazuar në Planin e Punës për vitin 2014 janë përfunduar me sukses këto projekte kryesore:**

### **➤ Përfundimi i projekti DMS (Document Management System):**

- ✓ Instalimi i aplikacionit në të gjithë punonjësit e AKEP
- ✓ Trajnimi i stafit
- ✓ Sistemi është në funksionim të plotë dhe aktualisht lëvizja e shkresave të portokollit bëhet nëpërmjet Revzone (DMS).
- ✓ Implementimi i këtij projekti ka rezultuar në:
  - Rritjen e cilësisë së shërbimit nëpërmjet një menaxhimi më efikas dhe më të shpejtë të materialeve shkresore dhe lëvizjes së shkresave.
  - Minimizim të kohës së nevojshme për përpunimin e këtyre materialeve shkresore
  - Analizë e detajuar e ngarkesës dhe kapaciteteve të nevojshme për çdo drejtori nëpërmjet raporteve të ndryshme të gjeneruara nga ky system.

### **➤ Përmirësimi i dhomës së serverave. (Upgrade i Server Room):**

Përmirësimi i kushteve dhe infrastrukturës fizike të dhomës së serverave. Vendosja e dyshemesë dhe e sistemit të ftohjes. Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe reagimit ndaj problemeve. Aktualisht sistemet informatike të AKEP janë në kushte optimale të operimit.

### **➤ Ngritja e Qendrës së rikuperimit të të dhënave:**

Ka përfunduar me sukses lidhja e dhomës së serverave me “data recovery site” dhe realizimi i komunikimit midis tyre. Si rezultat kemi një link fizik midis dhomës së serverave dhe ambienteve të rikuperimit të të dhënave si dhe konfigurimi i Back-Up për aplikacionet që ofrojnë shërbimet e AKEP ndaj përdoruesve, ATLAS dhe DMS.



## ➤ Firewall Cluster:

Duke vazhduar politikat e DTIA për optimizimin dhe disponueshmërinë e lartë të nivelit të shërbimit në infrastrukturën informatike ka përfunduar me sukses redundanca në pikën e lidhjes së AKEP me aksesin në internet.

## 🚩 Mbyllja e faqeve të internetit me përmbajtje të paligjshme

AKEP në bashkëpunim dhe me kërkesë të Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojrave Të Fatit në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në” nenin 15, pika 1.e) të ligjit nr. 9918/2008, i ka kërkuar ofruesve të shërbimit të Internetit (ISP) mbylljen e faqeve të internetit të cilat kanë në përmbajtje lojëra fati online. Aktualisht rezultojnë të bllokuara rreth 500 faqe të cilat kanë në përmbajtje lojëra fati online. AKEP në bashkëpunim edhe me MIAP dhe NJMLF ka zhvilluar disa takime konsultative dhe orientuese me këta sipërmarrës në lidhje me ndalimin e website të cilat janë në shkelje të ligjit.

AKEP gjithashtu në vazhdimësi bazuar në vendimet dhe kërkesat që vijnë nga Zyra Shqiptare e të Drejtave të Autorit u ka kërkuar dhe janë mbyllur nga ana e ofruesve të shërbimit të Internetit (ISP), një sërë faqesh interneti të cilat shkelin të drejtat e autorit etj.

### 2.7.2. Administrim i sistemeve cctld .al

Nr. domain-eve të regjistruar për vitin 2014 është **4960** dhe kemi një numer total prej **13760** domain-e.

Është kryer administrimi dhe mirëmbajtja e *root server-ave të .al*, procesimi i aplikimeve kryesisht për regjistrim dhe modifikim teknik në përputhje me Rregulloren nr.2 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin e domain-eve nën zonën .al dhe nën domain-eve .gov.al, .edu.al, .org.al, .com.al, .mil.al, .net.al”, e ndryshuar.

Me vendimin nr.2513, datë 06.11.2014 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2, datë 21.02.2008 për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al” e ndryshuar.

Këto ndryshime i dhanë një nxitje të mëtjshme regjistrimit të domain-eve nëpërmjet regjistruarëve të akredituar dhe gjithashtu u mundësoi të gjithë subjekteve që kanë domain-e të regjistruar pranë AKEP të zgjidhnin regjistruarët e preferuar dhe të kalonin domain-et e tyre tek regjistruarët preferencialë. Ky proces u realizua nëpërmjet këshillimit publik me sipërmarrësit dhe të interesuarit.

Aktualisht që nga muaji maj 2013 janë 5 regjistrarë të autorizuar nga AKEP , të cilët janë:

- 1) **Albtelecom sh.a.**
- 2) **Keminet sh.p.k.**
- 3) **ShqiperiaCom sh.p.k.**

- 4) Studio Driar
- 5) Webhost sh.p.k.

Numri në total i domain të regjistruar nën zonën .al deri në dhjetor 2014 është 13760. Më poshtë jepet një tabelë e domain-eve të regjistruar sipas zonës .al dhe nën zonave, duke bërë dhe krahasim midis viteve. Sikurse shihet vazhdon rritja me përqindje të lartë nga viti në vit për regjistrim e domain-eve në .al. Këtë vit kemi patur afro 5000 domain-e të regjistruar ndërkohë që numri i domain-eve të rinovuar nuk ka qënë i lartë. Ka patur mbi 3000 domain-e të cilët nuk janë rinovuar.

Më poshtë do të gjeni në formë tabelare të dhënat e detajuara të numrit të domain-eve.

Domain	Numri i domain-eve të regjistruar, 1998-2009	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2010	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2011	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2012	Numri i domain-eve të regjistruar , deri 2013	Numri i domain-eve të regjistruar, deri 2014
.al	1182	3912	6200	8334	11466	<b>12530</b>
.com.al	309	435	544	630	748	<b>676</b>
.gov.al	160	192	273	301	337	<b>265</b>
.org.al	93	93	116	134	165	<b>145</b>
.edu.al	75	81	124	133	129	<b>106</b>
.net.al	12	18	23	28	35	<b>30</b>
.mil.al	8	8	8	8	8	<b>2</b>
<b>Total</b>	<b>1893</b>	<b>4793</b>	<b>7387</b>	<b>9568</b>	<b>12888</b>	<b>13760</b>

Gjithashtu është kryer administrimi i sistemeve mbështetëse të cctld.al si:

- ✓ Monitorim i aksesit të jashtëm të Sistemit DNS, lidhjet perkatëse me ISP, ku shërbimi është ofruar nga 2 ISP, linja primare nga ABCOM dhe linja sekondare me Albtelecom kanë qënë në nivelin e kërkuar, pra një aksueshmeri në internet prej 100% për cctld .al.
- ✓ Monitorim dhe administrim i sistemit FRED, sistem i menaxhimit të domain .al.
- ✓ Ndjekja e problematikës dhe implementimi i zgjidhjeve për raportimet e regjistruarve të akredituar
- ✓ Administrim i kërkesave të ndryshme për kërkim informacioni lidhur me domain nën .al, procedim në përputhje me aktet ligjore të kërkesave për kufizim akses lidhur me website të cilat transmetojnë përmbajtje në shkelje të ligjit nga ZSHDA, etj.
- ✓ Kthim përgjigje të praktikave në lidhje me cctld .al, masat mbrojtëse, sigurinë, etj.

## **2.8. ZHVILLIMI I KUADRIT NËNLIGJOR RREGULLATOR, ZBATIMI I LIGJSHMËRISË DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PËRDORUESVE**

Në mbështetje të përmbushjes së rolit dhe funksioneve në drejtim të zhvillimit të kuadrit nënligjor rregullator, dhenies së asistencës ligjore për zbatimin e ligjshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve, në strukturën dhe organikën e AKEP është ngritur Drejtoria e Shërbimeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Përdoruesve.

Një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së AKEP për vitin 2014, konsiston në realizimin e objektivave për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator për funksionimin e tregut të shërbimeve elektronike dhe atij postar, për të transpozuar ndryshimet e ndodhura në legjislacionin parësor për komunikimet elektronike dhe përafrimin e tij me legjislacionin e BE me synim:

- sigurimin e realizimit të interesave të përdoruesve të shërbimeve elektronike dhe postare nëpërmjet procedurave ligjore dhe transparente të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për të patur përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike për të zgjedhur çmimin dhe cilësinë;
- në sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare në mbrojtje të interesave të tyre për të dhënat personale dhe privatësinë;
- në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të komunikimeve elektronike duke siguruar barazi në trajtimin e tyre dhe mosdiskriminim;

si dhe,

- në mbrojtje të interesave ligjore të institucionit nëpërmjet përfaqësimit ligjor në proceset gjyqësore ku AKEP është palë ndërgjyqëse.

### **2.8.1. Plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit nënligjor rregullator të fushës**

Një ndër aspektet më të rëndësishme të veprimtarisë së AKEP gjatë vitit 2014 ka qenë zhvillimi i kuadrit nënligjor rregullator në zbatim të përcaktimeve të parashikuara në legjislacionin material të fushës dhe implementimi i kërkesave që rrjedhin nga zhvillimet legjislative të BE.

**Në këtë drejtim vlen të përmendet përafrimi me aktet poshtëshënuar:**

**Direktiva 2009/140/EC** e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 25 nëntor 2009, e cila ka amenduar Direktivën 2002/21/EC “Mbi kuadrin rregullator të përbashkët për komunikimet elektronike”, Direktivën 2002/19/EC “Për aksesin interkoneksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe facilitetetve shoqëruese dhe Direktivën 2002/20/EC “Për Autorizimin e Rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, Direktiva 2009/136 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 Nëntorit 2009, e cila amendon Direktivën 2002/22/EC për

shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike,

**Direktiva 2002 / 58 / EC** lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike, dhe Rregulloren Nr. 2006 / 2004 të KE për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kombëtare përgjegjëse për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit në tregjet përkatëse

**Direktiva 2009/114 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 Shtator 2009, e cila amendon Direktivën 87/372/EEC për brezat e frekuencave që duhet të rezervohen për prezantimin e koordinuar të komunikimeve publike të lëvizshme tokësore dixhitale pan-Evropiane në Komunitet

**Direktiva e Komisionit 2008/63/EC** e datës 20 Qershor 2008 për konkurrencën e tregjeve pajisjet fundore të telekomunikacioneve

**Direktiva 2008/6 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 20 Shkurtit 2008, e cila amendon Direktivën 97/67/EC lidhur me realizimin e plotë të tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit

**Direktiva 2002/77 / EC**, 16 Shtator 2002, për konkurrencën në treg për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike

**Direktiva 2002/22 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 7 Marsit 2002 për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal) e amenduar me Direktivën 2009 / 136 / EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 Nëntorit 2009

**Direktiva 2009/114 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 Nëntorit 2009, e cila amendon Direktivën 87/372/EEC për brezat e frekuencave që duhet të rezervohen për prezantimin e koordinuar të komunikimeve publike të lëvizshme tokësore dixhitale pan-Evropiane në Komunitet

**Direktiva e Komisionit 2008/63/EC** e datës 20 Qershor 2008 për konkurrencën e tregjeve pajisjet fundore të telekomunikacioneve

**Direktiva 2008/6 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 20 Shkurtit 2008, e cila amendon Direktivën 97/67/EC lidhur me realizimin e plotë të tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit

**Direktiva 2009/114 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 14 Dhjetorit 2005, e cila shfuqizon Direktivën e Këshillit 90/544/EEC për brezat e frekuencave të caktuara për prezantimin e koordinuar të shërbimit radio paging tokësor public pan-Evropian në konsultimet e Komunitetit

**Direktiva 2002/77 / EC**, 16 Shtator 2002, për konkurrencën në treg për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike

**Direktiva 2002/22 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 7 Marsit 2002 për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve

elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal) e amenduar me Direktivën 2009 / 136 / EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 Nëntorit 2009

**Direktiva 2002/22 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 7 Marsit 2002 për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrejetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal)

**Direktiva 2002/21 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 7 Marsit 2002 për një kuadër rregullator të përbashkët për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kuadër), amenduar me Rregulloren (KE) Nr. 717/2007 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Qershorit 2007, Rregulloren (KE) Nr. 544/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 18 Qershorit 2009 dhe Direktivën 2009/140/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 Nëntorit 2009

**Direktiva 2002/21 / EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 7 Marsit 2002 për një kuadër rregullator të përbashkët për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kuadër)

**Direktiva 2002/20/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 7 Marsit 2002 për autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (Direktiva e Autorizimit), amenduar me Direktivën 2009/140/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 Nëntorit 2009

**Direktiva 1999/5/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 9 Marsit 1999 për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre

**Direktiva 98/61/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 24 Shtatorit 1998, e cila amendon Direktivën 97 / 33 / EC lidhur me portabilitetin e numrit dhe parazgjedhjen e bartësit

**Direktiva 97/13/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 10 Prillit 1997 për një kuadër të përbashkët për autorizimin e përgjithshëm dhe licencat individuale në fushën e shërbimeve të komunikimeve elektronike

**Rekomandimi 2007/879/EC** (Rekomandim mbi tregjet relevante)

**Rekomandimi 2009/396/EC** (Rekomandimi mbi tarifën e terminimit)

COM 2002/C 165/03 (**Udhëzimet për FNT**)

*Për këtë qëllim gjatë vitit 2014 janë hartuar nga strukturat përgjegjëse dhe miratuar nga Këshilli Drejtues gjithsej **10 akte normative administrative (Rregullore)** nga të cilat **6 akte përmirësuese me shtesa dhe ndryshime në aktet ekzistuese dhe 4 akte të reja në plotësim të kuadrit rregullator.***

1. Vendim Nr.2419, datë 06.02.2014 Për “Miratimin e Dokumentit për këshillim publik “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore Nr. 13, datë 16. 04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar”;
2. Vendim Nr.2422, datë 19.02.2014 Për “Miratimin e Formularëve të Regjistrimit për përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si pjesë e dokumentit, Rregulla për

*“Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtitimit për Lidhjen dhe Aksesin në Rrjetin Publik të Komunikimeve Elektronike”*, miratuar me Vendimin nr. 2405, datë 26.12.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP;

3. Vendim Nr. 2429, datë 13.03.2014 Për *“Miratimin e dokumentit “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””* dhe publikimin e qëndrimit të AKEP mbi komentet e palëve të interesit;
4. Vendim Nr.2443, datë 10.04.2014 Për *“Miratimin e dokumentit “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””*, e ndryshuar.
5. Vendim Nr.2479, datë 10.04.2014 Për *“Miratimin e disa shtesave dhe dryshimeve në Rregullore Nr.13, datë 16.04. 2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, e ndryshuar, dhe publikimin e mendimeve dhe komenteve të paleve te interesuara mbi ëshillimin publik te realizuar për këtë dokument”*.
6. Vendim Nr. 2500, datë 22. 09. 2014 Për *“Miratimin e dokumentit përfundimtar për “Kryerjen e studimit mbi pagesat që janë burim financimi në AKEP” dhe propozimeve për miratim në Këshillin e Ministrave””*.
7. Vendim Nr.2509, datë 30.2014 Për *“Miratimin e dokumentit për Këshillim Publik “Rregullore për Inspektimin, Monitorimin e Spektrit të Frekuencave dhe Masat Administrative ”*;
8. Vendim Nr.2510, datë 30.10.2014 Për Miratimin e dokumentit për këshillim publik *“Rregullore për administrimin e interferencave”*;
9. Vendim Nr.2513, datë 06.11.2014 për miratimin e dokumentit *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 2 datë 21.02.2008 për “Rregjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .al dhe nëndomain-et gov.al, mil.al edu.al, com.al, org.al, dhe net. al e ndryshuar”*.
10. Vendim Nr.2516, datë 06.11.2014 Për *“Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 12, datë 07.04.2010 “Per te dhenat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarresve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”*;
11. Vendim Nr.2521, datë 06.11.2014 Për Miratimin e dokumentit për disa ndryshime në Rregulloren Nr. 20 datë 19.02.2010 *“Pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike”*.

➤ **(Përafrimi me Direktivën 97/67/EC e ndryshuar nga Direktiva 2002/39/EC Direktiva 2008/6EC)**

Shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, rregullohen me ligjin Nr. 8530, datë 23.09.1999 *“Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (**Ligji 8530**). Ky ligj ka pësuar

disa ndryshime gjatë periudhës 1999 – 2010, por mbetet pjesërisht i harmonizuar me direktivat e BE-së për shërbimin postar.

Gjatë vitit 2014, Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) nxorri për këshillim publik projekt-ligjin e ri “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i cili synon reflektimin e direktivave më të fundit të KE-së (viti 2008) për shërbimin postar në legjislacionin Shqiptar.

AKEP ka marrë pjesë në procesin e hartimit të projekt-ligjit si dhe në takimet e zhvilluara nga MIAP me lojtarët e tregut për këtë projekt-ligj, duke kontribuar me komente specifike për përmirësimin e projekt-ligjit, me qëllim përafrimin e legjislacionit kombëtar për sektorin postar me *acquis* të BE-së, i cili synon liberalizimin e plotë të tregut dhe plotësimin e nevojave të tregut të brendshëm për shërbimet postare duke siguruar, nëpërmjet një strukture rregullatore të përshtatshme, ofrimin e shërbimeve postare efçente, të besueshme dhe me cilësi të mirë, të disponueshme për të gjithë qytetarët. Vëmendje e veçantë i është kushtuar sigurimit të shërbimit postar universal, për ofrimin e një minimumi shërbimesh me çmime të përballueshme, për përfitimin e të gjithë përdoruesve pavarësisht vendndodhjes së tyre gjeografike. Në komentet e dhëna janë marrë në konsideratë përvoja në vendet e rajonit si dhe situata aktuale në sektorin postar në Shqipëri.

### **2.8.2. Ushtrimi i kompetencës ligjore të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve**

Në kompetencat ligjore të AKEP-it përfshihet edhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9918/2008.(i ndryshuar)

Në varësi të problematikës/objektit, nëpërmjet strukturës përgjegjëse në bashkëpunim me strukturat e tjera sipas organikës, AKEP është angazhuar në ndjekjen e proçedimeve administrative si vijon:

#### **✚ Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.:**

- Vendimi Nr. 2354, datë 27.09.2013 Për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis sipërmarrësve Albtelecom Sh.A. dhe Vodafone Albania Sh.A.”
- Vendimi Nr. 2420, datë 06.02.2014 Për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 2354, datë 27.9.2013, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.”.

#### **✚ Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a:**

- Vendimi Nr. 2486, datë 26.06.2014, Për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. në lidhje tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare”.  
Vendim Nr. 2503, datë 22.9.2014 për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 2486, datë 26.6.2014, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. – Albtelecom sh.a. në lidhje me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare”.

#### **✚ Procedimi administrativ midis sipërmarrësve Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a:**

- Vendimi Nr. 2486, datë 26.06.2014, Për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Nisatel sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. në lidhje tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare”.

#### **✚ Në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera në varësi të objektit të ankimit janë trajtuar tete Ankime Administrative:**

- Vendimi nr. 2423, datë 27.2.2014, Për “*Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. dhe kërkesat e sipërmarrësve Alban Tirana Nascendo Al sh.p.k dhe Mediatel sh.p.k për ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Albtelecom, të miratuar me Vendimin nr. 2403, datë 26.12.2013 të AKEP*”;  
Trajtuar dhe kthyer përgjigje ankesave të Albtelecom sh.a. dhe Vodafone sh.a. në lidhje me VKD nr. 2405, datë 26.12.2013 për “*Termet e përgjithshme të kontratës së pajtimit*”;
- Vendimi Nr. 2425, datë 27.02.2014, Për “*Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a ndaj Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 2406 datë 26.12.2013 mbi miratimin e dokumentit “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në Shqipëri*”;
- Vendimi Nr.2444, datë 10.04. 2014 Për Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 2415, datë 04.02.2014 për “*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qira dhe vendosjen e masave rregulluese*”.
- Vendimi Nr.2445, datë 10.04.2014 “ *Për Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 2417, datë 04.02.2014 për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit për infrastrukturën fizike (LLU)*”.
- Vendimi Nr.2482, datë 15.05.2014 Për “*Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albanian Mobile Communications sh.a., ndaj Vendimit nr. 2431, datë 13.3.2014 dhe Vendimit nr. 2433 datë 13.3.2014*”.



- Vendimi Nr. 2483, datë 15.05.2014, Për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të Plus Communication sh.a., ndaj Vendimeve të AKEP nr. 2431, nr. 2432, nr. 2433, nr. 2434 dhe 2435 të datës 13.3.2014, “Për rishikimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare””;
- Vendimi Nr. 2485, datë 26.06.2014 “Për Shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone Albania sh.a. ndaj sipërmarrësit Plus Communication sh.a., për shkeljet në lidhje me shërbimin e fshehjes së identifikimit të thirrjes”.

Vendimi Nr. 2497, datë 8.9.2014 Për “Shqyrtimin e ankimit administrativ të ABCOM sh.p.k., SINTEL sh.p.k, TELE.Co Albania sh.p.k, SABATEL sh.p.k., dhe NISATEL sh.p.k, ndaj Vendimit të AKEP nr. 2489, datë 26.6.2014, “Për disa ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Albtelcom sh.a. në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse””.

### 2.8.3. Kontrolli administrativ i akteve të nxjerra nga AKEP-i, përfaqësimi dhe ndjekja e çështjeve gjatë shqyrtimit gjyqësor ku AKEP është palë ndërgjyqëse

#### 🚩 Çështje të mbyllura në gjykatën e shkallës së parë:

- |   |                                   |                   |                  |
|---|-----------------------------------|-------------------|------------------|
| ➤ | <b>Çështja gjyqësore me palë:</b> | <b>Paditës:</b>   | <b>AMC SH.A.</b> |
|   |                                   | <b>I Paditur:</b> | <b>AKEP</b>      |

#### **Objekti i Padisë:**

1. Deklarimi i pavlefshëm, shfuqizimi dhe /ose anulimin e:
  - a) Vendimit të AKEP nr. 2412, datë 16.1.2014 “Rishikimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celularë”;
  - b) Vendimit të AKEP nr. 2431, datë 13.3.2014 “Miratimi i rishikimit të tarifave të terminimit në rrjetet e telefonisë celulare”;
  - c) Vendimit të AKEP nr. 2433, datë 13.3.2014 “Miratimi i rishikimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik të lëvizshëm të sipërmarrësit AMC sh.a.”;
  - d) Vendimit të AKEP nr. 2482, datë 15.5.2014 “Shqyrtimi i ankimit administrativ të AMC sh.a. ndaj vendimit nr. 2431, datë 13.3.2014 dhe vendimit nr. 2433, datë 13.3.2014”.
2. Pezullimi i zbatimit të aktit administrativ të ankimuar si më lart.

Janë zhvilluar katër seanca gjyqësore, në të cilat nga palët janë parashtruar pretendimet dhe dorëzuar provat. Në seancën e datës 27.11.2014, nga përfaqësuesi i AMC sh.a. u shpjegua se, pas vendimmarrjes së AKEP, vendimi nr. 2522, të datës 6.11.2014, AMC paraqet kërkesën për tërheqje nga kërkesë padia. Në përfundim, gjykata vendosi pushimin e çështjes.

- **Çështja gjyqësore me palë:** **Paditës:** **AKEP**  
**I Paditur:** **Alfa Telecom sh.p.k.**

### **Objekti i Padisë:**

Detyrimin e të paditurit Alfa – Telecom sh.p.k. të përmbushë e detyrimet financiare të papaguara për faturën e lëshuar nga AKEP me nr. 2414002, në shumën 2,719,728 Lekë.

Gjykimi ka filluar më datë 17.4.2013. Janë zhvilluar 17 seanca gjyqësore, me palën e paditur në mungesë, për shkak të mosgjjetjes së adresës së palës së paditur Alfa – Telecom sh.p.k., megjithëse nga gjykata janë bërë të gjitha format e njoftimit të parashikuara nga ligji (njoftim tek selia e Biznesit (në dy adresa), njoftim tek QKR, deri në njoftim me shpallje. Këto të fundit kërkojnë patjetër afatin 20 ditor, gjë e cila ka sjellë zgjatjen e procesit. Pas shqyrtimit së kërkesë padisë dhe provave shoqëruese të paraqitura nga pala paditëse AKEP, Gjykata, ka kërkuar të thirret ekspert kontabël në lidhje me detyrimet e llogaritura nga AKEP. Nga ekspertimi u arrit në konkluzionin që detyrimet e llogaritura nga AKEP për Alfatelecom sh.p.k. janë të sakta dhe konform ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore.

Në përfundim të hetimit gjyqësor, Gjykata me Vendimin nr. 8911, datë 17.9.2014, vendosi pranimin e kërkesë padisë dhe detyrimin e palës së paditur Alfa Telecom sh.p.k., t'i paguajë AKEP-it, shumën shumën prej 2,719,728 (dy milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë e tetë) Lekë dhe shpenzimet gjyqësore.

Vendimi ka marrë formë të prerë dhe është lëshuar Urdhri i Ekzekutimit nga Gjykata.

- **Çështja gjyqësore me palë:** **Paditës:** **Info-Telecom sh.p.k.**  
**I Paditur:** **AKEP**

### **Objekti Padisë:**

Anullimi/shfuqizimi i akteve administrative të nxjerra nga AKEP “Shkresë nr. 1404Prot., datë 14.8.2013” dhe “Shkresë nr. 1404/8Prot., datë 27.9.2013 – njoftuar paditësit më datë 1.10.2013”.

Pezullimi i zbatimit të akteve administrative të mësipërme të AKEP.

Janë zhvilluar tre seanca në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vendimin nr. 3284, me datën 10.3.2014, gjykata shpalli moskompetencën lëndore dhe kalimin në dosjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatëmn e Lartë Info – Telecom sh.p.k.

Gjykata e Lartë me Vendimin Nr. 00-2014-921, datë 30.4.2014, ka lënë në fuqi Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Çështja ka kaluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku janë zhvilluar pesë seanca. AKEP ka paraqitur pretendimet dhe qëndrimin në lidhje me kërkesë padinë. Nga pala paditëse Info – Telecom është kërkuar kohë për të paraqitur në gjykatë kopje e faturës me detyrimet e llogaritura për vitin 2014. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata më datë 29.10.2014, vendosi pranimin e pjeshëm të kërkesë padisë.

Këtë vendim AKEP e ka ankimuar.

- **Çështja gjyqësore me palë:** **Paditës:** **Vodafone Albania sh.a.**  
**I Paditur:** **AKEP**  
**Palë e Tretë:** **Albtelecom sh.a.**

#### **Objekti i Padisë:**

1. Pezullimi i ekzekutimit të Aktit Administrativ, Vendimit nr. 2354, datë 27.9.2013 të AKEP.
2. Konstatimi i Pavlefshmërisë absolute të Aktit Administrativ, vendimit nr. 2354, datë 27.9.2013 të AKEP.

Gjykimi ka filluar më datë 21.10.2014, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. AKEP në këtë seancë ka kërkuar nxjerrjen jashtë juridiksionit gjyqësor të çështjes. Gjykata nuk e pranoi kërkesën e AKEP. Kundër këtij Vendimi AKEP bëri ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, kjo e la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shk.I.

Gjykimi rifilloi më datë 10.7.2014, ku në këtë seancë u shpall moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e dosjes gjykatës kompetente.

Më datë 5.9.2014, ka filluar gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

Nga pala paditëse Vodafone Albania sh.a. më datë 15.10.2014, u paraqit kërkesa për tërheqje nga kërkesë padia.

Gjykata e pranoi këtë kërkesë dhe vendosi pushimin e gjykimit.

- **Çështja gjyqësore me palë:** **Paditës:** **Sokol Gjini**  
**I Paditur:** **AKEP**  
**Person i tretë:** **DAP**

#### **Objekti i Padisë:**

1. Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimit nr. 1214, datë 10.6.2014, “Për lirim nga detyra”, të Kryetarit të AKEP.
2. Kthimin e paditësit në postin e Përgjegjës të Sektorit të Inspektimit, Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit të Spektrit, në AKEP, apo në një vend ekuivalent me të, dhe pagimin prej të paditurit të pagës së plotë, me të gjitha indeksimet e mundshme, prej datës 10.6.2014, deri në kthimin de facto dhe de jure në postin e larpërmendur apo ekuivalent me të.
3. Detyrimin e AKEP për të më njohur statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, duke qenë se jam pjesë e shërbimit civil.
4. Detyrimin e palës së paditur, për të paguar shpenzimet gjyqësore, shpenzimet e ekzekutimit dhe të tarifës së venien në ekzekutim sipas përcaktimieve të pikës 2, neni 66, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për organizimin e dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjykimi ka filluar më datë 19.11.2014, dhe janë zhvilluar 5 seanca. Nga palët janë depozituar pretendimet dhe provat.

Më datë 22.12.2014, gjykata shpalli vendimin për pranimin e kërkesë padisë.

Kundër këtij vendimi AKEP do të bëjë ankim në gjykatën e Apelit.

➤ **Çështja gjyqësore me palë:**                      **Paditës:**            **Plus Communication sh.a.**  
**I Paditur:**            **Autoriteti i Konkurrencës**  
**Palë e tretë:**        **Vodafone Albania sh.a.**  
**AKEP**

### **Objekti i Padisë:**

Ndryshim i pjesshëm i Vendimit të Autoritetit të Konkurrencës nr. 303, datë 16.1.2014 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e telefonisë celulare me pakicë ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania sh.a. dhe rekomandime për AKEP” njoftuar paditësit më datë 25.1.2014, duke vendosur që të konstatojë apo detyrojë Autoritetin e Konkurrencës që të konstatojë abuzimin me pozitën dominuese në treg të operatorit Vodafone Albania sh.a. për periudhën 1.1.2011 deri më 31.12.2012 dhe detyrojë këtë të fundit të ndalojë menjëherë sjelljen e tij abuzive në tregun e telefonisë celulare me pakicë.

AKEP është njoftuar për të marrë pjesë si palë e tretë në këtë çështje në seancën e datës 14.7.2014, ku AKEP ka kërkuar të njihet me padinë dhe provat e paraqitura nga palët. Në seancën e datës 9.10.2014, Të pranishëm ishin: Përfaqësues të Plus Communication sh.a., Përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, Përfaqësues të Vodafone Albania sh.a., Përfaqësues i Avokaturës së Shtetit.

Duke qenë se gjykimi u shty me kërkesë të AKEP për t’u njohur me dosjen dhe materialet e saj, AKEP në këtë seancë dha shpjegimet e përgatitura dhe më pas i depozitoi ato shoqëruar edhe me provat përkatëse.

Më pas fjalën e morën palët e tjera, ku nga pala e paditur Autoriteti i Konkurrencës dhe Vodafone Albania u kërkuua mospranimi i kërkesë padisë për shkak të kalimit të afatit 30 ditor të parashikuar nga ligji i konkurrencës.

Pala paditëse Plus Communication sh.a. e kundërshtoi këtë kërkesë e gjithashtu, sqaroi se e ka marrë njoftimin e Vendimit nr. 303, datë 16.1.2014, më datë 26.1.2014, dhe ka depozituar kërkesë padinë në gjykatë me datë 11.3.2014.

Në përfundim Gjykata u tërhoq për marrjen e vendimit dhe më pas shpalli: Të mos pranojë kërkesë padinë e ngritur nga Plus Communication sh.a, për shkak të kalimit të afatit 30 ditor të ankimit në gjykatë të parashikuar nga ligji për konkurrencën.

➤ **Çështja gjyqësore me palë:**                      **Paditës:**            **Frederik Kote**  
**I Paditur:**            **AKEP**

### **Objekt i Padisë:**

1. Shfuqizimin e pikës 2, të Urdhërit të Kryetarit të AKEP Z.Piro Xhixho, nr. 1057, datë 27.11.2013, me nr. 1972Prot. datë 27.11.2013, "Për lirim nga detyra".
2. Detyrimin e Palës së Paditur të paguajë pagën e dy muajve punë të papaguar si dhe të gjitha përfitimet ligjore në përputhje me detyrën.

Gjykimi ka filluar me datë 29.1.2014. Janë zhvilluar 4 seanca. AKEP në këto seanca ka kundërshtuar pretendimet e paditësit si të padrejta e të pabazuara në prova e ligj. Paditësi ka përfituar të gjitha shpërblimet që i takojnë me ligj, vërtetuar kjo me provat dhe aktet e AKEP.

Më datë 27.1.2014, Gjykata shpalli vendimin për rrëzim të kërkesë padisë.

➤ **Çështja gjyqësore me palë:**      **Paditës:**      **Ecogen sh.p.k.**  
**I Paditur:**      **Kristian Kabashi**  
**Palë e tretë:**      **AKEP**

**Objekt i Padisë:**

Ndalim cëmimi pronësie kundër Ecogen sh.p.k.

Në seancën e datës 3.12.2014, Gjyqtarja kryesuese pas verifikimit të palëve, ku të pranishëm ishin vetëm përfaqësuesit e palës së tretë AKEP, Vendosi pushimin e gjykimit.

✚ **Çështje të mbyllura në gjykatën e apelit.**

➤ **Çështja gjyqësore me palë:**      **Paditës:**      **Illir Zela**  
**Të Paditur:**      **Kuvendi i Shqipërisë**  
**Palë e tretë:**      **AKEP**

**Objekti i Padisë:**

Shfuqizimi i vendimit nr. 10 datë 26.11.2009 "Për lirim nga detyra të një anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

Detyrimi i palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit të anetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

Me Fletë – Thirrje nr. Akti 19496, datë 26.11.2013, Gjykata e shkallës së parë Tiranë ka caktuar seancën e parë me datë 23.12.2013, ku AKEP thirret si palë e paditur. Me Vendimin e datës 23.12.2013ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë kompetencës dhe kalimin e dosjes Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, u zhvilluan tre seanca.

Nga ana e AKEP në këtë proces janë kundërshtuar pretendimet e palës paditëse si të padrejta e të pabazuara në prova e ligj, duke qenë se AKEP nuk ka kompetenca për emërin apo shkarkim/lirim të Anëtarëve të Këshillit Drejtues të tij, dhe gjithashtu është organ në varësi të vendimmarrësit (Kuvendit të Shqipërisë) është ky organ që e ka shkarkuar palën paditëse.

Në përfundim Gjykatësja vendosi: Pranimin e kërkesë padisë dhe detyrimin e Kuvendit dhe AKEP t'i paguajnë paditësit pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit të anetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare; Konkretisht dëmshpërblimi prej 40 paga mujore (shuma 5 900 000 Lekë); Ky detyrim do të ekzekutohet në pagesa të ndara në pesë këste, brenda afatit 3 (tre) vjecar, nga momenti i marrjes formë të prerë vendimi; Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Kundër këtij vendimi AKEP ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

Me njoftimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, më datë 3.7.2014, kjo çështje do të shqyrtohet në dhomë këshillimi, pa praninë e plaëve.

Gjykata e Apelit Administrativ në Vendimin me nr. 2858, datë 3.7.2014 (protokolluar në AKEP me nr. 49/8Prot, datë 4.8.2014) ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore më datë 16.9.2014.

Në këtë gjykatë u zhvilluan pesë seanca, dhe në përfundim Gjykata vendosi të pranojë ankimin e AKEP, për sa i takon pjesës së dëmshpërblimit të caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, dhe të ndryshojë vendimin e kësaj gjykate.

➤ **Çështja gjyqësore me palë:**

<b>Paditës:</b>	<b>Abissnet sh.a.</b>
<b>I Paditur:</b>	<b>Albtelecom sh.a.</b>
<b>Palë e tretë:</b>	<b>AKEP</b>

### **Objekti i Padisë:**

Detyrimi për shpërblim të dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar në vlerën 20 000 000 (njëzet milion) Lekë për moslidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit nga Albtelecom sh.a.

Gjykimi ka filluar me datë 11.10.2011. AKEP është thirrur si palë e tretë me ftesë për t'u paraqitur më datë 4.10.2012. Në këtë proces pas paraqitjes së shpjegimeve dhe provave nga AKEP dhe nga palët, pas shqyrtimit të tyre trupi gjykues ka kërkuar të thirren ekspertë kontabël dhe inxhinier elektronik, në lidhje me saktësimin e detyrimeve për dëmshpërblim ndaj Abissnet.

Janë zhvilluar gjithsej 24 seanca dhe më datë 24.2.2014, Trupi gjykues ka vendosur: Pranimin e pjesëshem të kërkesepadise;

Detyrimin e palës së paditur Shoqeria Albtelecom sh.a të dëmshpërbleje palën paditëse shoqeria "Abissnet" sh.a në shumën 2,776,760 leke; Rrezimin për pjesën tjetër.

Kundër këtij vendimi Albtelecom sh.a. ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Më datë 9.10.2014, u zhvillua seanca në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në këtë seancë nga Albtelecom u kërkuu pranimi i kërkesës për tërheqje nga ankimi.

Gjykata e pranoi këtë kërkesë dhe vendosi pushimin e gjykimit.

➤ **Çështja gjyqësore me palë:** **Paditës:** **Ilir Shehu**  
**Të Paditur:** **Kuvendi i Shqipërisë**  
**Palë e tretë:** **AKEP**

#### **Objekti i Padisë:**

Shfuqizimin e Vendimit Nr. 11, datë 26.11. 2009, “Për Lirim tim nga detyra e anëtarit të Këshillit Drejtues të ERT-së” dhe rregullimin e të gjitha pasojave ligjore.

Gjykimi ka filluar më datë 1.3.2010 dhe janë zhvilluar gjithsej 24 seanca. Gjykata me datë 17.2.2011, vendosi: Pushimin e gjykimit të çështjes, si padi që nuk mund të ngrihet. Ndaj këtij vendimi pala paditëse bëri ankim të veçantë në Gjykatën e Apelit dhe kjo gjykatë vendosi: Prishjen e Vendimit nr. 1066, datë 17.2.2011 të Gjyqesës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Me Fletë – Thirrje nr. Akti 19378, datë 21.11.2013 Gjykata e shkallës së parë Tiranë ka caktuar seancën e parë me datë 27.12.2013, ku AKEP thirret si palë e tretë.

Me Vendimin e datës 27.12.2013, Gjykata ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë kompetencës dhe kalimin e dosjes Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, u zhvilluan tre seanca ku nga ana e AKEP në këtë proces janë kundërshtuar pretendimet e palës paditëse si të padrejta e të pabazuara në prova e ligj, duke qenë se AKEP nuk ka kompetenca për emërin apo shkarkim/ lirim të Anëtarëve të Këshillit Drejtues të tij, dhe gjithashtu është organ në varësi të vendimmarrësit (Kuvendit të Shqipërisë) është ky organ që e ka shkarkuar palën paditëse.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykatësja vendosi:

Pranimin e kërkesë padisë dhe detyrimin e Kuvendit t'i paguajnë paditësit pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit të anetarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe pagesën e shëpenzimeve gjyqësore.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim paditësi Ilir Shehu.

Më datë 5.11.2014, në Gjykatën Administrative të Apelit, u zhvillua seanca në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve.

Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs pala paditëse.

➤ **Çështja gjyqësore me palë:** **Paditës:** **AMC**  
**I Paditur:** **AKEP**

## **Objekt i Padisë:**

Deklarimin e pavlefshëm, shfuqizimin dhe/ose anulimin e Vendimit nr. 1505, datë 10.2.2011 të Keshillit Drejtues të AKEP, me objekt: “Për miratimin e dokumentit final për orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve celular me FNT”, dhe Vendimit të KD të AKEP nr. 1506, date 10.02.2011 “ Për miratimin e metodologjisë të rregullimit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit AMC”, njoftuar në AMC më date 18.02.2011”,

Pezullimi e zbatimit të aktit administrativ të ankimuar si më lart.

Gjykimi ka filluar më 9.6.2011, dhe janë zhvilluar gjithsej 12 seanca gjyqësore.

Më datë 6.11.2012, Gjykata e Shkalles së Parë shpalli vendimin: Rrëzim të kërkesë padisë. Kundër këtij vendimi AMC ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit.

Në seancën e zhvilluar më datë 21.2.2014, Trupi gjykues vendosi të shpallë moskompetencën duke e kaluar çështjen në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

Më datë 3.6.2014, është mbajtur seanca gjyqësore pa praninë e palëve Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova e ligj.

## **🚩 Çështje në pritje të gjyqimit në gjykatën e apelit.**

➤ **Çështja gjyqësore me palë:**                      **Paditës:**                      **Kelmend Frroku**  
**I Paditur:**    **AKEP**

## **Objekt i Padisë:**

1. Deklarimin e pavlefshmërisë së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës me të paditurin.
2. Detyrimin e të paditurit të më dëmshpërblejë me një vit paga mujore, për zgjidhjen e pajustificuar të marrëdhënieve të punës.
3. Detyrimin e të paditurit të më shpërblejë pagën për periudhën e afatit të njoftimit dhe për moszbatim të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës prej tre pagash mujore.
4. Shpërblimin për vjetërsi në punë.
5. Kthimin e shpenzimeve gjyqësore.

Gjykimi ka filluar me datë 15.4.2014. Janë zhvilluar 3 seanca. AKEP ka paraqitur parashtrimet dhe provat në mbështetje të tyre, ku ka kundërshtuar pretendimet e paditësit si të pabazuara në ligj. Më datë 8.5.2014, Gjykata shpalli vendimin pranimin e pjesëshëm të kërkesë padisë dhe detyrimin e AKEP për dhënien e 14 pagave dëmshpërblim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës pa shak të justifikuar dhe pagimin e shpenzimeve gjyqësore.

Kundër këtij vendimi AKEP ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.



Deri tani nuk kemi njoftim nga kjo gjykatë për zhvillimin e seancës.

- **Çështja gjyqësore me palë:**            **Paditës:**            **AKEP**  
   **I Paditur:**        **Komisioni i Prokurimit Publik**  
   **Palë e tretë:**    **Communication Progress sh.p.k.**

**Objekt i Padisë:**

1. Kundërshtim i aktit administrativ vendim nr. 38, date 17.12.2013 per pranimin e ankesës së operatorit Communication Progress dhe anulimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
2. Kundërshtim i aktit administrativ Vendim nr. 5, date 10.01.2014 të Komisionit të Prokurimit Publik për lënien ne fuqi te vendimit nr. 39, date 17.12.2013
- 3 Pezullimi i akteve administrative të ankimuarra më sipër.

Gjykimi ka filluar me datë 27.1.2014. nga AKEP janë paraqitur pretendimet, provat në mbështetje, dhe është kërkuar pranimi i kërkesë padisë. Janë zhvilluar tetë seanca dhe më datë 12.5.2014 shpalli vendimin për rrezimin e kërkesë padisë si pabazuar në prova e në ligj, duke iu referuar Vendimit të Gjykatës së Lartë për këto lloj çështjesh.

Kundër këtij vendimi AKEP ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

Deri tani nuk kemi njoftuar nga kjo gjykatë për zhvillimin e seancës.

- **Çështja gjyqësore me palë:**            **Paditës:**            **AKEP**  
   **I Paditur:**        **Komisioni i Prokurimit Publik**  
   **Palë e tretë:**    **Communication Progress sh.p.k.**

**Objekti i Padisë:**

1. Kundërshtim i aktit administrativ vendim nr.38, date 17.12.2013 per pranimin e ankesës së operatorit Communication Progress dhe anulimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave
2. Kundërshtim i aktit administrativ Vendim nr. 5, date 10.01.2014 të Komisionit të Prokurimit Publik për lënien ne fuqi te vendimit nr. 39, date 17.12.2013
- 3 Pezullimi i akteve administrative të ankimuarra më sipër.

Gjykimi ka filluar me datë 28.1.2014. Janë zhvilluar dhjete seanca dhe më datë 28.4.2014, shpalli vendimin për rrezimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova e në ligj.

Kundër këtij vendimi AKEP ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë.

Deri tani nuk kemi njoftuar nga kjo gjykatë për zhvillimin e seancës.

- **Çështja gjyqësore me palë: Padiës: Ded Jakaj**  
**I Paditur: AKEP**

**Objekti i Padiës:**

1. Shfuqizimi i aktit administrativ, vendimit nr. 1227, datë 13.6.2014, “Për lirim nga detyra”, të Kryetarit të AKEP .
2. Detyrimin e palës së paditur të më kthejë në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend pune paralel.
3. Detyrimin e palës së paditur të më paguajë pagën nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthimin në vendin e punës.
4. Detyrimin e palës së paditur, për të paguar shpenzimet gjyqësore, shpenzimet e ekzekutimit të tarifës për vënien në ekzekutim sipas pikës 2, të nenit 66, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, u zhvilluan pesë seanca, dhe në përfundim të hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor Gjykata, më datë 7.10.2014, vendosi: pranimin e kërkesë padisë.

Kundër këtij vendimi AKEP ka bërë Ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Deri tani nuk jemi njoftuar nga kjo gjykatë për zhvillimin e seancës.

- **Çështja gjyqësore me palë: Padiës: Edlira Vatnikaj**  
**I Paditur: AKEP**

**Objekti i Padiës:**

Shfuqizimi i Vendimit nr. 1226, datë 13.6.2014, “Për lirim nga detyra” të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe përfitimi i të gjitha të drejtave ligjore që i jep ligji.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, u zhvilluan katër seanca, dhe në përfundim të hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor Gjykata, më datë 27.10.2014, vendosi: Rrëzimin e kërkesë padisë.

Kundër këtij vendimi është ankuar pala paditëse Edlira Vatnikaj.

Deri tani nuk jemi njoftuar nga kjo gjykatë për zhvillimin e seancës.

- **Çështja gjyqësore me palë: Padiës: Pronet sh.p.k.**  
**I Paditur: AKEP**

**Objekti i Padiës:**

1. Konstatim i pavlefshmërisë (*absolute*) të aktit administrativ: Vendim nr. 404, datë 18.10.2007 të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe anulimin e pjesshëm (pikës 1 dhe pikës 2) të Faturës nr. 34, datë 20.8.2008 të nxjerrë nga AKEP.

- Vendosjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar deri në fund të procesit gjyqësor procedurat e arkëtimit të detyrimit prej 3 720 000 Lekë të përcaktuar në Faturën nr. 34, datë 20.8.2008 të AKEP.

Në shkallë të parë gjykimi ka filluar me datë 8.2.2013. Janë zhvilluar gjithsej 8 seanca. Në këtë proces AKEP ka kundërshtuar pretendimet e palës paditëse, duke qenë se ka qenë vetë kjo palë që ka kërkuar ndryshime/shtim (lidhje fikse) frekuencash në Autorizim Individual, të cilat më pas kanë rezultuar edhe me shtim të detyrimeve të llogarituara nga AKEP për këto frekuenca.

Më datë 1.11.2013 Gjykata shpalli vendimin: Rrëzimin e kërkesë padisë.

Kundër këtij vendimi Pronet sh.p.k. ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit.

Më datë 2.5.2014, Gjykata e Apelit Tiranë shpalli moskompetencën lëndore dhe kalimin në dosjes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Jemi në pritje të njoftimit nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

➤	<b>Çështja gjyqësore me palë:</b>	<b>Paditës:</b>	<b>Abcom sh.p.k.</b>
		<b>I Paditur:</b>	<b>AKEP</b>

**Objekt i Padisë:**

Kundërshtimi i detyrimit tatimor të njoftuar nëpërmjet faturës nr. 29 date 28.05.2008 në masën 4 074 000 lekë dhe anulimi i pjesëshëm i detyrimit të shprehur në faturën nr. 29 date 28.05.2008 për shumën 4 074 000 lekë.

Në këtë proces Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 314, datë 25.1.2010, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesë padisë të Abcom sh.p.k.
- Anullimin pjesërisht të detyrimit e shprehur në faturën nr 29 të ERT (sot AKEP) drejtuar Abcom shpk me dt 28.05.2008 për shumën 4 074 000 lekë.

AKEP ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Gjykata e Apelit Tiranë me Vendimin nr. 2438 datë 21.12.2010 ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Kundër këtij vendimi AKEP ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë

Më datë 17.6.2014, është zhvilluar seanca gjyqësore pa praninë e palëve në Gjykatën e Lartë, ku është Vendosur: Prishja e vendimit nr. 2438 datë 21.12.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Deri tani nuk jemi njoftuar nga kjo gjykatë për zhvillimin e seancës.

## **🚩 Çështje civile në pritje të gjykimit në gjykatën e lartë:**

➤ **Çështja gjyqësore me palë:**                   **Paditës:**       **Ada Hasa**  
  **I Paditur:**      **AKEP**

### **Objekt i Padisë:**

1. Detyrimi i të paditurit që të dëmshpërblejë paditësen me 12 muaj pagë për zgjidhje të marrëdhënies së punës pa shkaqe të arsyeshme.
2. Detyrimi i të paditurit për të dëmshpërblyer me dy muaj pagë për mosnjohim sipas nenit 143 dhe dy muaj pagë për mosrespektim të procedurës sipas nenit 144 për mosdhënie të mundësisë për t'u shprehur.

Gjykimi ka filluar me datë 13.1.2014. Janë zhvilluar 3 seanca. Në këtë proces AKEP ka kundërshtuar pretendimet e paditëses, si të pabazuara. Më datë 27.1.2014, Gjykata shpalli vendimin për pranimin e pjesëshëm të kërkesë padisë. Kundër këtij vendimi AKEP ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka njoftuar zhvillimin e seancës në dhomë këshillimi pa praninë e palëve më datë 15.5.2014, ora 10:40. Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

Kundër këtij vendimi AKEP ka bërë Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Deri tani nuk jemi njoftuar nga kjo gjykatë për zhvillimin e seancës.

➤ **Çështja gjyqësore me palë:**                   **Paditës:**       **Silvana Miho**  
  **I Paditur:**      **Panajot Barka**  
  **Palë e Tretë:** **AKEP**  
  **Drejtoria e Tatimeve Gjirokastrër**

### **Objekti Padisë:**

Shpërblim dëmi dhe ndalim i ushtrimit të aktivitetit të ofrimit të shërbimit të internetit në kushtet e konkurrencës së pandershme.

Është zhvilluar seanca e parë më datë më datë 4.12.2013, dhe AKEP ka marrë pjesë në dhjetë seanca në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrër. Në këtë proces, nga AKEP janë paraqitur pretendimet dhe provat të cilat i mbështesin ato, dhe kjo çështje është lënë në vlerësim të gjykatës. Kjo duke qenë se AKEP e ka dhënë mendimin në parashtrime e tij.

Me Vendimin nr. 619 (209) datë 23.5.2014, Gjykata e shkallës së parë ka vendosur: Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova e ligj.

Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastrër paditësi Silvana Miho.

Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me Vendimin nr. 385 (706) datë 24.9.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs pala paditëse Silvana Miho.

Deri tani nuk jemi njoftuar nga kjo gjykatë për zhvillimin e seancës.

➤ **Çështja gjyqësore (e mbyllyr) me palë:      Paditës:      Afrim Tonuzi**  
**I Paditur:      Kuvendi i Shqipërisë,**  
**AKEP**

#### **Objekti i Padisë:**

Shfuqizimi i vendimit nr. 12 date 26.11.2009 “Për lirimin nga detyra të një anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

Detyrimi i palës së paditur të dëmshpërbleje paditesin me pagën që do të përfitonte deri në plotësimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

Procesi ka filluar me 1.2.2010, dhe janë zhvilluar gjithsej 13 seanca. Nga ana e AKEP në këtë proces janë kundërshtuar pretendimet e palës paditëse si të padrejta e të pabazuara në prova e ligj, duke qenë se AKEP nuk ka kompetenca për emërim apo shkarkim/ lirim të Anëtarëve të Këshillit Drejtues të tij, dhe gjithashtu është organ në varësi të vendimmarrësit (Kuvendit të Shqipërisë) është ky organ që e ka shkarkuar palën paditëse.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane më dt. 20.10.2010, mori Vendim për pushimin e gjykimit si padi që nuk duhej ngritur.

Kundër këtij Vendimi paditesi ka bërë ankim në Gjykatën e Lartë.

Nga Gjykata e Lartë, jemi njoftuar për zhvillimin e seancës më datë 18.9.2014, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve.

(Gjykata ka nxjerrë çështjen jashtë kompetencës. Vendimi ende nuk është zbardhur).

#### **2.8.4. Ushtrimi i kompetencës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar**

AKEP e ka ushtruar kompetencën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar nëpërmjet instrumenteve të tij, zyrës përkatëse dhe “Komisionit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjes – KZM”, struktura e ngritur “ad hock” për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, në rastet kur pajtimtari kërkon që mosmarrëveshja e tij me sipërmarrësin të zgjidhet nga AKEP.

Mbështetur në Rregulloren që përcakton procedurën dhe strukturën përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis pajtimtarëve dhe sipërmarrësve, ky Komision ka marrë në shqyrtim çështjet që kanë plotësuar kërkesat e saj, duke i shqyrtuar dhe nxjerrë rekomandimin përkatës. Ankesat jashtë Komisionit janë trajtuar sa më parë, duke dhënë përgjigje sqaruese dhe orientuese për përdoruesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Gjithashtu nuk kanë munguar inspektimet e kryera në subjekte në lidhje me Kontratën e Pajtitimit, për të qënë sa më konform ligjit dhe dokumentave rregullatorë.

**Janë trajtuar 14 ankesa për zgjidhje të mosmarrëveshjeve midis pajtimtarit dhe sipërmarrësit, në kuadër të pjesëmarrjes në KZM, si:**

1. Ankesa e Donianna shpk (pajtimtari) me shkresë nr. 833/2 (prot. i AKEP) datë 24.04.2014 ka paraqitur në AKEP ankimim ndaj sipërmarrësit Plus Communication sh.a në lidhje me problemet që kanë të bëjnë me pretendime për keqfaturim dhe moslejim të portimit të numrave;
2. Ankesa e pajtimtarit z.Sation Zeqo, në lidhje me kontratën me operatorin Vodafone Albania sh.a. (ardhur me email);
3. Ankesa me email e z. Diamant Fiku, datë 17.11.2014, në lidhje me kohëzgjatjen e kontratës me Albtelecom;
4. Ankesa nr. 2544 prot. (i AKEP) datë 26.11.2014, Lawoffice & Investigation (z.Shefqet Dizdari), në lidhje me kontratën me operatorin AMC sh.a.;
5. Ankesa nr. 1927Prot, datë 13.8.2014 z.Dritan Malaj në lidhje me faturimin të operatorit Vodafone Albania sh.a.;
6. Ankesa e znj. Marjeta Prendi me nr. 2362Prot, datë 28.10.2014, për procesin e portimit nga Vodafone tek AMC.;
7. Ankesa e Qendrës Komunitare të Integritimit me nr. 2556Prot, datë 27.11.2014, në lidhje me transferimin e shërbimit të internetit të ofruar nga Albania Satellite Communication (Tring) në Krugën “D.Bosko”;
8. Ankesa e znj. Oriada Gjonbrati me nr. 2363Prot, datë 28.10.2014, në lidhje me procesin e portimit të numrave nga AMC në Vodafone;
9. Ankesa e z. Alban Ibrahimimi me shkresën nr, 2422Prot, datë 7.11.2014, në lidhje me faturimin nga AMC.;
10. Ankesa e z. Altin Behluli me nr. 1941Prot., datë 15.8.2014, në lidhje me kalimin e numrit Vodafone me kontratë në nr. “Club”;
11. Ankesa e znj. Helga Vukaj, me nr. 1921Prot. datë 12.8.2014, në lidhje me kalimin e numrit Vodafone me kontratë në nr. “Club”;
12. Ankesa e z. Avni Parllaku me nr. 2151Prot. datë 23.9.2014 në lidhje me portimin e numrave nga Eagle Mobile në Plus Communication;
13. Ankesa e z. Fation Softa e datës 16.7.2014, në lidhje me procesin e bartjes nga Abissnet tek Albtelecom;
14. Ankesa e z. Njazi Gropasi, e përcjellë në AKEP me shkresën Nr. K31NJ25-2Prot, të AKEP, datë 4.7.2014, të Avokatit të Popullit.

## **2.9. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË BURIMEVE NJERËZORE, MARRËDHËNIET NDËR-INSTITUCIONALE DHE NDËRKOMBËTARE, ADMINISTRIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR INSTITUCIONIN**


Çështjet që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, marrëdhëniet ndër-institucionale dhe ndërkombëtare, si dhe administrimi i shërbimeve mbështetëse për institucionin përbëjnë objektin e veprimtarisë të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Integritit të riorganizuar sipas strukturës dhe organikës së re të AKEP-it.

### **2.9.1. Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore**


Të gjendur në kushtet e nevojës së donosdoshme të ushtrimit të veprimtarisë normale me qëllim përmbushjen e objektivave rregullatore në zbatim të ligjit material dhe politikave sektoriale të zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe në kuadër të përafrimit të plotë të legjislacionit në përputhje me paketën 2002/2003 dhe atë 2009 të Parlamentit dhe Komisionit EU duke përfshirë edhe organizimin dhe funksionimin e strukturës dhe organikës si organ rregullator me ato të vendeve të Bashkimit Europian, është përcjellë kërkesa e AKEP-it për miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të strukturës dhe organikës duke e përshtaturme kushtet dhe rrethanat aktuale të fushës dhe legjislacionit, si dhe frymës së Qeverisë për reduktimin e shpenzimeve dhe funksionimin me struktura sa më profesionale, eficiente dhe numër sa më të ulët punonjësish.

Me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 11/2014, *“Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”* është miratuar struktura organizative dhe organika e AKEP, e përbërë nga 60 punonjës.

Implementimi i strukturës së re, në zbatim të Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil” dhe akteve nëligjore në fuqi ka mundësuar rritjen e efikasitetit të stafit dhe cilësisë së kapaciteteve të burimeve njerëzore, në përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe rritjes së fleksibilitetit dhe transparencës në ushtrimin e funksioneve, në gjithë veprimtarinë e punës së AKEP. E reja e kësaj strukture qëndron te konfigurimi i organigramës sipas zhvillimeve të tregut të komunikimeve elektronike dhe krijimit të një sektori të veçantë për rregullimin postar në Shqipëri.




**Figura 1.2: Përbërja strukturore sipas funksioneve në AKEP**





**Figura 1.3: Përbërja gjinore dhe arsimore**



Për funksionimin e veprimtarisë institucionale të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare janë miratuar nga Këshilli Drejtues rregulloret:

- ✓ Rregullore e brëndshme e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
- ✓ Rregullore e etikës dhe sjelljes profesionale në Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
- ✓ Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).
- ✓ Rregullore për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhani në Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Duke qenë se AKEP është një institucion që mbikqyr sektorë shumë të specializuar siç janë ato të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare, është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit. Gjatë vitit 2014, është shfrytëzuar çdo mundësi trajnimi financiar nga fondet e AKEP, të organizatave ku vendi ynë është anëtar dhe kontribues si dhe të institucioneve homologe.

Trajnimet e kryera janë bazuar në domosdoshmërinë e forcimit dhe promovimit të kapacitetit të kapitalit intelektual “*burime njerëzore*” që posedon sot administrata e AKEP si dhe në përmbushjen e objektivave të AKEP, si më poshtë:

Nr.	Aktiviteti	Institucioni Organizues
1.	Seminarin mbi kalimin në transmetimin tokësor dixhital dhe dividendin dixhital për Europën	ITU
2.	Takimin bilateral ndërmjet AKEP dhe EKIP me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Teknike për koordinimin e sistemeve GSM / DCS1800 në brezat e frekuencave 880-915/925-960 MHz dhe 1710-1785/1805-1880 MHz	AKEP dhe EKIP
3.	Simpoziumin e ITU - Makina e së Ardhmes në Rrjet	ITU
4.	Konferencën rajonale “Mbrojtja dhe siguria në hapësirën kibernetike”	ITU
5.	Master Class në Rregullimin e Telekomunikacioneve	Cullen International
6.	Pjesëmarrjen në takimin dy-palësh Itali-Shqipëri	Ministritë së

		Zhvillimit Ekonomik
7.	Konferencën Botërore të Zhvillimit të Telekomunikacioneve WTDC	ITU
8.	Pjesëmarrjen në takimin e 5-të BE-Shqipëri për “Tregun e Brëndshëm dhe Konkurrencen, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”	BE
9.	Forumit për Rregullimin e Telekomunikacioneve	IIR Telecoms & Technology
10.	Pjesëmarrjen në takimin ndërmjet AKEP dhe ANFR	AKEP , ANFR
11.	Pjesëmarrjen në seminarin Ndërkombëtar për Mbrojtjen Kibernetike (ICSE 2014), organizuar nga Autoriteti i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ICTA)	ITU, Ministrinë e Transportit, Cështjeve Detare dhe Komunikimeve të Turqisë
12.	Pjesëmarrjen në takimin e 4-rt të Grupit Rajonal të Punës të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEE RWG)	ANCOM
13.	Konferencën “Ndikimi i teknologjive të reja dhe inovacionit në rregullim”	ICTA
14.	Simpoziumin e 14-të Botëror të Rregullatorëve (GSR)	ITU
15.	Konferencën WSIS+10	ITU
16.	Seminarin trajnues mbi rregullimin e telekomunikacioneve, organizuar nga Autoriteti i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ICTA)	ICTA
17.	Takimin ndërmjet AKEP dhe ANCOM	AKEP ANCOM
18.	Pritjen e delegacionit të Maqedonisë në ambjentet e AKEP në datën 7 Korrik 2014, si dhe organizimin e një vizite 2-ditore në zonën e Korçës	AKEP
19.	Konferencën e 9-të ndërkombëtare mbi Rrjetet dhe Komunikimet e së Ardhmes – FNC 2014	Universiteti i Otavës Universiteti i Sidney Universiteti Queen, Kanada Instituti i Teknologjisë « New Jersey »
20.	Takimin rajonal të punë iniciativa për reduktimin e tarifave roaming në rajon, anëtarësimi i AKEP në IRG/BEREC nënshkrimi i Marrëveshjes Teknike ndërmjet AKEP & AEC për koordinimin e teknologjive GSM/UMTS/LTE	AEC
21.	Pjesëmarrjen në programin e trajnimit master class në rregullimin e shërbimit postar	Cullen International
22.	Takimin Plenar të 20-të të BEREC dhe Asamblenë e Përgjithshme të IRG	BEREC/IRG
23.	Konferencën Rajonale « Aktiviteti Rregullator në Sektorin e Komunikimeve Elektronike	EKIP-ITU
24.	Konferencën “Përcaktimi i çmimit mbi të dhenat e trafikut mobil 2014	Informa Telecoms & Media
25.	Pjesëmarrjen në Konferencën e Plotëfuqishme të ITU-së 2014 (PP-14)	ITU

26.	Kursit të trajnimit 3 ditor « Legjislacion dhe praktikë në prokurimet publike »	Gaba Consulting
27.	Pjesëmarrjen në Kongresin MVNO Networking 2014	IIR Telecoms & Technology
28.	Ndjekjen e kursit të trajnimit (një) ditor « Menaxhimi Modern i Burimeve Njerezore »	Agjensia shqiptare e punesimit
29.	Ndjekjen e kursit të trajnimit 1 (një) ditor « Administrata Publike »	Agjensia shqiptare e punesimit
30.	Ndjekjen e kursit të trajnimit <i>online</i> « Wireless and Mobile Broadband Internet »	ITU
31.	Pjesëmarrjen në Takimin e 6-të i Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për “Inovacionin, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”	BE
32.	Pjesëmarrjen në Simpoziumin e 12-të Botëror mbi Telekomunikacionin Indikatoret ICT (WTIS 2014)	ITU
33.	Pjesëmarrjen në Mbledhje Puneve të Kryetarve dhe Takimi Plenar të 21-te të BEREC	BEREC
34.	Samitin Inovacionet në Wi- Fi (wi-fi innovation summit 2014)	CVENT
35.	Konferencën “Digi-Dare Before the Final Switchover”	OSBE Kosove

### 2.9.2. Aktiviteti i bashkëpunimit ndër-institucional dhe marrëdhëniet ndërkombëtare

Në kuadër të proceseve integruese të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka thelluar bashkëpunimin me Komisionin Evropian, vendet anëtare dhe institucionet homologe Evropiane.

Në takimin Plenar të 20-të të BEREC dhe Asamblenë e Përgjithshme të Grupit të Rregullatorëve të Pavarur (IRG), i mbajtur në Romë, AKEP bëhet anëtar i BEREC me statusin e vëzhguesit dhe anëtar me të drejta të plota në IRG.

Në datën 9 shkurt, 2015 AKEP bëhet anëtar me statusin e vëzhguesit në Grupin e Rregullatorëve Evropianë për Shërbimet Postare (ERGP)

AKEP ka përgatitur dhe dërguar informacione periodike në Komisionin Evropian në kuadër të zbatimit të MSA, Dokumentit të Partneritetit Evropian (2007), rekomandimeve të Raporteve të Progresit dhe rekomandimeve të nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit:

- Për Komitetin e Stabilizim-Asociimit mbi zhvillimin e tregut të telekomunikacionit në kuadër të zbatimit të MSA
- Për nënkomitetin BE-Shqipëri “Tregu i Brëndshëm dhe Konkurrenca, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”
- Për nënkomitetin BE-Shqipëri “Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”
- Përnënkomitetin BE-Shqipëri “Inovacioni, Burimet Njerezore dhe Shoqëria e Informacionit”

### **2.9.3. Administrimi i shërbimeve mbështetëse për instuticionin**

Administrimi i shërbimeve mbështetëse të instuticionit ka siguruar mbarëvartjen e veprimtarisë së brendshme të AKEP, në mbulimin e nevojave të burimeve njerëzore me logjistike dhe shërbime mbështetëse, me qëllim sigurimin e kushteve më optimale dhe më eficiente në veprimtarinë e instuticionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Prokurimet publike**

Në zbatim të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 dhe akteve nëligjore të tij në bazë të Planit të parashikimeve të prokurimeve publike AKEP ka zhvilluar normalisht dhe me efektivitet procedurat e prokurimit publik duke zbatuar të gjitha detyrimet ligjore në fuqi.

Gjatë vitit 2014, janë realizuar 22 prokurime publike, kontratat e të cilave janë lidhur në vitin 2014 ndërsa 1 prokurim publik është hapur si procedurë në vitin 2014 dhe do të mbyllet gjatë vitit 2015. Në të gjitha procedurat e realizuara, është bërë kujdes dhe janë plotësuar Formularët e deklarimit të konfliktit të interesave nga antarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe njësisia e prokurimit.

#### **Dixhitalizimi i Arkivës së AKEP**

Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe sistemim e dokumenteve hyrëse dhe dalëse në AKEP është finalizuar me sukses procesi i dixhitalizimit të arkivës i cili mundëson aksesimin e informacionit në kohë reale dhe kërkimin e tyre ndër vite.

### III. PROGRAMI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2015

Programi i punës së AKEP-it për vitin 2015, ndikohet nga nevoja e tregut, kuadri i politikave kombëtare për sektorin, kërkesat e ligjit 9918, të ndryshuar, rekomandimeve të raport-progresit të BE-së për Shqipërinë si dhe Rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e AKEP.

Për vitin 2015, AKEP do të punojë me prioritet për:

1. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të vendosura nga AKEP për operatorët celularë në 2014;
2. Kryerja e analizës së tregut të telefonisë fikse;
3. Publikimi i numeratorit telefonik dhe shërbimet e kërimit në numerator;
4. Masa rregullatore për nxitjen e penetrimit broadband;
5. Përgatitja e kuadrit rregullator përkatës për shërbimin postar;
6. Publikimi dhe përditësimi i ATLASIT për shërbimet postare;
7. Ndjekja e procesit të dhënies së të drejtave të përdorimit për kanalet e lira në brezin 900 MHz;
8. Ndjekja e procesit të dhënies në përdorim të spektrit 1800 MHz për brezat e lirë për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX;
9. Ndjekja e procedurës mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”;
10. Hartimi i dokumentave mbi strategjinë dhe objektivat për futjen e shërbimeve të lëvizshme në brezat e frekuencave 800 MHz;
11. Ndjekja e procesit të heqjes së kufizimeve të shfrytëzimit të frekuencave në autorizimet për përdorimin e tyre në brezat GSM 900/1800 dhe UMTS;
12. Ndjekja e procesit të riorganizimit të frekuencave në brezat GSM 900/1800 dhe UMTS;
13. Ndjekja e praktikave të koordinimit të frekuencave me institucionet e tjera, ndërkuftare, satelitore etj;
14. Ndjekja e procesit të portabilitetit të numrit;
15. Implementimi i projektit për krijimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Frekuencave duke zhvilluar Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave;
16. Inspektimi i sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike;
17. Monitorimi i mbulimit dhe cilësisë së shërbimit në brezat e frekuencave GSM/UMTS/IMT/LTE në qytetet kryesore të Shqipërisë, rrugët kryesore, zonat urbane dhe pikat turistike;
18. Zhvillimi i mëtejshëm i Projektit ATLAS për komunikimet elektronike;
19. Kontrolli periodik i frekuencave që përdoren në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit, në brezat e frekuencave deri në 18 GHz;
20. Monitorimi i brezit të frekuencave 2.6 GHz në qytetet kryesore të vendit;
21. Monitorimi i brezit të frekuencave 2.4 GHz dhe 5.8 GHz në pikat kryesore të transmetimit në territorin e vendit;
22. Monitorimi i brezit VHF 140-170 MHz dhe UHF 440-470 MHz në rrethin e Tiranës dhe Durrësit;
23. Ndjekja e problematikave që dalin nga ndërhyrjet e dëmshme (interferencat);
24. Angazhim në konstatimin e nevojës për amendime/përditësime të akteve rregullatore të nxjerra nga AKEP dhe në fuqi, dhe në hartimin dhe ndryshimin e tyre në kuadër të përmirësimit të kuadrit rregullator dhe përjasjes së plotë me “*acquis*”;
25. Angazhim në përmirësimin e legjislacionit sekondar rregullator të miratuar dhe në fuqi për komunikimet elektronike;

26. Angazhim në forcimin e rolit të autoritetit rregullator në mbrojtjen e konsumatorit (përdoruesit/pajtimtarit) në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare duke e bashkërenduar punën me regjimin normativ në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit në Shqipëri, për të garantuar:
- mbrojtjen e interesave të përdoruesit në aspektin individual;
  - mbrojtjen e interesave të përdoruesve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike;
  - trajtim të barabarte dhe jodiskriminues të të gjithë përdoruesve përmes procedurave ligjore e transparente;
  - monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i autorizuari ndaj përdoruesve të shërbimeve elektronike dhe postare;
27. Angazhim në forcimin e rolit të rregullatorit në mbrojtjen e interesave ligjore të tregut të komunikimeve elektronike dhe për të garantuar trajtimin e barabarte ligjor dhe jodiskriminues të ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve në procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes tyre;
28. Angazhim në mbrojtje të interesave juridike dhe ligjore të institucionit të AKEP sa here që do të vepohet në emër dhe për llogari të tij me përfaqësim të autorizuar para gjykatës;
29. Angazhim në trajtim juridik profesional dhe konsulencë ligjore në trajtimin e të gjitha praktikave administrative të depozituara në AKEP.  
Angazhim në përmbushje të detyrave të caktuara në planin e veprimit të AKEP për vitin 2015 (*nga miratimi i tij*);
30. Detajimi i fondit të shpenzimeve të vitit 2015;
31. Arkëtimin e detyrimeve të prapambetura;
32. Hartimi i projekt- fondit të shpenzimeve të AKEP për vitin 2016;
33. Ndjekje e procesit të regjistrimit /rinovimit të domain-ve. Administrim i sistemit FRED (sistem i menaxhimit të domain .al);
34. Monitorim i aksesit në internet të Sistemit DNS (lidhjet përkatëse me 2 ISP);
35. Menaxhimi i CRBD dhe Portabiliteti i Numrit. Funkcionimi i sistemit të CRDB sipas Rregullores dhe realizimi i procesit të bartjes së numrave për pajtimtarët;
36. Ngritje e Backup Site pranë Q.K.M.F;
37. Biztalk Cluster për CRBD (Bazën e të dhënave referencë e centralizuar);
38. Formulimi, miratimi dhe ndjekja e zbatimit të strategjisë së AKEP për broadband;
39. Implementimi i strukturës së re, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 11/2014 të Kuvendit të Shqipërisë, “*Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)*”;
40. Vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil mbi sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të punonjësve të AKEP.
41. Realizimin e gjithë procedurave dhe detyrimeve ligjore të prokurimeve sipas afateve kohore dhe legjislacionit në fuqi.
42. Zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2014-2020.
43. Ndjekje dhe Informim nga Organizatat Ndërkombëtare në të cilat AKEP është antare.

#### IV. RAPORTI PËR REALIZIMIN E TREGUESVE FINANCIARË VJETOR TË AKEP

##### 4.1.Realizimi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2014

Me Vendimin nr.104 të Këshillit të Ministrave, datë 26.02.2014 “ Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2014 për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare” fondi i shpenzimeve u miratua në shumën 259,500,000 lekë.

📌 **Performanca e treguesve ekonomik – financiarë të AKEP – it është e pasqyruar si më poshtë:**

Nr. Ren	Emërtimi	Programi	Realizimi
<b>I</b>	<b>Të ardhurat gjithsej:</b>	<b>259,500,000</b>	<b>272,115,581</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime gjithsej:</b>	<b>259,500,000</b>	<b>232,177,757</b>
1	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	72,000,000	58,434,822
2	Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore	9,7000,000	8,143,808
3	Shpenzimet për materiale	5,200,000	6,264,027
4	Shpenzimet për shërbime	48,1800,000	44,405,237
5	Shpenzimet për investime	124,420,000	114,929,863
III	Tarifa e Shërbimit të radiokomunikacionit		357,892,000
1	Arkëtuar dhe Transferuar në Buxhetin e Shtetit		357,892,000

##### ➤ Realizimi i arkëtimeve

Për vitin 2014, të ardhurat janë realizuar në shumën 272,115,581 lekë nga 259,500,000 lekë të programuar në fillim të vitit, me realizim në masën 104.8%. Arkëtimet për vitin 2014 janë realizuar nga pagesat e sipërmarrësve që ofrojnë shërbime dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike , shërbimeve postare dhe regjistrim domain. Pagesat që llogariten dhe kryhen në AKEP nga sipërmarrësit janë sipas VKM Nr.599, datë 23.07.2010 “Për miratimin e pagesave që kryhen në AKEP”, i ndryshuar.

Të ardhurat në AKEP janë përfituar nga pagesat:

- Për dhënie dhe përdorimin e frekuencave,
- Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike,
- Për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike sipas nenit 24 të Ligjit Nr. 9918,
- Për ofrimin e shërbimeve postare,
- Për regjistrim domain.al
- Të tjera (çertifikata radio operator, certifikata miratim tipi, radioamator, interesa bankare).

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar dhe ndjekjes së debitorëve, me qëllim arkëtimin e detyrimeve që kanë si ndaj AKEP-it, ashtu dhe për tarifën e shërbimit të radiokomunikacionit. Procesi i mbledhjes së detyrimeve nga sipërmarrësit debitor është ndjekur nëpërmjet:

- Dërgimit të shkresave zyrtare, kontaktimit me telefoni dhe nëpërmjet website.
- Inspektimit të kryer nga Drejtoria e Inspektimit dhe Monitorimit të Spektrit.

#### ➤ **Realizimi i shpenzimeve.**

Shpenzimet gjithësej janë realizuar në shumën 232,177,757 lekë nga 259,500,000 lekë të planifikuara në fillim ose në përqindje realizimi është në masën 89.50%. Mos realizimi i shpenzimeve vjen si rrjedhojë e mosrealizimit të shpenzimeve në disa zëra të shpenzimeve administrative dhe investimeve.

#### ✓ **Shpenzimet administrative**

Shpenzimet administrative, ku përfshihen shpenzimet për paga e shtesa, për sigurimet shoqërore shëndetësore, për material dhe për shërbime janë realizuar në shumën 117,247,894 lekë nga 135,080,000 lekë të planifikuar ose 86.7%.

#### ✓ **Shpenzime për paga dhe shtesa**

Shpenzime për paga e shtesa nga 72,000,000 lekë të planifikuar u realizuan 58,434,832 lekë ose 81,2%. Mos realizimi shpenzimeve për paga në krahasim me programin ka ardhur nga mos plotësimi i numërit të punonjesve sipas strukturës së miratuar nga fillimi i vitit 2014.

#### ✓ **Shpenzime për sigurime shoqërore**

Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore nga 9,700,000 lekë të planifikuara janë realizuar 8,143,808 lekë ose 83,96%. Në mosrealizimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore ka ndikuar mos plotësimi i organikës së numrit të punonjesve të miratuar nga fillimi i vitit 2014.

#### ✓ **Shpenzime për materiale**

Shpenzimet materiale për vitin 2014 janë realizuar në shumën 6,264,027 lekë nga 5,200,000 lekë të programuara ose 120.4% me tejkalim në shumën 1,264,027 lekë. Tejkalimi i shpenzimeve materiale në krahasim me programin vjen kryesisht nga tejkalimi në shpenzimet për karburant në shumën 1,284,000 lekë dhe shpenzime kancelarie në shumën 167,000 lekë. Tejkalimi i shpenzimeve të karburantit vjen kryesisht nga rritja e numrit të kontrolleve në monitorimin e përdorimit të frekuencave të radiokomunikacionit, nga rritja e numrit të kontrolleve në monitorimin e cilësisë së shërbimit të operatorëve celular, nga rritja e numrit të inspektimit të subjekteve, e cila ka rritur kërkesat dhe nevojat për shpenzime transporti mbi parashikimin e programuar në fillim të vitit. Zërat e tjerë të shpenzimeve



materiale janë me mos realizim. Shpenzimet për pjesë këmbimi janë me mos realizim në shumën 68,171 lekë. Shpenzimet për goma e bateri janë me mos realizim në shumën 82,070 lekë. Shpenzimet për bojë priteri e fotokopje janë me mos realizim në shumën 262,973 lekë.

#### ✓ **Shpenzime për shërbime**

Shpenzimet për shërbime janë realizuar në shumën 44,405,237 lekë nga 48,180,000 lekë të programuar ose 92.16% me një mos realizim në shumën 3,774,763 lekë. Nga analiza e shpenzimeve për shërbime rezulton se mos realizimi më i madh është në zërin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike, programeve dhe internet në shumën 1,566,372 lekë, shpenzime udhëtim e dieta dhe kualifikim stafi në shumën 1,392,394 lekë, për marrjen e ambjenteve me qera për personelin në shumën 1,086,980 lekë, për shpenzimet e auto-transportin për shumën 290,231 lekë, për shpenzimeve për shërbime bazë për shumën 94,350 lekë, të shpenzimeve social – kulturore dhe pritje - përcellje për shumën 390,184 lekë.

- Shpenzimet për mirëmbajtje të paisjeve kompjuterike dhe internet nuk u realizua sepse shpenzimet e programuara të internetit për DNS dhe për administratën nga prokurimet e fondit të shpenzimeve për interne rezultuan me ulje për 60 %. Nuk u realizuan shpenzimet për blerjen e rekomandimeve dhe raportin e DVD- ROM dhe shpenzime për blerjen e Standarteve ETSI- EDS DVD A,B,C, shpenzimet për blerjen e Licencës vjetore antivirus dhe shpenzimet vjetore për mirëmbajtjen e faqes së AKEP u realizuar në 30%.
- Shpenzimet për udhëtim e dieta dhe kualifikim stafi nuk u realizuan në krahsim me programin sepse disa aktivitet jashtë shteti rezultuan me kosto me të ulët se programi në fillim të vitit e cila vjen nga ulja e shpenzimeve të transportit për jashtë shtetit.
- Në vitin 2014 ishte programuar marrja e ambjenteve me qera për personelin që ishin në godinë e AKEP, se parashikohej të fillohej rikostruksioni i godinës në tremujorin e katër dhe zhvendoseja personeli nga godinës ekzistuese në ambjente me qera, e cila në fakt nuk u realizua.
- Shpenzimet për auto – transportin nuk u realizuan sepse nuk u bë siguracioni i dy mjeteve të cilët u hoqën nga inventari i AKEP dhe nuk u realizuan shpenzimet e programura për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit.
- Shpenzimet për shërbime bazë nuk u realizuan si rezultat i mos realizimit të shpenzimeve të programuara për telefoninë fikse, celularë .
- Shpenzimeve social – kulturore dhe pritje – përcellje nuk u realizuan si rezultat i mos realizimit të një aktiviteti të programuar në fillim viti dhe mos realizimi i shpenzimeve të pritje – përcellje.

Në disa zëra shpenzimet për shërbime rezultuan me ritje në krahasim me programin e vitit 2014.

- Shpenzimet për publikime dhe njoftime në krahsim e programin e vitit u tejkaluan në shumën 390,184 lekë e cila vjen nga publikimin i tendërit për dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX”, Ref. 6-2X6-2015 për publikim në shtypin ndërkombëtar, shpenzime të cilat nuk ishin programuar për vitin 2014.

- Shpenzimet për antarsim në organizata ndërkombetare në krahasim me programin e vitit u tejkaluan në shumën 514,548 lekë e cila vjen nga pagesa e antërsimit të AKEP –it në IRG ( Independent Regulators Group) gjatë vitit 2014.
- Shpenzimet e tjera u tejkaluan shumën 227,834 lekë e cila vjen nga pagesat që u kryen për lëvizjen e pajisjeve nga godina në një ambient tjetër, nga dërgimi i disa pajisjeve në stacionin e monitorimit Krujë, shpenzimet për heqjen materialeve dhe pajisjeve nja godina për rikostruksion si: Dyer, kondicionerët e pajisjet e tjera si dhe shpenzimet për lëvizjen e materialeve të magazinës dhe lëvizjen e arkivit të AKEP .

## ➤ Investimet

Shpenzime për investime për vitin 2014 nga 124,420,000 lekë të programuara janë realizuar në shumën 114,943,382 Lekë ose 92.4%. Mos realizimi i shpenzimeve për investimeve për shumën 9,476,618 lekë ose 7.7% ka ardhur nga procedurat e prokurimit të investimeve sipas objekteve të programuara. Për vitin 2014 janë realizuar të gjitha objektet e investimit të programuara.

Realizimi i shpenzimeve sipas objekteve të investimit është si më poshtë vijon:

- Mirëmbajtja vjetore e “Portabilitetit të Numrit" nga 25,380,000 lekë e planifikuar për vitin 2014 është realizuar në shumën 25,242,000 lekë. Është kontratë në vazhdim nga viti 2011 për shërbimi i mirëmbajtjes.
- Dixhitalizimi i Arshivës së AKEP e prokuruar në vitin 2013, e programuar në shumën 5,040,000 lekë, është realizuar në shumën 5,040,000 lekë,
- Blerje “Disastar Recovery Site” e prokuruar në shumën 11,840,406 lekë dhe e financuar në vitin 2013 në shumën 9,968,404 lekë. Në vitin 2014 është financuar 1,872,201 lekë.
- Zhvillim dhe suport për FRED dhe rregjistrat të DNS e prokuruar në shumën 5,376,000 lekë e financuar në shumën 2,304,000 lekë në vitin 2013, për vitin 2014 është financuar në shumën 3,072,000 lekë.
- Blerje e shërbimit të informacionit rregullatorë e programuar në shumën 1,438,175 lekë është realizuar në shumën 1,438,175 lekë.
- Upgrade i Sistemeve Informatikë të AKEP është vazhdim kontrate nga viti 2013 dhe për vitin 2014 është financuar në shumën 1,572,000 lekë.
- Sistemi Inteligjent mbrotje per sistemet mbrotjeje për sistemin DSM e programuar në shumën 1,435,728 lekë është realizuar në shumën 1,435,728 lekë.
- Firewall Cluster e programuar në shumën 846,000 leke është realizuar në shumën 564,954 lekë.
- Zhvillim i DNS - BIND dhe suport për FRED dhe regjistarar-et DNS e programuar në shumën 12,267,000 lekë është relizuar në shumën 5,198,962 lekë.
- Blerje pajisje marrëse që do të mbulojë diapazonin e frekuencave 20 - 3000 MHz dhe kontrollon brezin VHF/UHF për matje, gjetje drejtimi dhe lokalizimi në stacionin Krujë e programuar në shumën 19,437,000 lekë është realizuar në shumën 18,645,247 lekë.
- Blerje pajisje USB tokën ( pajisje për certifikata dixhitale për punonjësit e AKEP) e programuar në shumën 226,000 lekë është realizuar në shumën 216,480 lekë.
- Modul për konvertimine P.P.F në formë web dhe nxjerejen online e programuar në shumën 480,000 lekë është realiyuar në shumën 465,072 lekë.

- Modul për konvertimine P.P.F në formë web dhe nxjerejen online e programuar në shumën 2,000,000 lekë është realiyuar në shumën 1,926,000 lekë.
- Version mobil për"al dns check" dhe"NP check" e programuar në shumën 423,000 lekë është realizuar në shumën 380,000 lekë.
- SMS4DC upgrade e programuar në shumën 846,000 lekë është realizuar në shumën 770,047 lekë.
- Modul për pagesat online e programuar në shumën 480,000 lekë është realizuar në shumën 426,000 lekë.
- Hardware support për pajisje e CRBD e programuar në shumën 2,115,000 lekë është realizuar në shumën 2,020,000 lekë.
- .Workstation( Pajisje për manazhimin e SMC4DC) e programuar në shumën 480,000 lekë është realizuar në shumën 256,762 lekë.
- Zhvillim (upgrade) të sistemit të Autorizimeve, Raportimeve, Certifikatave dhe Licensave e programuar në shumën 423,000 lekë është realizuar në shumën 411,600 lekë.
- Projektë për rikostrusion të godinës së AKEP e programuar në shumën 1,000,000 lekë është realizuar 984,000 lekë
- Rikostruksion i godinës së AKEP-it, financimi pjesor për vitin 2014 e programuar në shumën 28,800,000 lekë është realizuar në shumën 28,005,524 lekë.
- Blerje pajisje zyre për administratën e programuar në shumën 3,000,000 lekë është realizuar në shumën 1,900,800 lekë.
- Blerje Autoveture ( me 4 dyer dhe ABS 4x4 ) e programuar në shumën 9,100,000 lekë është realizuar në shumën 9,096,000 lekë.
- Blerje PC dhe pajisje kompjuterike e programuar në shumën 830,000 lekë është realizuar në shumën 727,452 lekë.
- Blerje pajisje Laptop PC e programuar në shumën 880,000 lekë është realizuar në shumën 770,070 lekë.
- Blerje pajisje të tjera për nevojat e administratës e programuar në shumën 997,095 lekë është realizuar në shumën 1,260,988 lekë.
- Në vitin 2014 nga të ardhurat e krijuar si agjent tatimor janë blerë 1,130,520 lekë pajisje për mekanizimin, informatizimin e vjeljes tarifese së radiokomunikacionit e cila derdhet në buxhetin e shtetit.

#### ➤ **Mbi tepricën e të ardhurave**

Teprica e të ardhurave në fund të vitit 2014 rezulton në shumën 39,937,824 lekë e cila është përfituar si rezultat i tejkalimit të ardhurave në shumën 12,515,581 lekë dhe mos realizimi i shpenzimeve në shumën 27,322,243 lekë. Teprica e të ardhurave derdhet në Buxhetin e Shtetit brenda 3-mujorit të parë të vitit 2015.

#### ➤ **Mbi taksën e radiokomunikacionit**

Në referencë të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “ Për taksat kombëtare” dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave Nr.28, datë 06.10.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit” i ndryshuar, AKEP është agjent tatimor për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në Buxhetin e Shtetit të tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Për vitin 2014 janë arkëtuar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit shuma prej 357,892,000 lekë. AKEP ka punuar dhe ndjekur në vazhdimësi mbledhjen e tarifës së radiokomunikacionit, ka bashkëpunuar me organet tatimore, për arkëtimet dhe derdhjen e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit.

Në realizimin e detyrës si agjent tatimor AKEP ka përfituar komisione në masën 5 % të shumës së derdhur në Buxhetin e Shtetit në shumën 17,894,584 lekë.

#### **4.2. Rritja e performancës dhe efektiviteti i realizimit të treguesve financiarë të AKEP**

AKEP gjatë vitit 2014 ka punuar për rritjen e performancës dhe efektivitetin e realizimit të treguesve financiarë si dhe në administrimin, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare duke bërë:

- Kontabilizimin në kohë të veprimeve të arkës, bankës, magazinës për të ardhurat dhe shpenzimet që kryen institucioni.
- Mbyllja e bilancit financiar të vitit 2013, dhe dërgimin e tij brenda afateve ligjore në organet tatimore.
- Ndjekja e vazhdueshme e sipërmarrësve debitor për likuidimin e pagesave për AKEP dhe tarifën e radiokomunikacionit dhe bashkëpunim me organet tatimore.
- Informatizimi i llogaritjeve të pagesave dhe mundësimi on-line në faqen e internetit të AKEP, për sipërmarrësit me qëllim rritjen e transparencës dhe uljen e debitorëve.
- Inventarizimin e pasurisë së AKEP për materialet në magazinë e në përdorim dhe për materialet e papërdorshme dhe asgjësimin e tyre konform legjislacionit në fuqi.

#### **4.3.Parashikimi i treguesve financiarë të AKEP për vitin 2015**

Në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshillit të Ministrave me Vendimin nr.924, datë 29.12.2014 “ Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2015 për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare” fondi i shpenzimeve u miratua në shumën 306,400,000 lekë.

Fondi i shpenzimeve për vitin 2015 sipas zërave u miratua si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Programi i Vitit 2015
<b>I</b>	<b>Të ardhurat gjithsej:</b>	<b>306,400,000</b>
<b>II</b>	<b>Shpenzime gjithsej:</b>	<b>306,400,000</b>
1	Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera	72,000,000
2	Shpenzimet për sigurime shoqërore e shëndetësore	9,700,000
3	Shpenzimet për materiale	5,800,000
4	Shpenzimet për shërbime	51,740,000
5	Shpenzimet për Investime	167,160,000

AKEP ka bërë detajimin e shpenzimeve në zëra analitike e ka miratuar në Këshillin Drejtues dhe ka filluar zbatimin për realizimin e detyrave dhe objektivave për vitin 2015.